



PROTESTAT SOCIALE DHE INSTITUCIONET: PRAKTIKAT E KOMUNIKIMIT DHE LLOGARIDHËNIA




Albanian Media Institute
Instituti Shqiptar i Medias

**Protestat sociale dhe institucionet:
praktikat e komunikimit dhe llogaridhënia**

Protestat sociale dhe institucionet: praktikat e komunikimit dhe llogaridhënia



Tiranë 2016



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Regional Research

Promotion Programme | Western Balkans



UNIVERSITÉ DE FRIBOURG
UNIVERSITÄT FREIBURG

Ky libër botohet në kuadrin e projektit kërkimor *“Praktikat e komunikimit në kontekstin e protestave sociale dhe kërkesave për llogaridhënie publike”*, të financuar nga Regional Research Promotion Programme (RRPP), në Ballkanin Perëndimor.

RRPP nxit studimet në shkencat sociale në Ballkanin Perëndimor (Shqipëri, Bosnjë e Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi). Studimet në shkencat sociale ndihmojnë në një kuptim më të mirë të nevojave për reforma në vendet e rajonit dhe në identifikimin e pasojave afatgjata të politikave. Studiuesit mbështeten nëpërmjet granteve për hulumtim, trajnimeve metodologjike dhe tematike, si dhe mundësi për krijimin e rrjeteve dhe këshillimin rajonal dhe ndërkombëtar. RRPP koordinohet dhe zbatohet nga Interfaculty Institute for Central and Eastern Europe (IICEE) pranë Universitetit të Friburg (Zvicër). Programi financohet plotësisht nga Agjencia Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Departamenti Federal i Punëve të Jashtme.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe jo domosdoshmërisht përfaqësojnë opinionet e SDC dhe Universitetit të Friburgut.

Botues:



Albanian Media Institute
Instituti Shqiptar i Medias

Rr. Gjin Bue Shpata, nr.8, Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +42229800

E-mail: info@institutemedia.org

www.institutemedia.org

© Instituti Shqiptar i Medias 2016

Treguesi i lëndës

Hyrje	7
-------------	---

QYTETARËT NË PROTESTA DHE MEDIA: EKSPLORIMI I SHANSEVE DHE PENGESAVE, THIRRJE PËR REFORMA NË MEDIA DHE NË SHOQËRI

Hyrje	11
1. Bagazhi teorik dhe rezultatet e studimeve të mëparshme	15
1.1. Studimi i praktikave dhe metodave të komunikimit gjatë protestave në tre vende	23
2. Rreth këtij studimi	26
2.1. Vendet e përfshira në studim dhe protestat e marra në analizë	32
2.2. Metodatat e kërkimit dhe përzgjedhja e subjektit ...	33
2.3. Koncepti i kornizimit dhe analiza e kornizimit që përdoret në këtë studim	38
3. Rezultatet kryesore të studimit në tre vende: Tablo e përgjithshme	44
3.1. Si i ka vendosur media në kornizë protestat, si u perceptuan ato nga të intervistuarit?	44
3.2. Si kornizohet në media koncepti i përgjegjësisë publike dhe çfarë thonë të intervistuarit mbi këtë çështje?	50

3.3. Roli i medias dhe metodat e komunikimit të gazetarëve	57
3.4. Mediat sociale - një partner i vështirë për mediat tradicionale	62
3.5. Metodat e komunikimit të qytetarëve/protestuesve	65
4. Disa shënime të fundit	68
Bibliografia	74

MIDIS MEDIAVE TRADICIONALE DHE MEDIAVE SOCIALE

1. Ambienti mediatik	83
2. Protestat qytetare dhe kërkesa e llogarisë ndaj qeverisë	89
3. Protestat e qytetarëve gjatë periudhës 2013 - 2015... ..	96
4. Përzgjedhja e rasteve studimore	101
5. Rezultatet e kërkimit	105
5.1 Protestat: kornizimi në media dhe perceptimi ...	105
5.2 Përgjegjësia publike: kornizimi në media dhe perceptimi	123
5.6 Roli i medias dhe metodave të komunikimit nga gazetarët	137
5.7 Roli i mediave sociale dhe platformave të tjera alternative	151
5.8 Mundësitë dhe mënyrat e komunikimit të qytetarëve/protestuesve	161
6. Shënime të fundit	169
7. Rekomandime	172
Bibliografi	174

Hyrje

Lëvizjet dhe protestat sociale në rajonin e Ballkanit kanë qenë të shpeshta vitet e fundit, por një vështrim dhe studim sistematik i praktikave dhe strategjive të komunikimit në këto lëvizje, si dhe efekti që ato kanë pasur në llogaridhënien e institucioneve, ka munguar. Këto nisma dhe lëvizje janë një mundësi e mirë për ndryshime pozitive sociale. Gjithsesi, rezultatet dhe sukseset e tyre janë të diskutueshme, pasi jo gjithnjë përdoret maksimumi i potencialit të komunikimit.

Ky botim përpiket të plotësojë këtë mungesë, duke sjellë rezultatet e një studimi të kryer në këtë fushë në tre vende të Ballkanit: Shqipëri, Bosnjë e Herzegovinë dhe Maqedoni. Studimi përqendrohet te praktikat e komunikimit të të gjithë aktorëve të përfshirë në protesta (qytetarë, qeveria dhe media), duke u përpjekur të hedhë dritë mbi mundësinë dhe kufizimet në komunikim, si dhe pasoja që ai ka për protestat dhe llogaridhënien e institucioneve. Botimi përmban kapitullin rajonal, i cili vë në dukje prirjet, ngjashmëritë dhe dallimet mes tre vendeve në komunikimin gjatë protestave, si dhe studimin që përqendrohet te protestat në Shqipëri. Botimi u krye në kuadrin e projektit të udhëhequr nga Qendra e Medias, Sarajevë, me pjesëmarrjen e Institutit Maqedonas të Medias dhe Institutit Shqiptar të Medias, nën këshillimin e Peace Institute, Ljubllanë.

Qytetarët në protesta dhe media:
eksplorimi i shanseve dhe pengesave, thirrje
për reforma në media dhe në shoqëri

Sanela Hodžić dhe **Mojca Pajnik**

Hyrje

Gjatë këtyre viteve të fundit rajoni i Ballkanit është përfshirë nga një valë protestash masive ku qytetarët kanë shprehur hapur pakënaqësitë e tyre, kërkojnë qeverisje të përgjegjshme, dhe vënien e qeverive para përgjegjësisë. Ndonëse edhe më parë protestat nuk kanë qenë aspak ndodhi e rrallë¹ - veçanërisht po të kemi parasysh se në disa vende të rajonit tubime protestash në një shkallë më të vogël janë zhvilluar në mënyrë thujse konstante – protestat e organizuara gjatë këtyre viteve të fundit, që nga viti 2003, kanë paraqitur një sërë mundësish dhe sfidash të reja në lidhje me komunikimin dhe shpërndarjen e informacionit të protestave, shtrirjen e tyre, numrin e pjesëmarrësve, ambientin social-politik, por edhe mbi ndryshimet e teknologjisë së komunikimit dhe përdorimit e medias. Qëllimi i këtij studimi është analizimi i praktikave dhe mënyrave të komunikimit gjatë disa protestave të këtyre viteve të fundit, duke patur parasysh se komunikimi është i rëndësishëm jo vetëm në aspektin simbolik dhe mediatik, por ai luan një rol parësor edhe përsa i përket organizimit dhe mobilizimit të masave dhe rezultatit përfundimtar të lëvizjeve sociale.

¹ Ia vlen të përmendet fakti se ky rajon ka përjetur protesta masive në vitet '90 (protestat antiluftë në Sarajevë në vitin 1992; dhe protestat antiqeveritare në Serbi, 1996-97).

Rastet e protestave të analizuara në këtë studim ndryshojnë nga njëri-tjetri nga fokusi dhe shtrirja e manifestimeve të protestës, por nga ana tjetër kanë disa ngjashmëri përsa i përket kontekstit dhe ambientit politik në të cilin u formuan por edhe rreth komunikimit dhe rrjedhës së informacionit përgjatë protestave. Këto manifestime proteste paraqitën disa risi. Në rastin e Shqipërisë protestat kundër një projekti për shkatërrimin e armëve kimike në territorin e saj ishin një nga lëvizjet e pakta masive që i shpëtuan instrumentalizimit politik dhe përfshinë një numër më të madh protestuesish. Protestat e shkurtit 2014 në Bosnjë Hercegovinë mobilizuan një numër më të madh protestuesish nga sa parashikohej. Ato gjithashtu tejkaluan fokusin fillestar mbi të drejtat e punëtorëve, duke përfshirë një gamë më të gjerë çështjesh sociale në nivel kombëtar, si dhe duke kapërcyer deri diku edhe barrierat etnike. Protestat kishin një element të fortë antiqeveritar, duke përfshirë thirrjet për dorëheqje dhe krijimin e një qeverie të re. Në Maqedoni, protestat e studentëve në vitin 2014 kundër një projekti për reforma në arsim ishin të parat e këtij lloji që nga viti 1997. E veçanta në këto protesta ishte shprehja e ndjenjave të forta antiqeveritare që arritën kulmin me krizën politike të vitit 2015. Kjo protestë ishte një nga rastet e rralla të lëvizjeve masive në Maqedoni që nuk përqendrohej në çështje etnike dhe ndjenjat nacionaliste.

Në protestat e kohëve të fundit në Bosnjë, dhe Maqedoni u krijuan për herë të parë në historinë e protestave në këto vende edhe plenumet (apo asamble). Plenumet u shfrytëzuan si një formë e re grumbullimi proteste për të nxitur shkëmbimin e pikëpamjeve dhe ankesave të qytetarëve, duke u përpjekur të realizohej një shkëmbim horizontal informacioni, dhe kjo paraqet një këndvështrim të ri dhe ripozicionim të roleve në proceset demokratike, si dhe

ndyshim thelbësor në praktikat dhe metodat e komunikimit masiv. Plenumet apo asambltetë që u ngritën në këtë rajon gjatë këtyre viteve të fundit ngjasonin shumë me aktivitetet e protestave të mëparshme që u zhvilluan anembanë botës, që nga Beteja në Siatëll në vitin 1999, ku janë organizuar lëvizje globale për t'iu kundërvënë pushtetit politik të korporatave apo elitave. Gjatë këtyre viteve të fundit kemi parë protesta të ngjashme ku ushtrohet rezistencë pasive në formë "sit-in," të organizuara si aktivitete proteste dhe të përdorura si metoda komunikimi në vitin 2011 gjatë lëvizjes *Occupy* (Pushto) që u prezantua me sloganin "ne jemi 99% e popullit."

Studimet në lidhje me proceset e komunikimit masiv gjatë protestave qytetare në rajonin e Evropës juglindore kanë qenë të pakta, po ashtu kemi vetëm njohuri sipërfaqësore mbi rolin e medias dhe platformave të komunikimit mbi futjen në kornizë të protestave dhe mobilizimin e masave për veprim. Kjo përmbledhje kërkimesh është një përpyetje për të mbushur disi këtë boshllëk. Vëmendja e këtij studimi përqendrohet mbi rastet e fundit të protestave në Shqipëri, Bosnjë Hercegovinë, dhe Maqedoni, ndërsa përpiqet t'i përgjigjet disa pyetjeve kryesore: a) kornizimi - si janë *paraqitur dhe prezantuar* protestat në media, dhe b) si *perceptohet roli* i mediave tradicionale dhe platformave alternative të komunikimit në informimin e qytetarëve dhe mobilizimin e tyre për aksion të përbashkët, dhe në veçanti c) si është paraqitur nga media mesazhi për kërkim llogarie, qeveri të përgjegjshme dhe vënie para përgjegjësisë, dhe d) cili është perceptimi i përgjithshëm mbi përgjegjshmërinë e qeverisë dhe institucioneve publike në vazhden e protestave qytetare.

Ky studim merr në analizë jo vetëm përmbajtjen e informacionit dhe reagimin e publikut ndaj tij, por hedh dritë edhe mbi ndihmesën apo pengesat që krijohen nga

praktika të ndryshme komunikimi ndaj nismave qytetare dhe përgjegjshmërisë qeveritare, çfarë roli kanë luajtur mediat kryesore në raportimin e protestave, si kanë reaguar zyrtarët publikë ndaj raportimit në media dhe si e kanë përdorur median protestuesit për të komunikuar mesazhin e tyre. Si përfundim, qëllimi i këtij studimi është që të ndihmojë në një njohje më të thellë të përmbajtjes dhe dinamikave mediatike gjatë protestave popullore, dhe të mundësojë një njohje më të mirë të përpjekjeve të qytetarëve për përgjegjshëri të institucioneve publike. Ky studim gjithashtu del me këshilla dhe rekomandime për organet e medias, zyrtarë, aktivistë apo qytetarë lidhur me mësimet e nxjerra nga praktika për të ndihmuar me strategjitë e komunikimit për të ardhmen.

Në fillim të këtij botimi, do të paraqesim së pari disa informacione dhe të dhëna mbi teoritë e lëvizjeve sociale dhe studimeve të komunikimit masiv lidhur me rolin që luan komunikimi dhe rrjedha e informacionit gjatë protestave, duke përfshirë avantazhet dhe pengesat që vijnë nga zbatimi i disa praktikave dhe metodave të ndryshme të punës, dhe më pas do të paraqesim në mënyrë më të detajuar rezultatet e këtij studimi.

1. Bagazhi teorik dhe rezultatet e studimeve të mëparshme

Fokusi dhe metodologjia e këtij studimi është bazuar në një bagazh të dhënash të mbledhura nga disa fusha, dhe i referohet nga njëra anë teorive të lëvizjeve sociale dhe shkencave politike, dhe nga ana tjetër studimeve mbi komunikimin dhe median. Roli i mediave dhe komunikimit gjatë aksioneve të përbashkëta qytetare është lënë pas dore dhe shpërfillur për një kohë të gjatë, por megjithatë disa studiues (Gamson dhe Wolfsfeld 1993) e kanë vlerësuar rolin e medias në mobilizimin e mbështetjes politike për lëvizjet sociale. Ky studim ka si pikënisje njohjen e rëndësisë dhe ndikimit të medias dhe komunikimit masiv në protesta dhe lëvizje sociale, lidhur me rolin e saj në fushën e **vlerave të një shoqërie dhe diskursit politik** që shërbejnë si sfond dhe kontekst për protesta, por edhe si pjesë e **dimensioneve strukturale**, duke përfshirë kontekstin social-politik, që përcaktojnë kursin dhe rezultatin përfundimtar të një lëvizjeje sociale.

Dimensionet strukturale përmblihen në ato që Cammaerts i quan “struktura ndihmëse mediacioni” (2012)²,

² Cammaerts thotë se komunikimi është i rëndësishëm për protesat në disa drejtime – “për proceset e kornizës në mediat kryesore dhe nga elitat politike, vetëpërfaqësimin nga aktivistët, përdorimin, përvetësimin dhe adoptimin e mjeteve të teknologjisë së komunikimit nga aktivistë dhe qytetarë për të mobilizuar masat dhe për të

që përfshijnë disa elementë të ndërlidhur dhe të ndërvarur nga njëri-tjetri: struktura ndihmëse mediatike, struktura ndihmëse diskursive, dhe struktura ndihmëse rrjeti, ku secila përmban njëkohësisht mundësi dhe avantazhe por edhe kufizime ndaj lëvizjeve sociale. Struktura ndihmëse mediacionale i referohet rolit të mediave kryesore në mobilizimin e mbështetjes politike, legjitimimin dhe pranimin e kërkesave të lëvizjeve sociale, dhe ndihmesës në zgjerimin e shtrirjes së frymës së protestës përtej grupit të ngushtë të simpatizantëve. Dy aspektet e tjera të strukturave ndihmëse mediacionale janë *strukturat ndihmëse diskursive*, të cilat u referohen dimensioneve strukturale që përcaktojnë bazat diskursive mbi disa dukuri të caktuara. Dhe së fundmi, roli i mjeteve dhe teknologjisë së komunikimit në organizimin, mobilizimin, rekrutimin, koordinimin e veprimeve dhe shpërndarjen e kornizimeve alternative në mënyrë të pavarur nga mediat tradicionale kryesore janë ato që Cammaerts i quan *struktura ndihmëse rrjeti*. Në lidhje me protestat masive, si Pranvera Arabe, revoltat popullore në Turqi dhe Brazil, një numër i madh studimesh janë fokusuar në rolin e teknologjisë së informimit në suksesin e lëvizjeve sociale në mobilizimin, rekrutimin, dhe koordinimin e aksioneve, si dhe për të komunikuar pikëpamjet dhe opinionet rreth qeverisë (apo rreth vetë lëvizjes sociale) në mënyrë të pavarur nga media tradicionale dhe burimet zyrtare (shiko Bennet dhe të tjerë, 2008). Të tre këto aspekte të strukturave

organizuar aksione proteste, si dhe disa praktika pune në media dhe komunikim masiv që përbëjnë në vetvete rezistencë të ndërmjetësuar” (Cammaerts, Protest logics and the mediation opportunity structure. European Journal of Communication, - Logjika e protestës dhe strukturat ndihmëse të mediacionit, Revista Evropiane e Komunikimit, faqe 118). Lexo gjithashtu mbi konceptin e mundësive politike nga Eisinger 1973, dhe Opp, 2009.

ndihmëse të mediacionit përcaktojnë shanset dhe kufizimet e veprimtarive të lëvizjes dhe përcaktojnë repertorin e aksioneve të protestës³.

Përsa i përket rolit të **mediave kryesore**, studimet tregojnë se suksesi i lëvizjeve sociale varet nga fakti nëse, dhe deri në çfarë niveli, mediat tradicionale i legjitimojnë dhe u bëjnë jehonë kërkesave të protestës, e zgjerojnë gamën e tyre, dhe nëse dhe deri në çfarë niveli raportimi në media mobilizon mbështetje politike për këto lëvizje. Një numër i madh studimesh kanë vënë re një prirje negative në raportimin e mediave kryesore ndaj protestave, duke përfshirë fokusimin mbi ngjarje të bujshme dhe akte dhune, si dhe favorizim të elitave politike dhe ekonomike⁴, aq sa disa studiues e konsiderojnë median si mekanizëm ideologjik në shërbim të shtetit dhe interesave kapitaliste (Althusser 1970, McCurdy, 2010). Sociologë të tjerë i kundërvihen këtij këndvështrimi mbi median si kundërshtarë e lëvizjeve sociale duke vënë në dukje praktika dhe eksperiencia diametralisht të kundërta, si trajtim të favorshëm apo mbështetje të lëvizjeve sociale nga media kryesore tradicionale.⁵ Fakti që fokusi dhe vëmendja e mediave tradicionale përqendrohet

³ Për shembull strukturat ndihmëse të rrjetit mundësojnë forma të reja rezistence nëpërmjet përdorimit të mjeteve të teknologjisë së informacionit. Kufizimet dhe pengesat në këtë ndërmjetësim vijnë në formën e njëanshmërisë dhe qëndrimit negativ nga mediat kryesore, kufizime që lidhen me përdorimin e teknologjisë, etj. Lëvizjet e protestës duhet që t'i kapërcejnë këto pengesa për të patur impakt sa më të madh.

⁴ Shiko për shembull McChesney, 2008; McCurdy, 2010, Halloran, e të tjerë. 1970, Gitlin 1980, Eldridge 1995.

⁵ Shiko për shembull DeLuca dhe Peebles, 2002; Cammaerts dhe Carpentier, 2009, van Zoonen, 1992. Rastet e përmendura më shpesh përsa i përket raportimit pozitiv në media janë protesat antiluftë apo lëvizjet për të drejtat e grave, apo protestat në Seattle kundër OBT.

tek akte të dhunës dhe protesta që përfshijnë akte të bujshme apo numër të madh pjesëmarrësish mund të shpjegohet thjesht nga parimi i lajmit të bujshëm që ndiqet rregullisht nga mediat. Për këtë arsye lëvizjet sociale dhe organizatat e protestës në mbarë botën po përshtaten dhe po adoptojnë rregullisht strategji komunikimi dhe planifikim strategjik. Ato e modifikojnë deri diku veprimtarinë e tyre që të përkojë me logjikën e medias, duke nxitur shpërndarjen e mesazheve dhe informacioneve nga protestat, duke lëshuar deklarata shtypi, dhënie intervistash, lejimi i aksesit për gazetarë, krijimi i faqeve të internetit dhe angazhimi aktiv në rrjetet sociale, ndërkohë që krijojnë edhe njëfarë strukture organizative që përfshin zëdhënës. Këto praktika dhe metoda pune përfshijnë edhe propagandë, apo zbutje dhe manipulime të ngjarjeve dhe aktiviteteve të ndryshme, si dhe shfrytëzim të natyrës së medias duke ndërhyrë në aktivitete të elitave apo duke inskenuar akte të bujshme për të tërhequr vëmendjen e medias⁶.

Strategjitë në disa raste mund të marrin edhe forma të pazakonta, ku disa lëvizje sociale mund të përdorin aktet e dhunës si pjesë e rëndësishme e strategjisë së protestës, që mund të ketë një efekt të ndjeshëm në tërheqjen e vëmendjes së medias. Interpretimi dhe të dhënat që mblidhen nga këto aktivitete proteste janë shumë të rëndësishme për lëvizjet sociale, po të kemi parasysh se ato shpesh përballen me raportime të pasakta mbi numrin e pjesëmarrësve

⁶ Ndërprerje të tilla aktiviteteve kanë ndodhur për shembull gjatë takimeve të G8 apo OBT-së; Po kështu komunikimi guerrilas dhe interferencat politike frymëzohen nga logjika e pjesëmarrjes në akte politike dhe taktika të “parodisë serioze” që mundohen të ndërhyjnë në sferën e politikës mbizotëruese (Cammaerts, 2007). De Luca (2005) vë në dukje rolin e rëndësishëm që kanë eventet simbolike të krijuara për median për shoqatat ambientaliste.

dhe interpretime negative nga autoritetet shtetërore, për shembull me ndryshime të mëdha në raportimin e numrit të protestuesve, raportimet mbi dëmet e shkaktuara nga aktet e dhunës, raportimet mbi dhunën policore, etj.⁷ Përveç mediave kryesore tradicionale, lëvizjet sociale krijojnë mediat⁸ e tyre, sidomos online, si platforma që mundësojnë vetëndërmjetësinë, me qëllim që të informojnë, të debatojnë rreth çështjeve të ndryshme, të krijojnë lidhje dhe të mobilizojnë njerëz në mbështetje të kauzës së tyre. Përdorimi i internetit e ka bërë më të lehtë prodhimin dhe shpërndarjen e materialeve në mbështetje të protestës (YouTube, rrjetet sociale, etj), ku protestuesit krijojnë dhe shkëmbejnë ide rreth protestave⁹. Ndërkohë që shumica e studiuesve

⁷ Della Porta dhe Diani (2006) janë të mendimit se repertori i akteve të protestës përcaktohet nga logjika e protestës, që përfshin: *logjikën e numrave* (Sa më masive të jetë protesta aq më i dukshëm bëhet qëndrimi disident); *logjika e dëmit të shkaktuar* (Dhuna politike ka qenë pikë kyçe në luftën për ndryshim, por shpesh gjykohet shumë ashpër nga media, nga autoritetet dhe nga vetë protestuesit; ka edhe argumenta se dhuna politike diskrediton legjitimitetin e protestave dhe i shërben mediave në etiketimin e “turmave të dhunshme” (Donson e të tjerë. 2004); por sidoqoftë të tjerë besojnë se dëmet materiale (jo dëmet në njerëz) janë një formë legjitime e rezistencës (Jazz, 2001, Cammaert 2012), dhe se dhuna provokon reagimin e policisë që tregon shkallën e dhunës në një demokraci liberale; *logjika e dëshmisë*. Logjika e dëshmisë dhe përbaljes me padrejtësinë është një element që ndeshet gjatë manifestimeve të rezistencës pasive dhe mosbindjes civile, bojkoteve të mallrave, etj.

⁸ Stacionet radio të komuniteteve në vende të ndryshme kanë ofruar mbështetje për lëvizjet sociale, por ky sektor është shumë i pazhvilluar në rajonin e Ballkanit perëndimor.

⁹ Duhet përmendur edhe përdorimi i teknologjisë së informacionit si mjet aksioni më vete (haktivistët, lëvizja Open source, etj.). Por përmbajtja online mund të fshihet, privatësia e përdoruesve mund të dhunohet, dhe faqet mund të mbyllen, dhe për këto arsye platformat online nuk janë të sigurta dhe mund të sjellin shumë rrezik për aktivistët.

vlerësojnë potencialin demokratik të platformave online, disa theksojnë faktin se angazhimi pasiv disi në distancë nga ekrani i kompjuterit, që quhet ndryshe nga kritikët si klik-tivizëm or përtacllëk (Morozov, 2009) natyrisht nuk të çon gjithmonë drejt angazhimit aktiv¹⁰ por mund të ndikojë mjaft në këtë proces.

Lëvizjet sociale janë një formë «konflikti politik me elitat, autoritetet dhe kundërshtarët e kauzës» që përfshin «organizimin, koordinimin dhe vazhdimin e rezistencës ndaj kundërshtarëve të fuqishëm» (Tarrow, 2011, faqe 6). Sidoqoftë ato nuk janë organizma fikse, por duhet të konsiderohen si procese që sjellin transformime me kalimin e kohës.¹¹ Në lidhje me këtë çështje, duhet të përmendim faktin se ky studim përqendrohet kryesisht mbi lëvizjet sociale “me kohëzgjatje afatshkurtër” (Mattoni dhe Trere, 2014), pra periudha të ngarkuara me aktivitete protestash dhe mobilizim masash. Mattoni dhe Trere (2014) arrijnë të bëjnë dallimin midis grupeve sociale që marrin pjesë në lëvizje sociale që shpesh “nuk kanë hierarki formale, marrin vendime në procese vendimmarrëse që bazohen në pjesëmarrje dhe vlerësojnë përfshirjen individuale të aktivistëve në protesta...” dhe kanë një organizim jo strikt të veprimtarive të përditshme, dhe nga ana tjetër kemi organizime të lëvizjeve sociale “me hierarki formale, që aplikojnë procese vendimmarrëse të bazuara në delegim...” dhe kanë një organizim më strikt të veprimtarive

¹⁰ Kjo mund të jetë shumë e rëndësishme për ata qytetarë që nuk munden apo nuk duan të aktivizohen në mënyrë ‘aktive’ ditë pas dite, dhe kështu mund të dëshmojnë dhe t’u kundërvihen padrejtësie duke dhënë ndihmesë drejt përgjegjshmërisë globale dhe ndërtimit të identiteteve kolektive (Kavada 2010, Cammaert 2012).

¹¹ Shiko për shembull Della Porta dhe Diani, 2006, Blee, 2012;

të përditshme (faqe 257-258)¹². Disa studiues i dallojnë lëvizjet sociale nga format e tjera të aksionit qytetar në bazë të ekzistencës së organizimit por Tarrow (2011) vë në dukje zhvillimin e “organizimeve hibride” (faqe 123-139), që mundohen të mbajnë në këmbë lëvizjet sociale ndërkohë që orvaten të ruajnë një ekuilibër të brishtë midis një lëvizjeje heterogjene dhe një organizimi të centralizuar.

Përsa i përket rolit të medias, ky studim bazohet kryesisht në konceptin e mediacionit, apo ndërmjetësimin, si një proces shoqëror ku media mbështet dhe siguron rrjedhën e informacionit dhe shkëmbimit të opinionëve në shoqëri (Silverstone 2002). Ky koncept ka të bëjë me shfrytëzimin e medias nga aktorë dhe faktorë socialë për të nxitur rezistencën ndaj mendimeve dhe strukturave hegjemoniste. Ky ndërmjetësim është një proces që ndërthuret me fusha dhe aktivitete të ndryshme sociale, duke përfshirë edhe lëvizjet e protestës. Ka të bëjë me përdorimin e teknologjisë së komunikimit dhe prodhimin e materialeve mediatike, por ajo gjithashtu nënkupton edhe rikonfigurimin e teknologjisë, ndryshimin dhe krijimin e mendimeve të reja (Lievrouw, 2011).

Përdorimi i mediave tradicionale dhe platformave alternative për komunikim nga grupet e protestës dhe lëvizjet sociale ngre disa çështje interesante lidhur me përvetësimin dhe shfrytëzimin e teknologjisë në ndryshimin dhe manipulimin e mendimit. *Mediatizimi* është një koncept

¹² Studiues të ndryshëm flasin gjithashtu për koalicione edhe rrjete lëvizjesh sociale, e para ka të bëjë me organizim strikt dhe kanale komunikimi formale, ndërsa e dyta ka një organizim më të relaksuar dhe rrjedhë informale komunikimi (Shiko Matoni dhe Trere, 2014)

i ngjashëm¹³, që përdoret “për të analizuar në mënyrë kritike ndërlidhjet midis ndryshimeve në fushën e medias dhe komunikimit nga njëra anë dhe ndryshimeve sociale nga ana tjetër” (Couldry dhe Hepp, 2013, faqe 197). Mattoni dhe Trere sugjerojnë se mediatizimi mund të jetë një koncept i vlefshëm në eksplorimin dhe studimin e “ndërveprimit midis proceseve mediatike dhe lëvizjeve sociale në një hark kohor të caktuar, për të kuptuar daljen në skenë të kombinimeve specifike ‘të strukturave diskursive, mediatike dhe organizative’ (Stainberg, 2004, faqe 125)” (2014, faqe 261). Mediatizimi është gjithashtu i lidhur me parimin e përgjegjshmërisë publike dhe vënien e autoriteteve para përgjegjësisë pasi tregon deri në njëfarë niveli përzierjen dhe depërtimin e politikës në media dhe medias në politikë, pra krijon hapësira për reflektime dhe analizë kritike të paralelizmave politikë, kur media në vend që të gjykojë vlerën e një lajmi për publikun i bën jehonë dhe krijon hapësira për fjalimet dhe këndvështrimet e elitave politike dhe ekonomike. Elitat e sotme politike ushtrojnë një lloj politike të mediatizuar, një politikë që ka humbur autonominë e saj funksionale dhe funksionon në varësi të medias, dhe e kundërta media është e varur nga funksioni i elitave politike (Mazzoleni dhe Schulz 1999, faqe 251). Proceset e mediatizimit gjithashtu kanë sjellë “spektakularizimin e komunikimeve politike” (po aty).

¹³ Mediacioni fokusohet në akte konkrete komunikimi nga një lloj media në një kontekst specifik, ndërsa mediatizimi i referohet “një procesi më afatgjatë, ku institucionet shoqërore dhe kulturore dhe mënyrat e ndërveprimit ndryshojnë” (Hjarvard 2008, Mattoni and Trerre 2014m p.261)

1.1. Studimi i praktikave dhe metodave të komunikimit gjatë protestave në tre vende

Ka patur shumë pak studime dhe analiza rreth procesit të komunikimit gjatë protestave popullore në tre shtete ballkanike: Shqipëri, Bosnjë Hercegovinë, dhe Maqedoni. Në përgjithësi, burimet e dorës së dytë rreth sektorit mediatik në rajon tregojnë se roli demokratik i medias është i kufizuar, si rezultat i problemeve strukturale të vetë medias. Disa raporte mbi këtë çështje e vënë theksin mbi depërtimin e politikës në media dhe një presion ekonomik gjithmonë në rritje mbi organet e medias¹⁴. Shërbimi publik që duhet të kryejë media dhe pluralizmi në raportim vihet në pikëpyetje vazhdimisht nga raportime të njëanëshme, mungesa e raportimeve investigative, mungesa e paraqitjes së opinionëve alternative dhe kritikave ndaj qeverisë, etj¹⁵. Kontrolli qeveritar ndaj medias është një faktor i përbashkët për të tre këto shtete, por ky kontroll është më drastik në Maqedoni. Në të njëjtën kohë, televizioni vazhdon të jetë burimi kryesor i informacionit për qytetarët në Shqipëri, Bosnjë Hercegovinë, dhe Maqedoni. Me rritjen konstante të përdorimit të internetit organet e mediave online kanë tërhequr më shumë vëmendjen e publikut, dhe në të gjithë rajonin, mediat online janë shtuar si kërpudhat pas shiut - disa prej tyre janë bërë shumë popullore dhe fitimprurëse, duke thithur fonde nga reklamat - por shumë pak syresh konsiderohen si suksese në fushën e gazetarisë. Disa platforma online shihen si oaze për gazetarinë e pavarur dhe

¹⁴ Shiko Petković, B. (ed), 2014. Shiko edhe raportet vjetore të Irex, Treguesi i Qëndrueshmërisë në Media.

¹⁵ Po aty.

kritike ndaj qeverisë, por disa të tjera konsiderohen thjesht si platforma publiciteti të maskuara për promovim politik apo biznesi. Rritja e aksesit në internet në të tre këto vende është ndjekur nga rritja e numrit të përdoruesve të rrjeteve sociale, kryesisht në Facebook. Sidoqoftë, janë zhvilluar shumë pak studime dhe ka ende shumë pak njohuri lidhur me ndikimin e rritjes së përdorimit të platformave online me rritjen e angazhimit politik të masave dhe mobilizimin qytetar. Disa studime të mëparshme tregojnë se platformat alternative mediatike në rajon nuk kanë fuqi politike apo ndikim në agjendën politike të një vendi (Dekić, 2010)¹⁶, dhe ndihmesa faktike e këtyre platformave në fushën e komunikimit në të tre këto vende vazhdon të mbetet shumë i kufizuar¹⁷. Sidoqoftë, nga përvoja e protestave këto vitet e fundit është vënë re se disa prej tyre ishin tejet varura nga platformat online për mobilizimin dhe organizimin e mitingjeve të protestës. Ky studim orvatet të analizojë ndërlidhjet midis protestuesve dhe platformave të ndryshme të komunikimit, dhe ky proces e meriton një rishqyrtim. Rastet e rralla të përmendjes së rolit të medias në lidhje me protestat e kohëve të fundit në këto tre vende paraqesin një tablo të zyrtë dhe nxjerrin në pah mungesën e profesionalizmit në media. Në Bosnjë Hercegovinë, për shembull, disa shkrime analitike të

¹⁶ Kjo përkon me përfundimet e nxjerra nga Hurwitz që thotë se aktivizmi online ka rritur ndjeshëm sasinë e informacionit politik në dispozicion të publikut (apo web-likut), por nga ana tjetër faqet online kanë qenë më pak të suksesshme në sigurimin e “një audience të qëndrueshme për informacione dhe tërheqjen e vëmendjes së vendimmarrësve” (faqe 102). Hurwitz gjithashtu thotë se platformat online krijojnë më shumë mundësi për aksion politik edhe midis atyre që janë politikisht aktivë dhe të mirëinformuar (Jenkins dhe Thorburn, 2003, faqe 103).

¹⁷ Shiko raportet e Treguesit të Qëndrueshmërisë së Medias.

botuara kryesisht në disa platforma online të organizatave të shoqërisë civile¹⁸, e kritikuan ashpër raportimin në media të protestave që nisën nga 6 shkurt 2014. Mediat ia kushtuan të gjithë vëmendjen e tyre akteve të pakta të dhunës dhe treguan mungesë dijenie apo indiferencë ndaj kauzës, shkaqeve dhe mesazheve që donin të përcillnin shumica dërrmuese e manifestuesve paqësorë që kritikonin punën e qeverisë, kërkonin ndryshim dhe vënien e autoriteteve para përgjegjësisë.

¹⁸ Faqe online si media.ba ose zastone.ba

2. Rreth këtij studimi

Qëllimi i këtij studimi është të kontribuojë me të dhëna dhe njohuri mbi përmbajtjen dhe raportimin e mediave mbi protestat popullore dhe këndvështrimet e aktorëve kryesorë mbi proceset e komunikimit dhe nivelin e përgjegjshëmrisë dhe vënies para përgjegjësisë në një vend (në veçanti vënien para përgjegjësisë të qeverisë, që kërkohet me forcë edhe nga protestuesit). Gjithashtu do të rishqyrtohen edhe dukuri apo prirje të identifikuara nga studime të mëparshme, si favorizimi i elitave politike nga mediat kryesore, apo potenciali i dobët i platformave mediatike alternative në rajon.

Informacioni dhe bagazhi teorik bazohet në teoritë e lëvizjeve sociale, ndërsa studimi analizon raste të vërteta nga **protestat** e viteve të fundit në tre vende të rajonit të Evropës juglindore¹⁹, dhe **plenumet** e ngritura nga protestuesit (në Bosnjë dhe Maqedoni). Protestat e analizuara në këtë studim nuk zgjatën më shumë se disa muaj, dhe kohëzgjatja e tyre ishte afatshkurtër apo në kufijtë e kohëzgjatjes afatmesme.

¹⁹ Mund të lexoni më shumë mbi përzgjedhjen e rasteve të marra në studim dhe përzgjedhjen e shembujve për vëzhgim nga secili vend në tre kapituj të këtij botimi që i kushtohen secilit nga shtetet, ndërsa këtu po prezantojmë kriteret e përbashkëta dhe parimet bazë të kërkim-studimit. Në secilin vend, një skuadër me të paktën tre veta u angazhua në zbatimin e një metodologjie të përbashkët dhe procesi studimi për vendin e tyre.

Këto protesta ishin shprehje të revoltës shoqërore, dhe disa prej tyre përdorën disa metoda të veçanta rezistence për të shprehur pakënaqësinë e tyre rreth një çështje gjatë një periudhe të caktuar kohe. Këto protesta mund të shpjegohen vetëm pjesërisht me teoritë e lëvizjeve sociale, pasi shumica e tyre nuk kishte ndonjë strukturë të organizuar apo ndonjë rrjet organizatash që ta mbante në këmbë revoltën politike, shkëmbimin e informacionit dhe ushtrimin e rezistencës civile, përtej një periudhe disaditore apo në pak muaj, dhe sipas disa studiuesve (Tilly, 1989) ky organizim është një parakusht për ekzistencën e lëvizjeve sociale²⁰.

Ka disa **përkufizime mbi protestat** në literaturë²¹, por gjatë këtij studimi protestat konsiderohen si veprime

²⁰ Përkohshmëria (me të kaluar, të tashme, dhe të ardhme) mezi përmbushet nga rastet e protestave popullore që mbulohen nga ky studim. Mattoni dhe Trere 2014 sugjerojnë se përkohshmëria afatgjatë i referohet “epokave kulturore të protestës (McAdam dhe Sewell, 2001) me disa modele të aksioneve kolektive që mund të adoptohen nga protestuesit në varësi të “repertorit të konfliktit” (Tilly, 1978, 1995)” (faqe 257).

²¹ Disa nga këto përkufizime janë: “...një aktivitet proteste është një model aksioni politik që orientohet kundër një politike apo situatë të caktuar, që karakterizohet nga shfaqje publike spektakolare apo sjellje të një natyre jo të zakonshme, dhe që ndërmerret për të arritur përfitime nga sisteme politike apo ekonomike ndërsa aktivistët vazhdojnë të jenë pjesë e po atij sistemi” (Lipsky 1968, Opp 2009, faqe 35). (2) “Një akt proteste përmbledh këto elementë: aksioni qytetar është shprehje e një pakënaqësie, dhe bindjes së masave se kundrejt tyre ka ndodhur një shkelje apo padrejtësi; protestuesit nuk janë në gjendje ta ndreqin vetë situatën; duhet kaluar në veprim që të tërhiqet vëmendja ndaj pakënaqësive; kalimi në aksion ka si qëllim që të nxisë marrjen e masave përmirësuese nga grupi apo institucioni drejt të cilit drejtohet protesta; dhe protestuesit kërkojnë të arrijnë një farë kombinimi të frikës dhe simpatisë që ta bindin grupimin apo institucionin të veprojë në të mirë të tyre” (Turner 1969, Opp 2009, faqe 35)

kolektive që synojnë të arrijnë disa objektiva të caktuara duke u munduar që të ndikojnë në vendimet e një grupimi apo institucioni të caktuar (Opp 2009, faqe 44). Për më tepër, studimi përqendrohet në protestat me sfond politik, një lloj i veçantë aksioni kolektiv – demonstrata masive, dhe shënjestra të qarta – qeveria/subjekte politike. Mund t'i referohemi edhe Girling (2004) dhe idesë së tij se demonstratat masive janë shprehje e “fuqisë simbolike të ankthit, inatit dhe mosbesimit” (faqe 146) si pasojë e ndjesisë se janë lënë në harresë dhe nuk janë në gjendje të ndikojnë në proceset vendimmarrëse.

Disa studiues i veçojnë lëvizjet sociale nga format e tjera të reagimit kundërshtues në bazë të rrjeteve shoqërore që janë në gjendje të mbajnë në këmbë aktivitete proteste, por nga ana tjetër Tarrow (2011) thotë se mbajtja në këmbë e lëvizjeve sociale bazohet në një ekuilibër të brishtë midis organizimit qendror dhe decentralizimit. Rastet e protestave të analizuar në këtë studim ndryshojnë nga njëri-tjetri në këtë pikë – disa prej tyre drejtoheshin nga struktura të organizuara lëvizjesh sociale, ndërsa disa të tjera vareshin nga pjesëmarrja e individëve apo grupeve të paorganizura. Kjo ndikon shumë në proceset e komunikimit dhe përçimin e mesazhit, dhe për pasojë edhe rekomandimet që jepen në fund të kapitullit për secilin vend mund të jenë të vlefshme vetëm për protestat e drejtuara nga struktura të qarta organizative²².

²² Në disa nga protestat e marra në analizë publiku u informua mbi çështjet problematike nga aktivistë të caktuar apo organizata të caktuara (në Maqedoni ky rol u krye nga një organizatë studentore), por në disa raste të tjera protestat nuk kishin strukturë drejtimi dhe mobilizimi kryhej nga një numër i madh individësh pjesëmarrës nëpërmjet një numri të madh kanalesh komunikimi (ashtu si në protestat e shkurtit në Bosnjë).

Elementi më inovativ në këto protesta ishin plenumet që shërbenin si forume debatesh ku idetë dhe planet e protestës diskutoheshin dhe testoheshin deri në çastin kur arrihej një konsensus i mundshëm midis protestuesve. Plenumet u krijuan si ndërthurje midis bëshkëbisedimit dhe diktutimeve “tradicionale” që realizonin komunikimin horizontal me përdorimin e mediave online për të komunikuar idetë dhe idealet e plenumit tek publiku. Plenumet dolën jo vetëm si forume ku formëzoheshin kërkesat e protestës dhe mesazhet mediatike, por ato u zhvilluan dhe evoluan në hapërsira ku prodhohej material mediatik, me fjalë të tjera “u bënë vetë media.”

Disa nga pyetjet kryesore që shtron ky studim renditen më poshtë:

- Si paraqitet kornizimi i protestës nga raportimet në media, dmth. cili identifikohet si problemi social kryesor gjatë zhvillimit të protestave, kush e identifikon këtë si problem, dhe kush preket nga ky problem?
- Si paraqitet në media dhënia e llogarisë dhe vënia para përgjegjesisë (veçanërisht për qeverinë) – sa shpesh përmendet ky koncept në raportimet në media, kush konsiderohet fajtor për një problem të caktuar apo përgjegjës për të zgjidhur një çështje? Ky studim nuk bën analizë apo kritikë të punës së qeverive, por analizon mënyrën se si raportohet apo debatohet rreth përgjegjesisë së qeverisë, nëse flitet hapur apo anashkalohet kjo çështje (duke përdorur metoda të analizës së përmbajtjes), por edhe si perceptohet nga protestuesit, gazetarët, dhe zyrtarët publikë (duke zhvilluar intervista të detajuara me gazetarë, qytetarë / aktivistë dhe zyrtarë partiakë / qeveritarë).

- Cili është perceptimi i palëve të interesuara rreth protestave, proceseve komunikuese gjatë zhvillimit të protestave, si dhe cili është mendimi i tyre rreth përgjegjshmërisë publike në vazhden e protestave?

Më poshtë janë renditur disa nga çështjet dhe pikëpyetjet themelore të studimit:

- *Roli i mediave tradicionale* gjatë protestave, komunikimi me protestuesit dhe qeverinë (jo vetëm prezantimi dhe paraqitja e protestave në media, por edhe krijimi i linjave të komunikimit dhe i gjithë procesi në prapaska: sa e hapur ishte media ndaj protestuesve, sa aktive ishte media në thithjen dhe transmetimin e informacionit, vënia në pikëpyetje e përgjegjësisë së qeverisë, angazhimi në gazetari investigative dhe raportime të thelluara, etj.);
- *roli i platformave alternative të komunikimit* gjatë zhvillimit të protestave (si gjykohet roli që kanë luajtur platformat online gjatë protestave qytetare, fokusi i raportimit të tyre, audienca, rëndësia e tyre, ndikimi politik, roli që kanë luajtur në mobilizimin e masave dhe shpërndarjen e informacionit),
- *metodat e komunikimit të zyrtarëve qeveritarë* (opinionirreth gatishmërisë për të dhënë informacion, kanalet e komunikimit, momentet e daljes para mediave, qëndrimi aktiv apo pasiv, reflektimi mbi dhënien e llogarisë, perceptimi mbi interpretimin e qeverisë ndaj protestave), dhe së fundmi,
- *komunikimi midis vetë protestuesve* (si komunikonin protestuesit me njëri-tjetrin dhe nëpërmjet cilave platforma, si i kishin marrëdhënet me gazetarët, a u munduan të përshtaten me logjikën e punës së medias – inskenimi i situatave të veçanta për të tërhequr

mediat, zbutje apo manipulime të ngjarjeve dhe aktiviteteve të ndryshme – dhe a krijuan platformat e tyre të informimit).

Kapitujt në raportet për secilin vend janë renditur në bazë të këtyre katër çështjeve të listuara më lart. Në faqet e hyrjes për secilin shtet jepet një paraqitje e shkurtër mbi ambientin mediatik në vend dhe historinë e protestave dhe aksionit qytetar. Në fund të raportit për secilin vend autorët japin disa rekomandime për të përmirësuar praktikën e punës në komunikim dhe rrjedhën e informacionit në protesta për secilën nga tri kategoritë e palëve të interesuara: protestuesit, median dhe qeverinë. Studiuesit e kuptojnë mirë se komunikimi gjatë protestave ndodh në një mjedis të tensionuar që nuk lë hapësira për zbatimin e strategjive dhe planeve të miratuara më parë si dhe që grupe të paorganizuara përfshihen në këtë proces, dhe për këtë arsye theksojnë faktin se këto rekomandime janë të zbatueshme vetëm nga grupe të organizuara, që kanë kohë të mjaftueshme dhe strukturë organizative që mundësojnë përdorimin e njëfarë strategjie komunikimi. Nga ana tjetër, rekomandimet që jepen për zyrtarët e qeverive apo partive politike, por edhe ndaj mediave, duhet të merren thjesht si tregues që diçka nuk shkon me praktikën apo politikën aktuale dhe është mirë të ndreqen, dhe jo si këshilla apo rekomandime që tregojnë si mund të zgjidhen problemet, pasi autorët e këtij studimi nuk mund të ndreqin mangësitë e sistemit që mund t'i japin përgjigje kërkesave të protestuesve.

Kapitujt që merren me secilin shtet do të trajtojnë çështje që merren me problemet dhe hapësirat strukturale për një komunikim më të mirë gjatë protestave qytetare dhe rekomandime mbi përdorimin më të mirë të medias dhe platformave online.

2.1. Vendet e përfshira në studim dhe protestat e marra në analizë

Ky studim përfshin rastet e protestave në tre vende të Ballkanit perëndimor: **Shqipëri, Bosnjë Hercegovinë, dhe Maqedoni**²³, që variojnë nga çështje ambientaliste deri te probleme sociale, dhe reforma në arsim.

Ambienti mediatik në këto tre vende është deri diku i ngjashëm, duke përfshirë ndër të tjera përzierjen e politikës në media dhe mungesën e transparencës mbi pronësinë dhe financimin e medias. Autorët e këtij studimi kanë paraqitur një tablo të ambientit mediatik në këto vende, ku është rritur përdorimi i teknologjisë së informacionit, ndërsa mediat tradicionale, në veçanti televizioni, mbeten burimi kryesor i informacionit. Gjithashtu, ndërsa përdorimi i internetit në këto vende është rritur nuk ka akoma studime që të tregojnë se sa e zhvilluar është “tradita e diskutimit politik online” (Hurwitz, 2003, faqe 101), që mundëson konsolidimin e opinionit publik dhe organizimin e aksionit politik nëpërmjet platformave online. Ka një mungesë të theksuar studimesh mbi praktikën dhe metodat e komunikimit në platformat mediatike tradicionale dhe alternative gjatë protestave popullore. Gjatë këtyre viteve të fundit ka patur një sërë protestash në të tre shtetet ballkanike, por ndërsa protestat që kërkonin ndryshim në Maqedoni dhe Bosnjë përfshinë një numër të madh protestuesish, në Shqipëri protestat kanë qenë më të rralla dhe me numër më të vogël pjesëmarrësish.

²³ Përzgjedhja e shteteve nuk është bazuar në tiparet apo në natyrën e veçantë të secilit vend apo të rasteve të marra në shqyrtim, por kjo ka ardhur thjesht si kufizim numerik dhe rastësor i këtij studimi. Studimi dhe kërkimi mbi protestat në vende të tjera të rajonit mund të jetë po kaq interesant.

Nevoja për studime dhe kërkime në fushën e komunikimit vjen nga lënia disi në harresë e rolit të medias dhe komunikimit në studimet mbi lëvizjet shoqërore, por edhe nga fakti se këto çështje nuk janë prekur gati fare në këto vende, megjithëse kultura e protestës duket se po forcohet. Protestat e kohëve të fundit në këto vende kanë pak a shumë të njëjtin fokus si ato në vendet e Bashkimit Evropian – ku shqetësimi kryesor janë çështjet me karakter social, marrëdhëniet në vendin e punës, si dhe arsimi, problemet ambientaliste si dhe aspekte të tjera që lidhen me punën e qeverisë.

Kriteret e përbashkëta në përzgjedhjen e rasteve të protestave në këto tre vende janë në radhë të parë ‘freskia’ e tyre (protesta që kanë ndodhur që nga viti 2012 e këtej), numri më i madh i demonstruesve në krahasim me raste të tjera, përfshirja e disa grupeve apo shtresave të popullsisë në këto manifestime, apo kërkesa mbi çështje që i kapërcejnë interesat e ngushta të një grupi të caktuar, dhe së fundmi, rëndësia social-politike e këtyre protestave, duke marrë në konsideratë kontekstin dhe natyrën e veçantë të secilit vend. Megjithëse në çdo vend u analizuan tre lëvizje protestash, vetëm nga një prej tyre u studiua në hollësi për secilin shtet (do t’i referohemi si rasti kryesor), ndërsa dy rastet e tjera përmenden vetëm pjesërisht, dhe përdoren më shumë për të bërë krahasime.

2.2. Metodatat e kërkimit dhe përzgjedhja e subjektit

Për të mbledhur të dhëna dhe njohuri mbi praktikatat dhe mënyrat e komunikimit gjatë lëvizjeve të protestës, ne kemi përdorur ***metodën sasiore***, që përfshin:

- **Analizë dytësore** mbi konceptet teorike dhe prirjet në metodat e komunikimit gjatë nismave qytetare (literaturë, raporte, etj), si dhe kërkime dytësore për *shtetet në fjalë* mbi ambientin mediatik dhe historinë e lëvizjeve të protestës në këto vende gjatë viteve të fundit në secilin vend (raporte, analiza, burime mediatike mbi lëvizjet sociale/ protestat: motivet, nismëtarët, rezultatet; burime mbi audiencën e organeve të ndryshme të medias – veçanërisht për ato media që janë marrë në analizë, etj.). Analiza dytësore na lejon që të ravijëzojmë prirjet dhe tendencat e proceseve të komunikimit mbi protestat dhe revoltat sociale në disa vende, dhe raporti me çështjet e përgjegjësisë qeveritare.
- **Analiza e kornizimit** të përmbajtjes mediatike. Qëllimi i analizës së përmbajtjes ishte që të mblidhte të dhëna dhe njohuri mbi mënyrën se si protestat dhe kërkesat për vënien para përgjegjësië së qeverisë paraqiteshin në kornizimin e raportimit të medias mbi protestat. Kufizimet e këtij studim-kërkimi nuk lejuan që të bëhej analiza e përmbajtjes së të gjitha platformave mediatike, dhe studimi u kufizua tek televizionet dhe mediat online (pasi televizioni vazhdon të jetë mjeti kryesor për marrjen e informacionit nga qytetarët, ndërsa burimet e lajmeve online po luajnë një rol gjithmonë e më të rëndësishëm në komunikim në të tre këto shtete; lidhjet apo tendencat politike të organeve mediatike online janë më heterogjene po të krahasohen me sektorët e tjerë mediatikë²⁴; gjithashtu audiencia apo

²⁴ Shiko në veçanti kapitullin mbi Maqedoninë.

popullariteti, si dhe lidhjet politike ishin disa nga kriteret kryesore për përzgjedhje). U përfshinë në këtë studim dy sektorë të medias, si për të evituar atë që Mattoni dhe Trere e quajnë “subjektivizmi i një mediumi të vetëm” (2014, faqe 254), ashtu edhe për të analizuar si mediat tradicionale ashtu edhe platformat sociale dhe alternative. Mediat sociale nuk janë analizuar në mënyrë sistematike, por janë nxjerrë të dhëna nëpërmjet intervistave me palët e interesuara²⁵. Përsa i përket përzgjedhjes së kanaleve televizive dhe organeve të mediave online, minimumi i kriterit për analizë në të tre këto vende ka qenë: *përfshirja e tipeve të ndryshme të medias* (publike/private), *audiencia* (u përzgjedhën televizionet dhe mediat online me audiencën më të madhe), *përfshirja e mediave të ndryshme në lidhje me qëndrimin e tyre ndaj qeverive* (media pro-qeveritare dhe pro-protestë²⁶). Në secilin vend u analizuan të paktën 50 kronika apo raportime televizive dhe të paktën 30 artikuj online.

Nga secili vend materialet e publikuara në ditët më të rëndësishme të protestave u bënë pjesë e studimit, dhe kjo analizë u kufizua në programet kryesore të lajmeve, dhe artikujt e publikuar në mediat online. Gjithashtu përzgjedhja e elementeve për analizë nuk

²⁵ Duhet patur parasysh se ky lloj vëzhgimi natyrisht paraqet mangësi në studim pasi këto të dhëna dhe informacione nuk mblidhen nga të gjitha platformat mediatike. Kërkime dhe studime të mëtejshme që do të mund të hidhnin dritë mbi përmbajtjen e platformave të tjera mediatike do të jenë të mirëpritura.

²⁶ Përzgjedhja varej nga njohja e këtyre mediave dhe kontekstit nga studiuesit.

synoi të përfaqësonte raportin e drejtë numerik të raportimit në media rreth protestave, por qëllimi ishte të mblidheshin të dhëna dhe njohuri e thelluar rreth prirjeve dhe tendencave të raportimit në media mbi këto protesta. Për këtë arsye, mostrat dhe shembujt e analizuar nga mediat në Bosnjë-Hercegovinë ishin shumë më të mëdha në numër pasi duhej analizuar edhe raportimi në media lokale, duke patur parasysh se protestat ishin shpërndarë në disa krahina, zhvilloheshin në disa qytete dhe kishin dinamika të ndryshme, dhe për pasojë secila kishte tipare të veçanta përsa i përket komunikimit²⁷. Një nga aspektet e studimit të kornizimit (*framing*) që krijoi media për protestat ishte analiza se si prezantohej në media koncepti i vënies para përgjegjësisë (kryesisht të qeverisë).

Për të minimizuar ndotjen dhe ndikimin nga imagjinata analitike e studiuesve dhe kornizimet personale të mendimit,²⁸ u krijua një procedurë sistematike për identifikimin e elementëve specifikë dhe identifikimin e kuptimit të nocioneve të ndryshme abstrakte²⁹.

²⁷ Mund të mësoni më shumë rreth shembujve të zgjedhur nga çdo shtet në kapitujt përkatës.

²⁸ Disa studiues nënvizojnë faktin se analiza e kornizave mediatike nuk do të thotë se këto korniza apo përkufizime janë evidente në përmbajtje apo në tekst, që natyrisht nuk varet nga lexuesi; në fakt është krejt e kundërta, teksti i lajmit shihet si: “përmbledhje elementesh simbolike që ndërveprojnë me kujtesën dhe logjikën e individëve për të gjetur kuptim midis rreshtave”.

²⁹ Duke u bazuar në përkufizimin e Pan dhe Kosicki mbi vlefshmërinë e analizës së kornizës mediatike (1993, faqe 58), studimi u organizua në mënyrë të tillë që të ndiqte një udhërrëfyes të detajuar, ku

- **Intervista të detajuara** u zhvilluan që të përftohej njohje e thellë mbi perceptimin e komunikimit dhe rrjedhës së informacionit gjatë protestave, dhe identifikimi i mundësive dhe problemeve nga të gjitha palët e interesuara (aktivistët, qeveria, dhe gazetarët)³⁰. Intervistat ishin gjysmë të strukturuar, me një listë të përbashkët pyetjesh por që kalonin më pas në pyetje dhe bashkëbisedim mbi tema dhe elementë specifikë të secilit vend dhe secilit të intervistuar. Gjatë këtij studimi nuk u arrit dot të kryhej analiza e përmbajtjes të platformave alternative online të përdorura nga protestuesit, por çështjet që kanë të bëjnë me platformat alternative (përmbajtja, qëllimi, proceset e krijimit

secila kategori ishte përshkruar hollësisht. Studiuesit në terren u këshilluan t'i qëndronin sa më besnikë tekstit original, që do të thotë të identifikonin mendimet me citime të sakta në tekst, dhe të jepnin shpjegime të detajuara për çdo mendim që nuk jepej me citim, si dhe një përshkrim të qartë dhe formal të imazheve. Kështu, rezultatet e studimit u bazuan mbi përdorimin dhe ngjyrimin e frazave të caktuara, imazheve, burimeve të informacionit, fjalëve kyçe, etj. Përdorimi i citimeve të sakta dhe shpjegimet e detajuara e bënë më të lehtë kontrollimin dhe korrigjimin e rezultateve të studimit gjatë procesit të analizimit të rezultateve.

³⁰ U kryen minimumi nga 20 intervista për çdo vend, apo edhe më shumë, sipas një regulli të përgjithshëm për të përcaktuar numrin e intervistave: numri i intervistave rritet nëse: a) informacioni i freskët me interes vazhdon të vijë nga palët e interesuara edhe pas 20 intervistave b) nëse ka nevojë për më tepër informacion (zgjedhje e seleksionuar mostrash dhe shembujsh) c) nëse ka nevojë për të përfshirë më shumë përfaqësues nga ndonjë prej palëve të interesuara. Intervistat e detajuara do të shërbejnë si bazë për të identifikuar platformat alternative të komunikimit të përdorura më dendur nga protestuesit/qytetarët gjatë protestave;

të informacionit, administrimi i tyre, përdorimi, efektiviteti, etj.) ishin përfshirë në intervista³¹. Për më tepër, megjithëse studimi nuk u mor me analizimin e treguesve mbi nivelin e përgjegjshmërisë dhe përgjegjësisë të qeverisë në momentin e protestave, nga intervistat dolën të dhëna dhe informacion mbi perceptimin rreth **kërkesës së llogarisë ndaj qeverisë** dhe nëse nocioni i përgjegjësisë qeveritare mendohet se ka ndryshuar si pasojë e protestave.

2.3. Koncepti i kornizimit dhe analiza e kornizimit që përdoret në këtë studim

Koncepti i **kornizimit** (*framing*) mbështetet në nocionin se të gjithë ne i klasifikojmë, organizojmë dhe interpretojmë eksperiencat tona të jetës në mënyrë që t'i kuptojmë ato më mirë (Goffman, 1974) dhe se mënyra se si këto vëzhgime futen në kornizime apo ndahen në kategori ndjell realitete të caktuara nga “kaleidoskopi i realiteteve të mundshme” (Edelman, 1993, faqe 232). Studiues të ndryshëm thonë se kornizimi ka shumë rëndësi mbi mënyrën se si perceptohet realiteti, dhe gjithashtu mund të ndikojë sjelljen

³¹ Disa nga studiuesit analizuan disa shembuj publikimesh në platforma të ndryshme, për të ilustruar disa nga prirjet apo tendencat në komunikim.

³² Për shembull, Edelman (1993) sugjeron se elementet që nënvizohen nga media gjatë raportimit mbi lëvizjet shoqërore ndikojnë në mënyrë direkte mbi zotësinë apo aftësinë e lëvizjes për të ndikuar opinionin publik dhe politikat. Në këtë këndvështrim, mediat kanë rëndësi shumë të madhe për të përçuar mesazhet drejt masës së gjerë që mund të kthehen në simpatizantë të lëvizjes, dhe për rekrutim. Përdorimi në rritje i platformave në internet ka patur një ndikim të madh mbi

e individit³². Strategjitë e kornizimit janë të rëndësishme jo vetëm për pozicionimin ideologjik, por ashtu si thonë Benford dhe Snow (2000) ato ndikojnë në rektutimin, mobilizimin dhe gatishmërinë për t'u hedhur në veprim³³.

Ndërtimi i kuptimit³⁴ në lëvizjet sociale nëpërmjet procesit të futjes në kornizë përfshin një mori faktorësh, kornizash, dhe transformim të besimeve kolektive. Faktorët shoqërorë përpriqen herë pas here të ndikojnë në ndërtimin e mendimit, por kornizimet dominante në një shoqëri të caktuar mund edhe të kopjohen³⁵ apo mendimet dominante mund

jetën politike: përsa i përket aksesit në informacion, zgjedhjeve dhe fushatave elektorale, komunikimi midis kandidatëve dhe zgjedhësve të tyre, kushtimi i vëmendjes ndaj çështjeve më të rëndësishme për popullatën, si dhe përpjekjet e aktivistëve për të përçarur mesazhet e tyre. Jenkins dhe Thorburn (2003, faqe 4) përmendin rastin e *indymedia.org*, që filloi ekzistencën e saj si një lloj agjencie gjatë protestave në Seattle kundër Organizatës Botërore të Tregtisë, për të promovuar idetë dhe lajmet rreth protestës duke përdorur metodën e multim medias (duke postuar shkrime, fotografi, regjistrime audio dhe video).

³³ Studimi mund të analizojë se deri në çfarë pike eksperiencat, simbolet dhe modelet e lëvizjeve sociale dhe protestave po krijojnë njëfarë «komuniteti epistemik» (Lipshutz, 2005), duke ushqyer luftën sociale dhe duke transferuar njohuri drejt komuniteteve brenda dhe jashtë vendit sidomos nëpërmjet përdorimit të platformave online.

³⁴ Klandermans (1992) thotë se kemi tre procese të ndërlidhura në ndërtimin e kuptimit në lëvizjet sociale: ligjëratën publike, komunikimet propagandistike dhe ngritjen e ndërgjegjes (Johnston dhe Klandermans, 1995, faqe 10).

³⁵ Disa korniza mund të fitojnë një status vetë-përforsues, dhe ashtu si thotë edhe Gamson (1992) ato mund t'i vishen termave të veçantë që përdoren gjerësisht në jetën e përditshme (një shembull i tillë mund të jetë fjala “sigurimi”). Kur ndodh diçka e tillë, komunikuesi që përdor një term të ndryshëm mund të mos kuptohet drejtë dhe mund të perceptohet si tip i dyshimtë të cilit nuk i duhet besuar.

të vihen në diskutim dhe në dyshim. Studiuesit e lëvizjeve sociale bien dakord me idenë se lëvizjet sociale krijojnë kuptimet e tyre kolektive (që quhen edhe kornizime, paketa ideologjike apo ligjërata kulturore) që frymëzojnë aksione kolektive (Tarrow, 2011, faqe 31). Në periudhat e lëvizjeve sociale, apo forma të tjera konflikti politik, këto kuptime janë në konkurrencë të hapur me kornizimet e kundërta. Beteja mbi mendimin është një pjesë e rëndësishme e politikës disidente³⁶. Tarrow thotë se një nga faktorët kryesorë të mbajtjes në këmbë dhe suksesit të lëvizjeve sociale është "... aftësia e tyre për të lidhur eksperiencat dhe përvojat e jetës me nevojën për aktivizëm" (2011, faqe 266).

Media konsiderohet të luajë një rol kritik mbi faktin se cili kornizim do të jetë më dominant në shoqëri. Kornizimi gjithashtu konsiderohet si pjesë përbërëse e punës së gazetarit (Gitlin, 1980³⁷). Kornizimet në media zakonisht reflektojnë marrëdhëniet me pushtetin, dhe nxjerrin në pah palët rivale dhe interesat që luftojnë për të dominuar tekstin. Kornizimet dominante në shoqëri ndikojnë mënyrën se si lajmi futet në korniza. Në lidhje me mënyrën se si media zakonisht kornizon lëvizjet sociale, Entman dhe Rojecki (1993) mendojnë se gjykimet dhe vendimet mbi kornizimet që gazetarët vënë mbi lajmin, apo raportimin rreth lëvizjeve sociale, janë shumë të ndikuara nga burimet

³⁶ Tarrow thotë se lëvizjet sociale e gjejnë veten shumë shpesh në dizavantazh duke qenë se shteti ka në dispozicion të tij instrumente për ndërtimin e mendimit (2011, faqe 32)

³⁷ Gitlin e lidh konceptin e kornizës në mënyrë të drejtpërdrejtë me prodhimin e lajmit, dhe thotë se kornizat "i lejojnë gazetarët që të përpunojnë një sasi të madhe informacioni me shpejtësi dhe në mënyrë rutinë [dhe të] pakëtojnë informacionin për konsum të shpejtë nga audienca" (1980, faqe 7).

elitare të informacionit. Ata gjithashtu tërheqin vëmendjen mbi dyzimin e gazetarëve kundrejt lëvizjeve masive të popullatës – në teori mund të jenë mbështetës të këtyre lëvizjeve, por në realitet janë mosbesues ndaj aksioneve masive që organizohen për të fituar dhe ushtruar pushtet politik (Gitlin, 1980, Entman dhe Rojecki, 1993, faqe 156)³⁸. Sidoqoftë, disa studiues të tjerë e vënë theksin më tepër mbi potencialet transformuese në procesin e kornizimit dhe ndërveprimin me ndërtimin e mendimit³⁹. Njëpërmjet “bashkëveprimet dhe shkëmbimeve komplekse midis medias dhe faktorëve shoqërorë, si lëvizje sociale, kundërlëvizje sociale, parti politike dhe autoritete shtetërore, si dhe ndërveprime të rangut personal në rrjete sociale dhe grupe shoqërie — mendimi ndërtohet dhe rindërtohet” (Johnson dhe Klandermans, 1995, faqe 10). Protestat nxitin strukturat

³⁸ Entman dhe Rojecky (1993) identifikuan korniza gjykimi kundër lëvizjeve të protestës, por nga ana tjetër kornizat e gjykimit kundrejt elitave që drejtonin politikën e jashtme zakonisht nuk pasqyroheshin në raportimet e gazetarëve gjatë lëvizjeve antibërthamore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

³⁹ Lëvizjet sociale formëzohen nga njëra anë nga aspekte të kulturës dominante, por nga ana tjetër prirën që të shkëpusin lidhjet dhe respektin mbi normat dominante në shoqëri dhe ta ndryshojnë kulturën dominante (shiko Johnston dhe Klandermans, 1995). McGee mendon se lëvizjet sociale po ndryshojnë mendimet në botë dhe po ndryshojnë realitetin (McGee, 1975, faqe 243). Shiko gjithashtu Livingstone, 1990. Duhet patur parasysh se kjo ngre pikëpyetje rreth besueshmërisë dhe vlefshmërisë të analizës së kornizës, duke patur parasysh mënyrën se si identifikohen kornizat në tekst gjatë analizës së kornizës, pasi kjo ndikohet nga kornizat individuale të vetë studiuesit. Ne nuk mund të deklarojmë se i kemi shmangur plotësisht këto ndikime dhe influenca, por kemi marrë masa që të sigurohemi që studiuesit të kenë arritur në të njëtin kuptim për sa i përket kategorive të analizës.

dominante të mendimit dhe debatit por ato janë gjithashtu një terren pjellor për kultivimin e sfidave ndaj perceptimeve dhe praktikave të vjetra, dhe për pasojë i kundërvihen strukturave dominante të mendimit, si dhe mundësojnë (ri)ndërtimin e identiteteve kolektive (Melucci, 1996). Gjatë zhvillimit të protestave përdoren strategji të ndryshme kornizimi për të prezantuar ndaj publikut punën e qeverisë, si dhe motivet, manifestimet, aksionet dhe qëllimet e protestuesve. Roli i lëvizjeve sociale, marrëveshjet e brendshme dhe komunikimi me jashtë nëpërmjet mediave tradicionale dhe platformave të protestës, nuk duhet lënë pas dore kur marrim në konsideratë vështirësitë dhe avantazhet që ndeshin lëvizjet sociale gjatë procesit të komunikimit⁴⁰.

Analiza e kornizimit në këtë studim bazohet në njohuritë teorike të kornizimit si një proces që përmbledh diagnostikimin e problemeve nga njëra anë dhe rekomandimin e zgjidhjeve nga ana tjetër. Për shembull, Gamson (1992) flet rreth diagnostikimit, vlerësimit dhe rekomandimit të disa zgjidhjeve të veçanta mbi mënyrën se si futet në kornizë realiteti shoqëror. Entman e përkufizon procesin e kornizimit pak a shumë në të njëjtën mënyrë: “Kornizimi është të seleksionosh disa aspekte të një realiteti të perceptuar dhe t’i nxjerrësh më të spikatura në një tekst komunikues, në mënyrë të tillë që të promovohet një përcaktim specifik mbi një problem, interpretim rastësor, vlerësim moral, dhe/apo rekomandim trajtimi për çështjen e përshkruar “ (1993, faqe 52.). Analiza në këtë studim fokusohet pra në këto dy kategori kryesore: a) mënyra si identifikohet dhe përkufizohet një problem (me një fjalë: diagnoza) nga njëra anë, dhe b) si prezantohet në media prognoza/zgjidhja e

⁴⁰ Lexo McCurdy, 2010.

këtij problemi. Përtej këtyre kategorive kryesore, analiza gjithashtu identifikon faktorët që preken nga ky problem, faktorët që kanë identifikuar problemin / zgjidhjen, dhe së fundmi normat dhe gjykimet që mbështesin një diagnozë / prognozë⁴¹ të caktuar. Këtu kemi ndjekur përkufizimin e Verloo (2005: 20) që e shpjegon kornizimin si “instrument organizativ që transformon copëza informacioni fragmentare apo rastësore në një problem të strukturuar dhe të kuptueshëm, që përfshin në vetevete, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, edhe zgjidhjen.” Me fjalë të tjera: çdo tekst mund të analizohet në mënyrë të tillë që të identifikohet problemi që trajton, dhe çfarë zgjidhjeje afrohet për problemin e identifikuar.

Për të kuptuar pjesërisht ndërveprimin midis aspekteve të ndryshme të komunikimit dhe për të paparaqitur këndvështrime të ndryshme mbi kornizimet e protestave dhe rrjedhën e informacionit, metoda e analizës së kornizimit të medias (televizion dhe internet) u kombinua me intervista të detajuara me pjesëmarrës të procesit të komunikimit: qytetarë/protestues, gazetarë dhe autoritetet partiake/ qeveritare⁴².

⁴¹ Natyrisht, jo të gjitha kategoritë e kornizave u identifikuan në çdo tekst.

⁴² Sidoqoftë, në këtë studim nuk sqarohen lidhjet e kornizave në raportime me qëllimet dhe kornizat individuale të komunikuesve të veçantë, dhe nuk ka patur analiza të mënyrës se si kornizat kanë hedhur dritë rreth qëndrimeve dhe sjelljeve të protestuesve apo të palëve të tjera të interesuara.

3. Rezultatet kryesore të studimit në tre vende: Tablo e përgjithshme

3.1. Si i ka vendosur media në kornizë protestat, si u perceptuan ato nga të intervistuarit?

Opinioni dominant midis të intervistuarve është se protestat janë shprehje e demokracisë, një mënyrë legjitime për të shprehur vullnetin e masave dhe pakënaqësinë e tyre rreth punës së qeverisë dhe zyrtarëve të zgjedhur, për të kërkuar ndryshim apo për të ndaluar ndryshimin e politikave të caktuara, si dhe për të kërkuar standarde më të larta të përgjegjësisë qeveritare. Ato konsiderohen shumë të rëndësishme sidomos kur qeveritë janë të paafta për të kryer funksionin e tyre, dhe protestat mbeten “e vetmja zgjidhje legjitime.” Nga ana tjetër, disa nga të intervistuarit i shohin protestat si tregues të mungesës së demokracisë, pasi në demokracitë e shëndetshme përfshirja e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes është diçka normale dhe protestat janë të panevojshme. Një pikë tjetër në favor të protestave popullore është se ato kanë fuqi të mbledhin bashkë grupe dhe masa të ndryshme për një qëllim të përbashkët, ashtu si ndodhi në disa nga protestat në Bosnjë Hercegovinë, dhe Maqedoni ku u kapërcyen barrierat e ndarjeve etnike. Protestuesit i bashkuan kritikën dhe pakënaqësia ndaj politikave sociale dhe punës së qeverisë. Pakënaqësitë në Bosnjë Hercegovinë kishin të bënin me çështje sociale dhe varfërimin e qytetarëve nga politikën e klasës udhëheqëse

që kishin humbur kontaktin me masat. Ashtu si tha edhe një aktivist në Bosnjë Hercegovinë mesazhi i qartë nga protestat e shkurtit 2014 ishte: “Nuk më intereson fare nacionalizmi, dua që fabrikat të punojnë, dhe që punëtorët të kenë të drejtë të vendosin sërish mbi fatin e tyre...”. Nga ana tjetër, ashtu si doli edhe nga të dhënat e studimit, ndarjet etnike ishin të pranishme në raportimin në media, ndërsa kornizimi mediatik dhe perceptimet e zyrtarëve punonin fort për t’i përforcuar këto dasi në disa nga rastet e marra në analizë.

Sidoqoftë, të intervistuarit, sidomos zyrtarët, pjesërisht përfaqësuesit e medias dhe disa herë edhe nga vetë protestuesit, i minimizojnë këto elemente pozitive të protestave kur komentojnë rastet specifike të analizuara në këtë studim. Në total, ka tre kornizime dominante që vënë në pikëpyetje rolin e këtyre protestave:

- kornizimi i instrumentalizimit politik të protestave për interesat e ndonjë grupi të veçantë politik apo të ndonjë partie, më shpesh të opozitës, por ndonjëherë fajësohet edhe elementi i huaj.
- Kornizimi i mangësive brenda grupit të protestuesve (mungesa e organizimit, eksperiencës dhe aftësive). Një ilustrim i këtij kornizimi është edhe pretendimi se protestuesit në Bosnjë nuk kishin njohuri të mjaftueshme mbi funksionimin e sistemit politik dhe kjo e bëri të pamundur suksesin e protestave. Dhe së fundmi,
- kufizimet dhe mangësitë strukturore, pjesë përbërëse e sistemit politik (deri diku edhe atij mediatik) që i konsideron protestat të pasuksesshme dhe pengon ndryshimet e politikave ngalart-poshtë. Të intervistuarit, sidomos ata në Maqedoni dhe Bosnjë, janë të mendimit se protesat nuk sollën ndryshimet e pritura për arsye se qeveria nuk vihet para përgjegjesisë.

Kornizimet e medias mbi protestat e analizuara në Bosnjë Hercegovinë dhe Maqedoni përkojnë deri në njëfarë shkalle me kritikën e vetë protestës. Kornizimi i instrumentalizimit politik është mjaft dominante në vënie në kornizë të protestave nga ana e medias. Nga mënyra se si media i vuri në kornizë rastet e protestës⁴³, mund të dalloheshin dhe deshifroheshin lehtë strategjitë e perfeksionuara në vite të delegjitimitimit që përdoren shpesh dhe lehtësisht nga media. *Georgievski*, *Adonov* dhe *Trajkoska* vunë në dukje se në Maqedoni, pa ndonjë surprizë të madhe dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, mediat që njihen për politikën e tyre editoriale proqeveritare raportuan në mënyrë negative mbi kërkesat e protestuesve dhe motivet e tyre, dhe u munduan t'i diskreditonin ata me kornizimin e instrumentalizimit politik dhe ndërhyrjen e ndërkombëtarëve, rol që zakonisht luhet nga fondacioni Soros. Ashtu si del edhe nga rezultatet e studimit nga *Cvjetičanin*, nënkornizimet e protestave të shkurtit, përveç kornizimit të përgjithshëm të instrumentalizimit politik, ishin të shumëllojshme, si një pasqyrim i kompleksitetit të organizimit administrativ të vendit dhe dasive etnike. Fokusimi ishte më shumë tek instrumentalizimi etniko-politik, sesa përdorimi i protestave për përfitim thjesht politik nga partitë opozitare. Kishte një prirje të qartë për t'i paraqitur protestat si një sulm kundër interesave kombëtare të një prej tre grupeve etnike kryesore, pra edhe kundër autoriteteve qeveritare të lidhura ngushtë me identitetin dhe interesat e atij grupi etnik. Rezultatet

⁴³ Kur përdoret një sintaksë e ngjashme në të gjithë publikimin, nuk do të thotë se i referohemi të gjithë përmbajtjes në media. Ashtu si përmendën edhe më parë, të dhënat dhe informacioni nuk mund të përdoren për përgjithësim, por thjesht që të tregojnë disa prirje të raportimit në media mbi protestat popullore.

e studimit në Bosnjë Hercegovinë janë të ngjashme me studime të mëparshme të kësaj natyre që tregojnë se mediat përqendrohen kryesisht te dhuna gjatë protestave.⁴⁴ Dhe në të vërtetë, dhuna e ushtruar nga protestuesit dhe dëmtimi i pronës publike ishte kornizimi dominant në ditët e para të protestave të shkurtit në Bosnjë, dhe një nga kornizimet dominante të të gjitha raportimeve. Cvjetičanin nënvizoi faktin se pamjet nga aktet e dhunës mbizotëruan raportimin në media gjatë gjithë periudhës së protestave.

Në veçanti, në Maqedoni studiuesit vunë re një ndarje të theksuar midis mediave proqeveritare dhe mediave që raportuan në mënyrë më të favorshme mbi protestat, pra media që zakonisht konsiderohet si e pavarur dhe më kritike ndaj partive politike në pushtet. Këto të fundit i dhanë më shumë hapësirë prezantimit të motiveve dhe arsyeve të protestës, raportuan më gjerë mbi punën e plenumeve dhe, deri në njëfarë niveli, kritikuan qeverinë për punë të dobët. Në lidhje me kornizimet mbi studentët protestues në Maqedoni, Georgievski, Adonov dhe Trajkoska thonë: *“mediat që janë kritike ndaj qeverisë i vënë reformat në korniza [reformat e qeverisë në arsim që kundërshtoheshin nga studentët] që i paraqesin si të nxitura, joproduktive, dhe në shkelje të autonomisë universitare.”*

Protestat kundër shkatërrimit të armëve kimike në Shqipëri në vitin 2013 ndryshonin shumë me protestat në Bosnjë dhe Maqedoni përsa i përket komunikimit – raportimet në media u përqendruan në mënyrë maksimale mbi zhvillimin e protestave dhe kërkesat e protestuesve, ndërsa burimet zyrtare shfaqeshin shumë rrallë. Ashtu si u raportuara nga Londo, gati të gjitha organet e medias, pavarësisht nga ngjyrimet dhe

⁴⁴ Lexo McChesney, 2008; McCurdy, 2010

simpatitë politike, me raportimet e tyre i dhanë legjitimitet kërkesave të protestuesve. Mund të ketë dy arsye për këtë: së pari, protestat nuk u angazhuan në kritika të përgjithshme të punës së qeverisë dhe vëmendja e tyre ishte drejtuar vetëm te një çështje e caktuar dhe vendimit të qeverisë në lidhje me të, dhe së dyti, zyrtarët e qeverisë gati nuk u përfshinë fare në diskutime publike mbi këtë çështje dhe për pasojë i lejuan më shumë hapësira protestuesve që të shfaqnin shqetësimet e veta. Në këto rrethana, në ndryshim me protestat në Bosnjë dhe në Maqedoni, raportimi u përqendrua te çështjet e ngritura nga protestuesit dhe kërkesat e tyre: media u fokusua në problemet e mundshme që mund të dilnin nga shkatërrimi i armëve kimike në territorin e Shqipërisë, në kornizimin e rrezikut ndaj shëndetit dhe jetës, dhe deri diku si problem i mungesës së transparencës dhe përgjegjësisë nga ana e qeverisë në lidhje me vendimin nëse këto armë duheshin shkatërruar në Shqipëri apo jo. Ndërsa kornizimi i instrumentalizimit politik ishte dominant në rastet e tjera të protestave qytetarë në Shqipëri, në këtë rast ishte shumë pak e pranishme, dhe më shumë në formën e rrezikut se opozita mund të instrumentalizonte protestën, dhe disa herë u hodh ideja se mbase zgjidhja e këtij problemi ishte të ndalohej pjesëmarrja e politikanëve në protesta. Zgjidhjet ndaj problemeve të ngritura në protesta ishin gjithashtu të thjeshta dhe të drejtpërdrejta, në kornizimin e kundërshtimit të shkatërrimit të armëve kimike në territorin e Shqipërisë, dhe funksionim më transparent dhe të përgjegjshëm të qeverisë mbi çështje të tilla.

Perceptimi i raportimit në media të protestave qytetare në të tre vendet ishte në përgjithësi negative, sidomos perceptimi i vetë qytetarëve/protestuesve. Opinioni i përgjithshëm është se mbulimi në media varion nga raportimi i politizuar rëndë i protestave deri tek raportimi politikisht korrekt por

sipërfaqësor, që nuk arrin të japë informacione të thelluara dhe tablo të plotë të problemeve të shprehura në protesta (si për shembull analizë të papunësisë apo korrupsionit në Bosnjë, apo një analizë të (dis)avantazheve të reformave të sistemit arsimor të propozuara në Maqedoni).

Elementi i përbashkët nga intervistat nga të tre vendet ishte se mediat online konsiderohen janë më të hapura kundrejt prezantimit të protestave, dhe ky opinion shoqërohet nga perceptimi se mediat e tjera janë më pranë qeverisë, në veçanti me partitë politike dhe qendra të tilla të pushtetit politik dhe ekonomik.

Autorët e këtij studimi gjithashtu kanë vënë re se futja në korniza e protestave ndryshon nga rasti në rast. Për shembull, në rastin e protestave kundër arrestimit të gazetarit Kezarovski në Maqedoni, zyrtarët dhe media, si ato proqeveritare ashtu dhe ato kritike ndaj qeverisë, duket se e braktisën kornizimin e instrumentalizimit politik ndaj protestave, dhe autorët e këtij studimi besojnë se kjo erdhi ngaqë protestuesit kësaj radhe ishin vetë gazetarët dhe futja në kornizë e protestave u ndikua shumë nga solidariteti profesional. Mediat që konsideroheshin si “proqeveritare” nuk i diskredituan protestat, ndërsa mediat më kritike ndaj qeverisë ishin më aktive në përpjekjet për të liruar Kezarovskin. Një arsye tjetër është se këto protesta ishin më pak antiqeveritare sesa protestat studentore, dhe ishin të fokusuar në një fushë të caktuar të vendimeve të qeverisë dhe nuk u angazhuan në kritika të përgjithshme ndaj qeverisjes, kështu që nuk përbënin ndonjë kërcënim real për pushtetarët. Në Bosnjë Hercegovinë, protestave kundër shkatërrimit të një parku në një qytet, që u mbajtën në vitin 2012, nuk iu kushtua aspak rëndësi nga mediat kryesore në Republika Srpska. Raportimet ose ishin shumë të rralla ose informacioni transmetohej në formën e lajmeve të shkurtra

të marra nga agjencitë e lajmeve. Protestat mbështeteshin vetëm nga media të vogla të pavarura dhe komunikimi nëpërmjet platformave online, por nga intervistat doli se kjo ishte shumë pak për të arritur mbështetje më të madhe popullore.

3.2. Si kornizohet në media koncepti i përgjegjësisë publike dhe çfarë thonë të intervistuarit mbi këtë çështje?

Nga të dhënat e raporteve nga të tre vendet vihet re se raportimi në media mbi protestat qytetare ka prekur deri diku çështjet e përgjegjshmërisë në qeverisje dhe vënien para përgjegjësisë të autoriteteve. Sidoqoftë, mënyra se si tematizohet vënia para përgjegjësisë është shumë e kufizuar. Nga tre raportet kombëtare që u publikuan në këtë studim janë identifikuar si problematike disa aspekte të raportimit në media: vënia para përgjegjësisë përmendet si koncept i përgjithshëm dhe nuk drejtohej ndaj institucioneve të caktuara, partive politike apo zyrtarëve (kjo vihet re më shumë në Bosnjë), dhe referimi ndaj vënies para përgjegjësisë bëhej vetëm kur kjo përmendej nga burime të rëndësishme informacioni; dhe kjo e fundit është edhe më problematike pasi zyrtarët kanë shumë më tepër akses në media sesa protestuesit. Kjo ishte shumë e dukshme në Bosnjë, ku sulmet dhe akuzat e paqena kundër protestave u raportuan dendur në media, duke përfshirë edhe informacione të rreme rreth sasive të mëdha të drogës që ishin shpërndarë midis protestuesve apo plaçkitjen e dyqaneve të një qendre tregtare. Nga rezultatet e analizës së përmbajtjes në media, në veçanti në Maqedoni, mediat kryesore proqeveritare, nuk i përmendnin fare çështjet e ngritura nga protestuesit, dhe

nuk e prekën fare diskutimin mbi vënien para përgjegjesisë të qeverisë, dhe e gjitha kjo nën fasadën e kornizimit të instrumentalizimit politik të protestave.

Sidoqoftë, në rastet nga Bosnja dhe Shqipëria, rezultatet e analizës së përmbajtjes treguan se në shumicën e rasteve qeveria ishte identifikuar si përgjegjëse për “problemin” që ka shkaktuar protestën. Në Bosnjë vënia para përgjegjesisë zakonisht përdoret vetëm si koncept në terma të përgjithshme kundër elitave politike, por në disa raste drejtohet edhe ndaj institucioneve qeveritare, partive politike dhe figurave politike të veçanta; vënia para përgjegjesisë paraqitet si kërkim llogarie për problemet sociale që kanë shkaktuar protestën, apo si kërkim llogarie për reagim të plogët ndaj protestave dhe kërkesave të protestuesve, në rast përshkallëzimi të protestave. Në Shqipëri, ishte kryeministri dhe qeveria që u vendosën në kornizë si fajtorë për “problemin” e “vënies në rrezik të shëndetit publik nga që morën në konsideratë shkatërrimin e armëve kimike (52 raste), për mungesë transparence (20 raste) dhe kërkesë llogarie (2 raste),” siç u raportua nga *Londo*. Në Shqipëri, vënia para përgjegjesisë dhe kërkesa e llogarisë përkonte me mënyrën se si problemi u vendos në kornizë në përmbajtjen në media, ku qeveria shihej si përgjegjëse për pasivitet dhe mungesë transparence në rastin e shkatërrimit të armëve kimike, dhe zgjidhja ishte heqja dorë e qeverisë nga këto praktika pune dhe të refuzonte shkatërrimin e armëve në territorin shqiptar. Gjatë protestave të shkurtit në Bosnjë u vu re një divergjencë më e madhe në prezantimin dhe kornizimin e kërkesës së llogarisë. Kërkesa e llogarisë ndaj qeverisë, nën kornizimin e qeverisjes së keqe, u trajtua si nevojë për më shumë kërkesë përgjegjësie në përgjithësi, për dorëheqje, zgjedhje të parakohshme, ndryshime kushtetuese, reforma të administratës publike, krijimin e vendeve të

punës, rishikimin e privatizimeve, heqjen e privilegjeve të zyrtarëve shtetërorë, përfshirjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse, etj. Gjithashtu, në disa raste qeveria shihej si përgjegjëse për të zgjidhur një problem që vinte në rrezik interesat kombëtare, për shembull që protestat të mos përhapeshin në Republika Srpska apo të mos vihej në rrezik administrata e pushtetit lokal. Në një rast tjetër, përgjegjësia iu vesh një grupi etnik – ‘të qëndrojmë të bashkuar për të mbrojtur interesat kombëtare.’ Gjithashtu, media vuri në kornizë përgjegjësinë e qytetarëve si zgjidhje për ndalimin e dhunës por edhe për bashkimin kundër qeverisjes së keqe.

Në Maqedoni, në përgjithësi nuk përmendej kërkesa e llogarisë ndaj qeverisë gjatë raportimit në media mbi protestat e studentëve. Gjithashtu, vihej re një ndryshim i madh midis raportimit të dy grupimeve të ndryshme mediatike rreth këtij subjekti, ku *Telma*, *Alsat-M*, *novatv.mk* dhe *plusinfo.mk* e përmendnin më shpesh vënien para përgjegjësisë të qeverisë dhe ministrisë së arsimit për reformat e propozuara dhe mungesën e transparencës, dhe nga krahu i kundërt ishin rreshtuar *Kanal 5*, *MTV1*, *Sitel* dhe *Kuruir.mk*, që fajësonin Unionin Social Demokrat të Maqedonisë (SDSM), fondacionin Soros, studentët dhe mediat “opozitare” si përgjegjës për protesta të kota dhe të paarsyeshme.

Referencat ndaj përgjegjësisë së qytetarëve/protestuesve në Shqipëri morën një formë tjetër, pati disa referenca ndaj përgjegjësisë së tyre me kornizën e protestimit të paarsyeshëm dhe të keqinformimit të tyre, ndërsa pati edhe disa referenca mbi përgjegjësinë e tyre për mobilizim më të madh në protesta.

Në Bosnjë Hercegovinë, në disa media raportimet u përqendruan te problemet midis vetë protestuesve, më shumë mbi aktet e dhunës në protesta, dhe protestuesit u quajtën përgjegjës për shkatërrimin e pronës publike. Cvjetičanin

del me përfundimin se mungesa e kërkesës së llogarisë ndaj elitave politike manifestohet me mungesën e vetëreflektimit nga zyrtarët në shembujt e marrë në analizë nga raportimet në media, pasi në shumicën dërrmuese të rasteve i referohen përgjegjësisë së protestuesve për dëme materiale; apo hedhja e përgjegjësisë te “të tjerët” (duke përfshirë udhëheqësit e partive kundërshtarë, grupet e ndryshme etnike, agjentë të huaj, etj.), që identifikohen si përgjegjës për politizimin e protestave apo për vënien në rrezik të interesave kombëtare. Sidoqoftë, nga të gjithë shembujt e marrë nga raportimet në media në Bosnjë, zyrtarët përmenden më shpesh si përgjegjës për zgjidhjen e problemeve, zakonisht të problemeve social-ekonomike që ishin shkaktare të protestave.

Të intervistuarit nga të tre shtetet tregojnë se ka një mungesë të theksuar të kërkesës së llogarisë ndaj qeverisë dhe komunikimi i zyrtarëve gjatë protestave nuk tregonte aspak transparencë dhe marrje përgjegjësie nga ana e qeverisë. Një pjesë e të intervistuarve nxori në pah faktin se vetë protestat janë tregues të mungesës së vënies para përgjegjësisë të qeverisë. Shumë nga të intervistuarit vërejnë se koncepti dhe qëndrimi ndaj përgjegjësisë dhe kërkesës së llogarisë ndaj qeverisë mbeti i pandryshuar gjatë dhe pas protestave popullore. Të intervistuarit identifikojnë dy probleme kryesore që sollën dështimin në rritjen e kërkesës së llogarisë ndaj autoriteteve shtetërore: e para ka lidhje me vetë protestuesit (mobilizim i pamjaftueshëm, mungesë këmbëngulje, dalja me kërkesa të paqarta, jo të unifikuara, jo jorealiste, etj.); dhe e dyta ka të bëjë me çimentimin e disa mendësive dhe praktika të ngulitura thellë në mungesën e dhënies së llogarisë nga qeveria, dhe këto dolën më të forta sesa sfidat dhe opozita nga protestuesit. Të gjendura para këtyre situatave reagimi i qeverisë në secilin nga të tre shtetet ishte natyrisht rezistencë tipike sistemi ndaj ndyshimit.

Këto reagime varionin nga injorimi i protestave, krijimi akuzave dhe trillimeve kundër protestave dhe protestuesve (duke përfshirë insinuata mbi instrumentalizim politik apo kriminalizim të protestuesve), fajësimi i partive të tjera, grupimeve etniko-politike, apo zyrtarëve të tjerë (kjo ndodhi kryesisht në Bosnjë), dhe vetëm në çastin e fundit vinte ndonjë lëshim i vogël - ndryshime apo reforma të parëndësishme që erdhën pas presioneve të forta dhe frikës nga përshkallëzimi i protestave. Disa nga intervistat përshkruajnë shumë qartë reagimet e zyrtarëve shtetërorë ndaj protestave: *“Zyrtarët shtetërorë zakonisht nuk janë shumë aktivë kur vjen fjala te protestat; lëvizin ngadalë, me zor të dëgjojnë, apo thjesht bëjnë sikur duan të të kuptojnë apo të marrin seriozisht, por edhe kjo ndodh vetëm nëse protestuesit janë aq këmbëngulës sa t’i bezdisin. Edhe kur dalin me ndonjë deklaratë publike nuk reflektojnë aq sa duhet dhe reagojnë dobët ndaj protestave. Deklaratat e tyre janë thjesht retorikë dhe nuk përmendin fare zgjidhjet apo alternativat që ofrohen nga protestuesit.”*⁴⁵ Apo e thënë ndryshe me fjalët e *Cvjetičanin*, nga të dhënat dhe informacionet e marra në intervista del se zyrtarët tregojnë mangësi të theksuar përgjegjshmërie dhe përgjegjësie nëpërmjet *“politikës së injorancës, politikës së arrogancës* dhe madje tregojnë edhe se *u vjen pështirë nga njerëzit që i kanë zgjedhur.”*

Të dhënat nga intervistat nga të tre vendet tregojnë se gjatë protestave të kohëve të fundit zyrtarët u angazhuan shumë rrallë në komunikim dypalësh nëpërmjet medias apo kontakteve direkte me protestuesit. Në rastin e shkatërrimit të armëve kimike në Shqipëri, zyrtarët shtetërorë nuk komunikuan fare me publikun edhe pse kishin kaluar disa ditë që nga fillimi i protestave. Kryeministri lëshoi një deklaratë

⁴⁵ Intervistë me Sazan Gurin, ambientalist shqiptar;

në Facebook disa ditë pas flimit të protestave, ndërsa një deklaratë në televizion u dha vetëm pas këtij komunikimi të pare online.

Përsa i takon gjuhës së përdorur dhe përmbajtjes të komunikimeve nga zyrtarët, deklaratat e tyre shpesh përmbajnë elemente të fortë paternalistë. Deklaratat e zyrtarëve në Shqipëri e manifestuan këtë paternalizëm kur pretenduan se protestuesit e kishin gabim, se protestat erdhën si pasojë e mungesës së informacionit të duhur dhe një mungese të papërligjur besimi se qeveria mund të punonte në të mirë të interesit publik. Pretendime dhe akuza të tilla u shpërndanë në media edhe gjatë protestave të studentëve në Maqedoni. Në Bosnjë, intervistat treguan se zyrtarët u munduan t'i degradonin dhe denigronin protestat në mënyra të ndryshme, shpesh duke evokuar marrëdhëniet e kohës së luftës, e shoqëruar me ndjelljen e frikës dhe ndjenjat etno-nacionaliste. Së fundmi, në Maqedoni, megjithë klimën e sekreteve dhe fshehtësisë nga ana e qeverisë dhe refuzimit për t'u takuar me studentët, pati disa incidente dhe polemika që ilustronin mungesën e përgjegjshmërisë nga ana e qeverisë, të paraqitura nga mediat kritike ndaj qeverisjes: si për shembull, raportimet se tezat e provimit të shtetit kishin dalë disa muaj përpara se të bëheshin publike, dhe se vendi i zhvillimit të një takimi publik me përfaqësues të universitetit u ndërrua papritur dhe fshehurazi.

Autorët e raporteve të tre vendeve dëshmuuan se mediat kryesore nuk punuan sa duhet për të investiguar dhe për të raportuar seriozisht mbi nevojën e vënies para përgjegjësisë së zyrtarëve publikë, dhe mbajtën një qëndrim goxha pasiv duke i lënë hapësira vetëm disa burimeve të kufizuara të informacionit, si dhe nuk krijuan vend për diskutime mbi protestat dhe kërkesën e llogarisë. Raportimet në media në përgjithësi bënin deri diku thirrje për kërkesë llogarie

nga ana e qeverisë, ashtu si kërkohej edhe nga protestuesit, por shumë rrallë u përballën direkt me zyrtarë të caktuar, verifikim dhe investigim të problemeve të identifikuara, etj.

Gjithashtu, të intervistuarit nga të tre vendet pjesëmarrëse në studim janë shumë pesimistë rreth mundësive për ndryshim, kur vjen fjala te kërkesa e llogarisë dhe vënia e qeverisë para përgjegjësisë. Disa nga protestuesit shkojnë edhe më tej, dhe deklarojnë se qeveria duhet të kërcënohet më ashpër dhe demonstrimi i forcës dhe fuqisë të protestuesve është e vetmja mënyrë për të arritur rezultate më të mira nga protestat dhe për të arritur një qeverisje më të përgjegjshme. Disa prej tyre flasin rreth fuqisë simbolike të protestave masive, dhe kënaqen thjesht me konceptimin e kërcënimit dhe nocionin e masave si “turmë e egër,” por ka dhe nga ata që mendojnë se disa forma dhune mund të jenë pjesë legjitime e strategjisë së protestës. Disa nga të intervistuarit në Maqedoni gjithashtu shprehën mendimin se kjo lloj force mund të ushtrohet duke ushtruar presion nëpërmjet disa protestave qytetare të zhvilluara në të njëjtën kohë. Disa prej tyre thanë se koordinimi i disa manifestimeve të protestës në të njëjtën kohë mund të ketë patur një efekt shumëfishues mbi qeverinë, dhe e detyroi atë të niste bisedimet me studentët dhe të lironte nga burgu gazetarin Kezarovski. Nga ana tjetër, disa nga të intervistuarit në Bosnjë thanë se mënyra si u zhvilluan protestat e kohëve të fundit nuk e cenonte aspak rutinën e punës së qeverisë, ngaqë zyrtarët janë tashmë më të përgatitur për t’u përballur me protesta të tilla qytetare.

Të intervistuarit në Bosnjë flasin gjithashtu mbi perceptimet e tyre se ka një rritje të ndërgjegjes qytetare, angazhimit qytetar, mirëkuptimit dhe ndjeshmërisë sociale që bashkon njerëzit përtej barrierave etnike, në pak fjaë – ato flasin për një rritje të ndërgjegjes politike të qytetarëve. Disa

nga të intervistuarit, gjithashtu, besojnë se protestat kanë sjellë në qendër të vëmendjes çështjet e drejtësisë sociale dhe antikorrupsionit, por nga ana tjetër Cvjetičanin vëren se ka patur edhe një forcim të ndjenjave nacionaliste gjatë këtij procesi si rezultat i evokimit të dasive etnike nga mënyra se si u vunë në kornizë protestat nga zyrtarët dhe pjesërisht edhe nga media.

3.3. Roli i medias dhe metodat e komunikimit të gazetarëve

Një përfundim i përbashkët që del nga të tre raportet kombëtare, është se mediat kryesore tradicionale konsiderohen si platforma të domosdoshme komunikimi gjatë protestave. Të intervistuarit nga secili prej tre shteteve dëshmojnë se niveli i raportimit në mediat kryesore lidhet direkt me suksesin apo dështimin e protestave, dhe luan një rol parësor në sjelljen e një çështjeje të caktuar në qendër të diskutimit publik, rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimin e qytetarëve, si dhe në bindjen e qytetarëve mbi nevojën për aksion. Kjo vlen më tepër për televizionin, që vazhdon të jetë burimi kryesor i informacionit për qytetarët në të tre këto vende. Gjithashtu, të dhënat e mbledhura nga intervistat e zhvilluara në Bosnjë Hercegovinë tregojnë se media luajti një rol shumë të rëndësishëm në dështimin e protestave.

Mediat kryesore vlerësohen kryesisht për potencialin që kanë për të amplifikuar apo për të përforcuar zërat e protestuesve. Sidoqoftë, vihet re një skepticizëm i përgjithshëm në të tre këto vende rreth punës dhe rolit të medias, dhe kjo vjen kryesisht nga përzierja e politikës me sektorin e medias, ku përmbajtja e medias shihet kryesisht si shprehje apo manifestim i interesave të qeverisë, partive

të caktuara politike, apo grupeve të biznesit, që ndikojnë direkt në financimin dhe mbijetesën e organave të medias. Për shembull, shumica e të intervistuarve në Bosnjë mendon se mediat kryesore ishin të njëanshme, kundër protestave dhe u treguan favoritizëm kundrejt burimeve qeveritare të informacionit dhe këndvështrimeve apo opinioneve të qeverisë. Sidoqoftë, kjo njëanshmëri vërtetohet vetëm pjesërisht nga analiza e përmbajtjes të raportimeve në media. Në veçanti, radio-televizioni i Republika Srpska (RTRS) tregoi favoritizim të burimeve zyrtare të lidhura ngushtë me qeverinë në Republika Srpska, ndërsa raportimi i dy transmetuesve të tjerë publikë BHRT dhe FTV gjithashtu tregoi një avantazh të burimeve zyrtare si dhe fokus dominant mbi dhunën e ushtruar gjatë protestave, por ato treguan mjaft vëmendje ndaj raportimit të kërkesave të protestuesve, dhe i lanë hapësirë shoqërisë civile dhe protestuesve, veçanërisht gjatë ditëve të fundit të protestave. Përqendrimi vëmendjes ndaj burimeve zyrtare bëri që media të transmetonte propagandën qeveritare kundër protestave, duke u mbështetur në dasitë etniko-nacionale dhe rajonale, apo thjesht duke raportuar mbi supozime të sjelljeve kriminale të protestuesve pa e verifikuar më parë vërtetësinë e tyre. Sidoqoftë, një analizë e plotë e përmbajtjes së medias në Bosnjë nuk e konfirmon dominimin e burimeve zyrtare të informacionit, pasi protestuesit dalin pak më shumë si burime informacioni në media. Megjithatë, prania e protestuesve dhe zëdhënësve të protestës në lajme nuk do të thotë se raportimet ishin domosdoshmërisht në favour të kauzave të protestuesve. Për më tepër, në protestën kundër armëve kimike në Shqipëri, zëri i protestuesve ishte dominant në media, dhe nuk u vu re ndonjë favoritizim i qeverisë.

Ndërsa në rastin e protestave të studentëve në Maqedoni kishte një ndarje të theksuar midis dy kampeve të medias,

duke konfirmuar polarizimin e medias në këtë vend. Mediat proqeveritare i paraqitën protestat në kornizimin e instrumentalizimit politik nga partitë opozitare, ndërsa kërkesat e protestuesve në përgjithësi u shpërfillën. Nga krahu tjetër, mediat kritike ndaj qeverisë i dhanë publikut më shumë informacion rreth protestave, i dhanë më shumë hapësirë zërit të protestuesve, dhe i vunë protestat në korniza si takime popullore që bashkuan qytetarët pavarësisht interesave partiake dhe etnike.

Disa nga të intervistuarit gjithashtu raportuan se mbulimi në media ndikohej edhe nga faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe praktikën apo rutinën e punës në redaksitë e lajmeve. Të intervistuarit në Bosnjë dhe Shqipëri iu referuan prirjeve të redaksive në prodhimin e lajmeve, ku gazetarët parapëlqejnë t'i referohen burimeve të mirënjohura të informacionit, raportojnë mbi informacione të gatshme dhe angazhohen shumë rrallë në gazetari investigativ. Në këto rrethana, informacionet transmetohen gati pa koment apo pa u analizuar, dhe përmbajtja e lajmeve varet më shumë nga dinamika e protestës dhe përpjekjet informative të protestuesve apo zyrtarëve, sesa nga ndonjë politike e qartë editoriale. Kjo mbështetet edhe nga të dhënat e mbledhura nga intervistat – në të tre vendet raportimi në media rreth protestave gjykohet si sipërfaqësor, me mungesë thellimi në informacion dhe detaje, dhe nuanca të ndryshme në raportimin e çështjeve me rëndësi për protestat. Ashtu si vuri në dukje edhe *Londo*, në vend të raportimeve investigative për të kuptuar thelbin e çështjeve, formatet më të përdorura nga mediat ishin debatet në studio dhe prezantimi i opinioneve rivale. Në fjalët e një gazetari shqiptar: “Puna jonë zakonisht përfundon kur protestuesit largohen nëpër shtëpitë e tyre, dhe ne rendim për të raportuar mbi diçka tjetër; nga mungesa e kohës, përpjekjeve, dhe nganjëherë nuk kemi as vullnet apo

mundësi që të gërmojmë më thellë në raportim.”⁴⁶ Praktikrat e punës dhe rutina profesionale u përmendën gjithashtu nga *Londo* dhe *Cvjetičanin* si një nga arsyet e mundshme pse protestuesit që dilnin më shumë në media ishin përfaqësues të shoqërisë civile që merrnin pjesë në protesta, apo persona të tjerë të njohur mirë nga media, ndërsa persona që nuk ishin aq të ekspozuar në publik kontakoheshin më rrallë si burime informacioni. Një arsye tjetër që u përmend nga studiuesit ishte edhe dëshira e disa protestuesve që të mos ekspozoheshin në media. Së fundmi, disa nga karakteristikat e protestave duket se i japin atyre njëfarë përparësie pasi përkojnë me logjikën e punës të medias. Në veçanti masiviteti i protestave përmendet nga *Londo* si faktor që tërheq vëmendjen e medias. Dhuna duket se ka efekt të paqartë mbi protestat – megjithëse tërhoqi vëmendjen e mënjëhershme të medias gjatë protestave të shkurtit në Bosnjë, jehona e fortë e dhunës nga raportimet, edhe pasi këto akte pushuan, mund të ketë ndikuar në mënyrë negative të përcimi i mesazhit të protestave. Mungesa e burimeve dhe kapaciteteve në media përmendet vetëm nga disa të intervistuar si arsye për mungesën e raportimit cilësor, por në përgjithësi mendohet se ky nuk është një faktor kryesor. Së fundmi, të intervistuarit nga Bosnjë Hercegovina thonë se një nga arsyet pse media nuk e përmbushi si duhet detyrën e saj kishte të bënte me sfidat dhe problemet që rridhnin nga kompleksiteti i protestave të shkurtit, shumë ngjarje dhe zhvillime në të njëjtën kohë, dhe kërkesa të shumta në lidhje me çështje shumë komplekse të shprehura jo qartë nga protestuesit.

Autorët e studimit në Bosnjë gjithashtu tërheqin vëmendjen rreth ideve të ndryshme të të intervistuarve

⁴⁶ Intervistë me Klevis Saliaj, ATN TV.

mbi preferencat e tyre mbi rolin e medias. Një pjesë e tyre, shumica gazetarë, thonë se media duhet të japë një pasqyrim objektiv të realitetit, që përkufizohet si “të mos mbash asnjë anë” dhe të paraqesësh “pikëpamje të ndryshme” mbi një çështje. Të intervistuar të tjerë thonë se në njëfarë mënyrë media duhet të “mbajë anë,” dhe të tregohet e përgjegjshme kundrejt të mirës së përgjithshme, pra të angazhohej më shumë në raportimet mbi protestat.

Në të tre vendet, disa media online u lavdëruan për ndihmesën e vlefshme në komunikim dhe rrjedhën e informacionit gjatë protestave, pra për vëmendjen më të madhe që i kushtuan protestave (si mediat online Reporter në Shqipëri, apo Žurnal, Abraš media, etj. në Bosnjë). Autorët e kapitullit mbi Maqedoninë përmendën si media online Novatv.mk dhe Plusinfo.mk ashtu edhe stacione televizive Telma, Alsat-M, si platforma që dhanë më shumë informacione mbi protestat.

Rezultatet e studimit nuk nxjerrin përfundime në lidhje me ndonjë ndryshim në nivelin e profesionalizmit në media midis të tre vendeve. Krahasimi me dy rastet e tjera të protestave tregon diferenca në raportimin e medias edhe përbrenda një shteti. Mënyrat e ndryshme të raportimit në media rreth protestave kishin të bënin më tepër me dinamikat e ndryshme të komunikimit gjatë protestave, duke përfshirë edhe mënyrën e komunikimit apo mungesën e komunikimit nga zyrtarët, dhe mënyrën sesi protestuesit i kanë shfrytëzuar mundësitë që u janë dhënë për komunikim. Rasti më tipik ishte raportimi i pazakontë korrekt mbi protestat rreth shkatërrimit të armëve kimike në Shqipëri, që ishte më tepër një rezultat i rrethanave të caktuara ku mungonte thuhajse krejtësisht komunikimi nga zyrtarët, dhe kjo i lejoi protestuesit që të zinin më shumë hapësirë në media.

3.4. Mediat sociale - një partner i vështirë për mediat tradicionale

Rezultatet e studimeve mbi të tre vendet tregojnë rëndësinë e mediave sociale, veçanërisht Facebook, për të informuar dhe mobilizuar njerëzit në protesta. Ishte një praktikë e zakonshme pune që të krijoheshin disa profile në Facebook mbi protesta të caktuara ndërkohë që ishin në zhvillim e sipër, ku një apo dy profile ktheheshin në pika reference ku individë dhe komunitetet merrnin informacion të freskët. Për shembull në rastin e Shqipërisë, Aleanca kundër importit të plehrave (AKIP) u kthye në një pikë reference të dukshme në Facebook, duke mbledhur së bashku ambientalistë dhe grupet e të drejtave të njeriut, duke informuar komunitetin mbi zhvillimet më të fundit, por edhe duke sugjeruar hapin tjetër që duhej ndërrmarë për të zhvilluar më tej aksionin e protestës, që të arrihej bllokimi i shkatërrimit të armëve kimike në territorin e Shqipërisë.

Ishte diçka tipike që protestat ndiqeshin nga krijimi i një numri të madh profilesh në Facebook; disa prej tyre zakonisht përdoreshin për të krijuar bashkëpunim midis grupeve të ndryshme me interesa të ngjashme. Kjo mund të interpretohet si pasqyrim i lëvizjeve pa një strukturë të qartë, që angazhojnë shumë individë pa ndonjë strukturë formale udhëheqjeje. Ndërsa aktivistët ambientalistë ishin më të përqendruar që të krijonin bashkëpunim dhe të tërhiqnin vëmendjen e grupeve të ekspertëve dhe profesionistëve, një profil që u hap në Facebook nga disa studentë u bë faqja kryesore për mobilizimin e publikut të gjerë: “një milion shqiptarë kundër shkatërrimit të armëve kimike në Shqipëri”.

Ndërkohë që roli i mediave sociale gjatë protestave vlerësohet lart nga të intervistuarit në të tre shtetet e rajonit, raportimi në mediat kryesore tradicionale vazhdon

të konsiderohet si mjete kryesor për të komunikuar nga protesta me publikun e gjerë, duke njohur mirë popullaritetin dhe ndikimin e komunikimit televiziv në rajon. Rëndësia e komunikimit televiziv në të tre vendet në disa raste u kuptua mirë nga aktivistët që u munduan të përdorin në maksimum hapësirat që u jepeshin nga mediat, si ajo online ashtu dhe mediat tradicionale – ndërkohë që ishin aktivë në komunitetet online, protestuesit gjithashtu bashkëpunonin me mediat tradicionale për të arritur sa më shumë publik.

Ndërsa vetë krijimi i profileve apo grupeve në Facebook nuk paraqitnin ndonjë interes për median tradicionale, dhe përmbajtja e këtyre platformave konsiderohej e pamjaftueshme për të siguruar mbështetje të vazhdueshme dhe për të mbajtur në këmbë protestat; mediat e përdornin Facebook-un si burim informacioni mbi protestat, por dhe vetë aktivistët u munduan me sa kishin mundësi që të përfaqësoheshin dhe të paraqisnin pikëpamjet e tyre në mediat tradicionale.

Prezantimi i protestave në mediat sociale dha ndihmesën e vet në mobilizimin për protesta, por paraqitja në televizion mendohet të jetë ajo që ndikon më të vërtetë në realitet, dhe që luan një rol kryesor mbi zhvillimin dhe rezultatin e protestave qytetare. Në fakt, të intervistuarit në të tre vendet e rajonit i shikonin mediat sociale kryesisht si mjete për mobilizimin e masave. Ndërkohë që mediat tradicionale duan shumë kohë që të prodhojnë lajme dhe lëvizin relativisht ngadalë, profilet në Facebook e mbushën këtë boshllëk duke shkëmbyer informacione në mënyrë konstante. Lëvizjet studentore në Maqedoni dhe Shqipëri për shembull e treguan qartë këtë rol të mediave sociale, duke i identifikur këto si format kryesore të komunikimit për organizimin dhe mobilizimin për aksione proteste.

Përveçse shërben si platformë organizative, Facebook

u përdor gjithashtu për të shpërndarë opinionet dhe refleksionet e individëve të ndryshëm mbi protestat, në këtë mënyrë profilet në Facebook krijuan një prezantim të veçantë të protestave, duke nënvizuar rëndësinë e kauzës së protestuesve edhe për publikun e gjerë. Në disa raste mediat sociale paraqitnin diçka diametralisht të kundërt me atë që paraqitej në mediat tradicionale; si për shembull, gjatë protestave në Bosnjë kur mediat kryesore i vunë protestat në korniza dhune. Përveç kësaj, mediat sociale iu kundërvunë mediave tradicionale duke i denoncuar disa raportime si të pavërteta – në Sarajevë protestuesit u këshilluan të mos i besonin lajmeve mbi plenumet nëse këto nuk konfirmoheshin në faqet zyrtare të këtyre plumeve në internet. Për pasojë, kornizimet e prezantimit në mediat online shpesh ndryshojnë nga mediat tradicionale – nëse kornizimi i dhunës ishte dominues në mediat tradicionale, atëherë rastet e dhunës policore raportoheshin në platformat e mediave sociale. Kishte raste kur mediat sociale ishin e vetmja hapësirë mediatike ku mund të raportoheshin mbi dhunën policore. Mediat tradicionale e evituan këtë çështje, dhe dëshmitë personale të qytetarëve, që nuk gjenin hapësira në mediat tradicionale, ishin të vetmet të dhëna rreth dhunës policore.

Në këtë mënyrë mediat sociale dolën si hapësira që mundësuan një raportim alternativ të ngjarjeve në terren. Sidoqoftë, të intervistuarit pranuan se kishte raste kur materialet në mediat sociale vuanin nga mungesa e besueshmërisë. Ngaqë nuk arrinin dot standardet profesionale të gazetarëve, të përgatitura nga njerëz të panjohur, informacionet në këto platforma nuk ishin dhe aq të besueshme për një pjesë të publikut. Gjithashtu, disa të intervistuar në Bosnjë pretenduan se këto platforma herë pas here manipuloheshin nga partitë politike që mund të infiltroheshin në rrjet. Përgjimi nga ana e shtetit u përmend

si rrezik potencial për komunikimin në rrjete sociale si në Bosnjë ashtu edhe në Maqedoni, dhe pati disa komente se duhet të jemi të ndërgjegjshëm se informatorë të shtetit apo partive politike janë shumë aktivë në komunikimet online.

3.5. Metodatat e komunikimit të qytetarëve/protestuesve

Të intervistuarit që reflektonin mbi protestat e shkurtit në Bosnjë, dhe pjesërisht edhe mbi protestat e tjera në të tre shtetet, nënvizuan hallakatjen e informacionit dhe komunikimit midis protestuesve dhe aktivistëve. Hallakatja në komunikim ishte një pasqyrim i mungesës së strukturave organizative të protestave, organizimin e tyre horizontal, si dhe mungesën e një udhëheqjeje apo përfaqësuesve të zgjedhur të protestës. Në lidhje me mediat tradicionale, këto karakteristika, deri diku tipike për lëvizjet sociale, herë pas here kanë vështirësuar komunikimin me “palët e treta”.

Eksperiencat në të gjitha rastet e analizuara tregojnë se mediat tradicionale kërkonin të kontaktonin me zëdhënësia, përfaqësues të plenumëve, kërkonin të merrnin informacione të sakta mbi strategjitë e lëvizjeve dhe kërkonin mesazhe konsekuente të formuluar qartë. Është vënë re se strategjitë e lëvizjeve sociale mund të kenë dëmtuar përpjekjet e vetë këtyre grupimeve si pasojë e dështimit për t'u përshtatur me kërkesat dhe nevojat e mediave tradicionale, duke kontribuar në paraqitjen e shtrembëruar të protestave dhe kauzave të tyre. Sidoqoftë, nuk duhet të kritikojmë vetëm mungesën e profesionalizmit nga ana e lëvizjeve sociale, por duhet të përmendim edhe mangësitë e mediave tradicionale në kuptimin e drejtë të situatës dhe mungesës së përpjekjeve të tyre për t'u përshtatur me rrethanat. Për këtë arsye, kur shqyrtojmë metodatat e komunikimit të protestuesve nuk

duhet të rishikojmë vetëm rrjedhën e informacionit nga ana e tyre, por duhet të analizojmë edhe (keq)kuptimin e situatës nga ana e medias tradicionale. Raportet kombëtare tregojnë se mediat tradicionale në disa raste nuk u munduan fare që të njihnin “nga afër” idetë dhe motivet e lëvizjeve. Në disa raste gazetarët mjaftoheshin me raportimin e mesazheve kontradiktore dhe agresive pa u munduar që t’i analizonin apo të merrnin vesh kuptimin e tyre. Transmetimi i drejtpërdrejtë i aludimeve dhe deklaratave politike kundër përfaqësuesve të protestave u përmend shpesh nga të intervistuarit në Bosnjë. Prirjet negative në mbulimin e protestave nga media u vunë re edhe kur raportimet e gazetarëve i paraqisnin protestuesit si njerëz me karakter të dobët, të paarsimuar, apo kur media ndiqte nga pas persona të famshëm që merrnin pjesë në protesta, dhe të gjitha këto ishin praktika dhe metoda që e ulnin prestigjin dhe zbehnin rëndësinë e protestave.

Nga ana tjetër, duhen përmendur edhe ato raste që treguan aleancë midis protestuesve dhe gazetarëve. Kur gazetarët profesionistë ishin vetë në rolin e protestuesve aktivë (veçanërisht në protestat kundër arrestimit të gazetarit Kezarovski në Maqedoni) dukej se e kuptonin qartë rëndësinë e protestës dhe për rrjedhojë edhe cilësia e raportimit ishte më e lartë.

Problemet në kuptimin apo vlerësimin e protestave nga ana e mediave tradicionale kanë ndikuar goxha në strategjitë e komunikimit të protestuesve me median. Nëse në rastin e Shqipërisë protestuesit ishin të vendosur që të punonin ngushtë me gazetarët, shembujt nga protestat në Bosnjë treguan raste kur protestuesit nuk pranuan të bashkëpunonin me median. Këto refuzime mund të vijnë si pasojë e eksperiencave të këqija në të kaluarën me shtrembërim informacioni nga media; nganjëherë si pasojë e mungesës së përvojës në komunikim dhe frikës

së shtrembërimit të mesazhit nga media, siç ndodhi me protestat e studentëve në Maqedoni; apo edhe nga frika e pasojave individuale, për sigurinë e tyre apo heqjen nga puna (sidomos në Bosnjë). Për shembull, studentët protestues në Shqipëri treguan një qëndrim pragmatik në marrëdhëniet e tyre me median – mediat u konsideruan thjesht si mjete për ta përçuar informacionin te publiku. Për të shpërndarë mesazhet e tyre, disa grupe, si *Lëvizja për Universitetin* në Shqipëri, kanë krijuar strategji komunikimi, kanë ngritur struktura të marrëdhënies me publikun, dhe shpërndajnë deklarata shtypi, mbajnë kontakte me gazetarë, shkëmbejnë informacione, etj. Në rastin e protestave kundër shkatërrimit të armëve kimike në Shqipëri, përfqësues të Aleancës Kundër Importit të Plehrave kishin krijuar që më parë marrëdhënie të mira me median, dhe siguruan një paraqitje të protestës në media po aq të suksesshme sa edhe profilet e tyre në Facebook. Ka edhe shembuj të tjerë që paraqesin një tablo krejt të kundërt, si sjelljet e plenumëve studentore në fillimet e protestës, kur protestuesit u angazhuan në komunikimet midis tyre ndërsa prenë kontaktet me mediat tradicionale që kërkonin përshtatjen e protestuesve me nevojat e tyre. Me kalimin e kohës pjesëmarrësit në këto plume u treguan më të hapur në kontaktet me mediat.

Disa protestues nga Bosnja e vunë thesin edhe te rëndësia e identitetit vizual dhe simboleve të protestave të shkurtit, të cilin e konsiderojnë të mangët, sidomos po ta krahasosh me paraqitjen e fortë vizuale nga protestat JMBG në vitin 2013 (një grusht që del nga biberoni); në fakt, paraqitja vizuale e disa plenumëve dhe simbolet e përdorura nga protestuesit, duket se nuk ishin mjaft tërheqëse për median, dhe për pasojë nuk mundën dot të zëvendësonin dhe të zhvlerësonin imazhet e dhunës që dominonin paraqitjen e protestave në media.

4. Disa shënime të fundit

Problemet dhe sfidat në komunikim me të cilat hasen si protestuesit ashtu edhe media gjatë zhvillimit të protestave janë të shumta dhe disa prej tyre lidhen ngushtë me karakteristikat bazë të protestave: linja horizontale të komunikimit dhe mungesa e një strukture organizative midis protestuesve; ngandonjëherë nuk ka përfaqësues proteste që të flasin në emër të masave; pjesëmarrja e grupeve me përkatësi dhe interesa shumë të ndryshme nga njëri-tjetri, dhe për pasojë kemi shumë llojshmëri dhe mospërputhje mesazhesh dhe kërkesash nga protesta; herë të tjera krijon probleme mungesa e përvojës në marrëdhëniet me median.

Nga ana tjetër, edhe sistemi mediatik paraqet mangësi dhe pengesa që kanë të bëjnë edhe me përzierjen e politikës në organet e medias dhe 'paralelizmin politik' që konsiderohet si një dukuri sunduese në të tre këto vende, dhe kjo ka një ndikim të konsiderueshëm në mënyrën e raportimit të protestave nga mediat kryesore tradicionale. Disa protesta janë pritur mirë nga media, dhe raportimi për to ka qenë më pozitiv, por kjo duket se vjen nga fakti që këto protesta nuk ishin shumë kritike ndaj qeverisë. Një rast i tillë ishte protesta për ndalimin e shkatërrimit të armëve kimike në Shqipëri, apo mitingjet e protestës për lirin e gazetarit në Maqedoni, që ishin fokusuar në çështje të caktuara dhe ishin më pak antiqeveritare sesa protestat e shkurtit 2014 në

Bosnjë Hercegovinë apo protestat studentore në Maqedoni, që patën një mbulim problematik në media. Në këtë këndvështrim, në rastin e protestave kundër armëve kimike në Shqipëri, kornizimi dominant përkonte me akuzat dhe kërkesat e protestuesve – projekti i shkatërrimit të armëve kimike u vu në kornizë si *vënie në rrezik të sigurisë publike*, dhe pjesërisht kjo u bë e mundur ngaqë kritikën ndaj qeverisë ishin të kufizuara vetëm mbi këtë çështje dhe nuk përbënin ndonjë kërcënim. Nga ana tjetër, në protestat e analizuara në Maqedoni dhe Bosnjë Hercegovinë, kornizimi dominant në media ishte diametralisht i kundërt me atë të protestuesve, ku u përdorën strategji deligjitimitimi të përdorura rëndom në të tilla raste, kryesisht nëpërmjet kornizimit të instrumentalizimit politik të protestave. Forma specifike e kornizimit varej nga ideologjia dominante në shtetin përkatës, kështu që nëse në Maqedoni bazohej në akuzat e lidhjeve partiake-politike me protestuesit, në Bosnjë mori formën e instrumentalizimit etniko-politik, duke i paraqitur protestat si sulme kundër interesave kombëtare të një prej grupeve etnike kryesore apo kundër një krahu të qeverisë të lidhur ngushtë me këtë grup të caktuar etnik.

Për ta përmbledhur, rezultatet e studimit në këto tre vende treguan se media nuk është shkëputur nga modelet e vjetra të reagimit ndaj protestave që karakterizohen nga lidhjet politike dhe klientelizmi. Edhe kur një media e caktuar raportonte në mënyrë të paanshme dhe të balancuar rreth protestave, dhe krijonte hapësira që protestuesit të shprehnin pakënaqësitë dhe kërkesat e tyre, raportimi ishte sipërfaqësor, pa analizuar shkaqe dhe probleme, dhe pa u thelluar në kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë.

Në vend që të ofrojnë të dhëna dhe analiza të çështjeve që shqetësojnë protestuesit, media funksionon në shumicën e rasteve thjesht si platformë për opinione të kundërta, duke

treguar favoritizëm për njëri apo tjetri palë. Mënyra si u raportua mbi protestat në të tre këto shtete ndryshonte nga vendi në vend por kishte diferenca në raportim edhe nga mediat brenda një shteti, duke filluar nga njëanshmëria proqeveritare; raportim sipërfaqësor pa u thelluar në çështje (në të tre vendet); deri te raportimi proprotestë.

Karakteristika kryesore e protestave që i shkonte më për shtat medias dhe natyrës së saj të punës ishte masiviteti, dhe kjo siguroi pasqyrimin e tyre në media (ndonëse jo në cilësinë e duhur) – sa më masive të jenë protestat aq më e vështirë është për median që t'i shpërfillë. Masiviteti ishte një mesazh i fortë mediatik në vetvete. Dhuna është një tjetër element që tërhoqi vëmendjen e medias; në protestat e shkurtit në Bosnjë dëmet materiale gjatë dhunës në ditët e para të protestës tërhoqën plotësisht vëmendjen e medias. Kjo mund të ketë ndikuar në mënyrë negative në prezantimin e protestave para publikut, pasi çështja e ushtrimit të dhunës, në veçanti pamjet filmike, mbizotëroi raportimin në media përgjatë gjithë periudhës së zhvillimit të protestave, dhe kjo mund të ketë zbehur efektshmërinë e mesazheve të protestuesve.

Qëndrimet e mediave në Bosnjë në lidhje me protestat e muajit shkurt ishin të larmishme, duke filluar nga favorizimi i hapur i qeverisë, në mbulimin disi të balancuar të protestave, deri te raportimi i njëanshëm duke favorizuar protestuesit e shkurtit. Nga ana tjetër në Maqedoni studiuesit vunë re një ndarje me thikë të dy kampeve mediatike në raportimin e protestave të studentëve, me median proqeveritare në njërin krah, dhe median kritike ndaj qeverisë në krahun tjetër, që jepte me shumë informacion mbi protestat dhe i bënte jehonë kërkesave të protestuesve.

Platformat online (rrjetet sociale dhe disa faqe interneti) u identifikuan si media që krijuan më shumë hapësira

komunikimi për protestuesit, duke lejuar raportimin në mënyrë të pavarur nga presioni mediatik qeveritar, dhe në disa raste platformat në internet ishin të vetmet burime informacioni mbi një çështje të caktuar, si për shembull dhuna policore. Komunikimi nëpërmjet platformave online - veçanërisht nga grupet në Facebook dhe faqet e internetit të protestave - luajti rol shumë të rëndësishëm për shpërndarjen e informacionit midis pjesëmarrësve në demonstrata dhe për mobilizimin për aksion proteste. Sidoqoftë, përveç këtyre rezultateve fillestare, platformat online duket se kanë patur një efekt të kufizuar në ndërtimin e mendimit dhe krijimin e kornizimit të realitetit, duke treguar edhe njëherë se mediat kryesore, sidomos televizioni, vazhdojnë të luajnë një rol vendimtar në këtë proces. Të intervistuarit, duke përfshirë edhe vetë protestuesit, janë shumë të ndërgjegjshëm mbi rëndësinë e vëmendjes të medias për të rritur ndikimin e protestës dhe për të siguruar qëndrueshmërinë e saj.

Asnjë nga raportet kombëtarë nuk identifikoi ndonjë ndryshim të ndjeshëm në lidhje me qëndrimin ndaj kërkesës së llogarisë të zyrtarëve gjatë dhe pas protestave të kohëve së fundit, apo në mënyrën si kjo kërkesë përgjegjësie diskutohet në sferën publike. Reagimet e zyrtarëve ndaj protestave kanë lënë shumë për të dëshiruar – që nga heshtja e plotë dhe injorimi i protestave (sidomos në rastin e protestave kundër shkatërrimit të armëve kimike në Shqipëri), tek akuzat e instrumentalizimit politik (në Bosnjë dhe Maqedoni), dhe deri tek insinuatat apo trillimet kundër protestuesve (në Bosnjë: kriminalizimi; hedhja e fajit mbi “të tjerat” njësi administrative dhe komunitete etnike; pretendimi se protestat janë një sulm kundër shtetit, rajonit apo krahinës), dhe së fundmi përvetësimi i axhendës së protestës (disa zyrtarë në Bosnjë deklaruan se binin dakord me pakënaqësitë dhe kërkesat e protestuesve, por në të

njëjtën kohë nuk ndërmorën asnjë masë për të ndrequr ato probleme). Gjatë protestave, zyrtarët u angazhuan gati tërësisht në komunikim të njëanshëm (deklarata për shtyp, dalje në televizion, postime në Facebook) dhe pati vetëm pak raste kur pranuan të diskutojnë direkt me protestuesit apo të marrin pjesë në debate dhe emisione mediatike interaktive. Po kështu, edhe organet e medias kryen një punë të dobët (për të mos thënë më tepër), duke transmetuar deklarata problematike pa e verifikuar dhe konfirmuar më parë informacionin, si dhe dështuan të nisin debatin rreth kërkesës së llogarisë ndaj qeverisë në vazhden e protestave qytetare. Për ta përmbledhur, rezultatet e studimit tregojnë se reagimi ndaj protestës si nga ana e qeverisë ashtu dhe nga ana e medias ishte një përgjigje sistemike, dhe të dyja institucionet dështuan në detyrën e tyre në të mirë të interesit publik dhe promovimit të përgjegjshmërisë dhe kërkesës së llogarisë.

Në të tre vendet e përfshira në këtë studim edhe vetë fakti që u zhvilluan protesta ishte i mirëpritur, si shprehje e demokracisë. Të intervistuarit e kuptojnë fuqinë e komunikimit dhe nevojën për të përdorur të gjitha mundësitë që jepen si nga mediat kryesore ashtu edhe nga platformat alternative. Megjithë vështirësitë dhe problemet në komunikim, protestuesit në disa raste gjetën mënyra për të depërtuar te publiku dhe sfiduan kornizimet dominante. Në Shqipëri, heshtja e qeverisë në ditët e para të protestës kundër shkatërrimit të armëve kimike krijoi mundësi të mira dhe la më shumë hapësirë për protestuesit që të shprehnin opinionet e veta në mediat kryesore. Në rastin e protestave të shkurtit në Bosnjë, disa media u identifikuan si mbështetëse të protestave dhe demonstruesit u mbështetën te këto media për të transmetuar informacione që shpërfilleshin nga shumica e mediave të tjera kryesore. Duke vizatuar rrathë rreth fotove në Facebook, protestuesit në Maqedoni imitonin

metodat e mediave pro-qeveritare që i etikonin ata si vegla politike, dhe në këtë mënyrë shndërruan një instrument diskreditimi në një mjet komunikimi dhe vetëpromovimi. Ka patur disa shembuj të suksesshëm komunikimi dhe përpjekje për të përdorur platforma të ndryshme komunikimi, për të paraqitur forma të reja aksioni dhe proteste (kryesisht plenumet), duke ndihmuar kështu në “familjaritetin kulturor” (Tarrow, 2011) me një repertor më të gjerë të aksionit të protestës, që mund të ndikojë edhe nisma të tjera qytetare në të ardhmen.

Gjatë këtij studimi dolën qartë në pah disa mundësi të mira por edhe shumë vështirësi e pengesa, dhe këto njohuri dhe përvoja mund të shërbejnë si sfond i vlefshëm për protestat qytetare në të ardhmen. Në rast se protestat qytetare ndizen përsëri – dhe disa nga të intervistuarit mendojnë se kjo është e pashmangshme (veçanërisht në Bosnjë dhe Maqedoni) – protestuesit ka shumë gjasë të ndeshen me sfida dhe vështirësi të ngjashme në lidhje me ndërtimin e mendimit dhe shfrytëzimin e hapësirave për komunikim me aq sa e lejojnë kufizimet dhe problemet strukturale të sistemit. Autorët e raporteve kombëtare kanë ofruar rekomandimet e tyre për secilën nga palët në këtë proces: media, zyrtarët politikë dhe vetë protestuesit, por këto rekomandime jepen me shumë rezerva duke qenë se zbatimi i tyre kufizohet shumë nga faktorët e kulturës politike, ambientit mediatik, si dhe nga niveli i organizimit të protestave, nga i cili varet edhe zbatimi i strategjive të komunikimit. Si përfundim, ndryshimet thelbësore janë të mundshme vetëm nëse ato përfshijnë zgjidhje në nivel strukturor dhe reforma thelbësore në shoqëri dhe media.

Bibliografia

Althusser, L. 1970, Ideology and Ideological State Apparatuses, in Lenin and Philosophy and Other Essays, **(Ideologjia dhe aparatet shtetërore ideologjike, te Lenini dhe Filozofia dhe ese të tjera)** 1970.

Cammaerts B. 2012. Protest Logics and Mediation Opportunity Structure. European Journal of Communication **(Logjika e protestës dhe strukturat ndihmëse të mediacionit. Buletini evropian i komunikacionit)** 27(2), 117-134. Londër: Sage.

Cammaerts, B dhe Carpentier, N. 2007. Reclaiming the Media: Communication Rights and Democratic Media Roles. **(Ta rimarrim median: të drejtat e komunikimit dhe rolet e medias)** Bristol: Intellect Books. faqe. 265-288.

Cammaerts B dhe Carpentier N (2009) Blogging the 2003 Iraq War: Challenging the ideological model of war and mainstream journalism? **(Blogjet dhe lufta e Irakut në 2003: Sfida ndaj modelit ideologjik të luftës dhe gazetarisë tradicionale?)** *Observatorio* 3(2): 1-23.

Bennett LW, Breunig C dhe Givens T (2008) Communication and political mobilization: Digital media use and protest organization among anti-Iraq War demonstrators in the U.S. Political Communication **(Komunikimi dhe mobilizimi politik: Mediat digjitale dhe organizimi në protesta kundër luftës së Irakut në komunikimin politik në SHBA)** 25(3): 269-289.

Benford RD dhe Snow DA (2000) Framing processes and social movements: An overview and assessment (**Kornizimet dhe lëvizjet sociale: Tablo e përgjithshme dhe vlerësim**) *Annual Review of Sociology* 26: 611–639.

Blee, K. M. 2012. *Democracy in the making: How activist groups form* (**Demokracia në lëvizje: Si formohen grupet aktiviste**). Oxford, Angli; Malden, MA: Oxford University Press.

Couldry N. dhe Hepp, A. 2013, Conceptualizing Mediatization: Contexts, Traditions, Arguments. *Communication Theory* (**Konceptualizimi i mediatizimit: konteksti, tradita, argument**). *Teoria e komunikacionit*. Volumi 23, Numri 3, faqe 191-202

Della Porta D dhe Diani M (2006) *Social Movements: An Introduction* (**Lëvizjet sociale: Hyrje**). Oxford dhe Victoria: Blackwell Publishing.

Deluca K.M (2005) *The new rhetoric of Environmental Activism* (**Retorika e re e aktivizmit ambientalist**), Guilford Press.

DeLuca K.M dhe Peoples J (2002) From public sphere to public screen: Democracy, activism, and the ‘violence’ of Seattle. *Critical Studies in Media Communication* (**Nga sfera publike në skenën publike: Demokracia, aktivizmi, dhe ‘dhuna’ në Siatëll. Studime kritike mbi komunikimet e medias**) 19(2): 125–151.

Dekić, S. 2010. "Queer online": Queer Community on Internet and Activism in Croatia, Serbia and Bosnia and Herzegovina (**Homoseksual online. Komuniteti homoseksual në internet dhe aktivizmi në Kroaci, Serbi and Bosnjë Hercegovinë**) Hodžić E., Jusić, T. (Ed.). *On the Margins: Minority and media in SEE (Të lënë pas dore: Minoritete dhe media në Evropën juglindore)* (ed.). Mediacentar Sarajevo: 2010.

Donson F, Chesters G, Welsh I dhe Tickle A (2004) *Rebels with a cause, folk devils without a panic: Press jingoism, policing tactics*

and anti-capitalist protest in London and Prague. *Internet Journal of Criminology* (**Rebelë me arsye, djaj sypatrembur. Gazetaria shoviniste, taktika policore dhe protestat antikapitaliste në Londër dhe Pragë**) Buletini i Kriminologjisë në Internet. Mund të lexohet në: www.internetjournalofcriminology.com/ (faqja u vizitua më 10 gusht 2015).

Edelman, M. J. 1993. Contestable categories and public opinion. *Political Communication*, (**Kategoritë e kontestueshme dhe opinion publik**). *Komunikimi politik* 10(3), 231-242.

Eldridge J (1995) *Glasgow Media Group Reader, Volumi 1: News Content, Language and*

Visuals (**Përmbajtja e medias, gjuha dhe pamjet**) . Londër: Routledge.

Entman, R. M. 1993. Framing: Toward Clarification of a Fractured Paradigm *Journal of Communication* (**Kornizimet: Drejt sqarimit të një paradigme të copëzuar**). Buletini i Komunikimit, 43(4)

Entman, R. M., & Rojecki, A. 1993. Freezing out the public: Elite and media framing of the U.S. anti-nuclear movement. *Political Communication*, (**Lënia e publikut jashtë loje: Kornizimet e elitës dhe medias ndaj lëvizjes antibërthamore në SHBA. Komunikimi Politik**) 10(2), 151-167.

Gamson, W. 1992. *Talking politics* (**Të flasim mbi politikën**). New York: Cambridge University Press.

Gamson, W. A., Wolfsfeld, G. (1993), 'Movements and Media as Interacting Systems', *Annals of the American Academy of Political and Social Movements*, 526 (**Lëvizjet dhe media si sisteme bashkëvepruese, Analet e e Akademisë Amerikane të Lëvizjeve Sociale dhe Politike**) faqe. 114-27.

Girling J. 2004 Social Movements and Symbolic Power Radicalism, Reform and the Trial of Democracy in France (**Lëvizjet sociale**

dhe radikalizimi simbolik i pushtetit, reforma dhe testi i demokracisë në Francë) Palgrave Macmillan

Gitlin, T. (1980), *The Whole World is Watching: Mass Media in the Making & Unmaking of the New Left*, (**Po na shikon e gjithë bota: roli i medias në formimin dhe shformimin e të majtës së re**) Berkeley/Londër: University of California Press.

Goffman, E. (1974) *Frame analysis (Analiza e kornizimit)*. New York: Free Press

Jusić, T (Ed) 2010. Communication and Community: Citizens, Media and Local Governance in Bosnia and Herzegovina (**Komunikimi dhe komuniteti: qytetarët, media, dhe pushteti lokal në Bosnjë Hercegovinë**). Mediacentar Sarajevo

Halloran JD, Elliott P dhe Murdock G (1970) *Demonstrations and Communication: A Case Study (Demonstrime dhe komunikime: Studim i një rasti)* Harmondsworth: Penguin Books.

Hurwitz R. 2003, *Who Needs Politics? Who Needs People? The Ironies of Democracy in Cyberspace (Ç'na duhet politika? Ç'na duhen njerëzit? Ironitë e demokracisë në internet)*

Jenkins, H. dhe Thorburn, D. (ed.) *Democracy and New Media (Demokracia dhe media e re)*, MIT Press, Cambridge, Massachusetts, Londër.

Jenkins, H. dhe Thorburn, D. (ed.) 2003. *Democracy and New Media (Demokracia dhe media e re)*, MIT Press, Cambridge, Massachusetts, Londër.

Johnston dhe Klandermans (ed.) *Social Movements and Culture (Lëvizjet dhe kultura sociale)*, Minneapolis: University Minnesota press, 1995

Lievrouw, L. 2011. *Alternative and activist new media (Mediat e reja alternative dhe aktiviste)*. Cambridge, Angli: Polity.

Lipschutz RD (2005) *Networks of knowledge and practice:*

Global civil society and global communications. (**Rrjetet e dijes dhe praktikës**) De Jong W, Shaw M dhe Stammers N (eds) *Global Activism, Global Media* (**Aktivizmi global, media globale**). Londër: Pluto, faqe 59–80.

Livingstone, S. 1990. Making sense of television: the psychology of audience interpretation (**Të kuptojmë televizionin: psikologjia e interpretimit të audiencës**). Oxford: Pergamon Press

Mattoni A, dhe Trere, E, 2014, Media Practices, Mediation Processes, and Mediatization in the Study of Social Movements, *Communication Theory* (**Praktikat e medias, proceset e mediacionit, dhe mediatizimit në studimet e lëvizjeve sociale, teoria e komunikimit**) 24, faqe 252–271

Mazzoleni, G., Schulz, W. 1999. „Mediatization’ of Politics: A Challenge for Democracy?. *Political Communication* (**Mediatizimi i politikës: Një sfidë ndaj demokracisë? Komunikimi Politik**) 16(3): 247-262.

McChesney RW (2008) *The Political Economy of Media: Enduring Issues, Emerging Dilemmas* (**Ekonomia politike e medias: Çështje të vjetra, dilema të reja**). New York: Monthly Review Press.

McCurdy P (2010) Breaking the spiral of silence: Unpacking the ‘media debate’ within global justice movements. A case study of Dissent! *Interface: A Journal for and about Social Movements* (**Këputja e zinxhirit të heshtjes: Hapja e ‘debatit mbi median’ brenda lëvizjeve për drejtësi globale. Një studim mbi disidencën! Interface: Buletini i lëvizjeve sociale**) 2(2): 42–67.

McGee, M. 1975 “In Search of the ‘The People’: A Rhetorical Alternative.” (**Kush flet ‘në emër të popullit’?: Një alternativë retorike**) *Quarterly Journal of Speech* 61.3 (1975): 235- 249.

Melucci A 1996 *Challenging Codes: Collective Action in the Information Age* (**Sfida ndaj sistemit: aksioni kolektiv në epokën e informacionit**). Cambridge: Cambridge University Press.

Mondak, J., Gearing, J and Adam, F. 1998. Civic Engagement in Post-Communist State (**Angazhimi qytetar në shtetin post-komunist**). *Political Psychology* (Psikologjia politike), 19(3)

Mossberger, K, Tolbert, C.J, McNeal R.S. Digital Citizenship: the Internet, Society and Participation. (**Shtetësia dixitale: interneti, shoqëria dhe pjesëmarrja**), The MIT Press. Massachusetts/Londër: 2008.

Morozov E (2009) The brave new world of slacktivism. (**Bota e re e përtacllëkut**), *Foreign Policy* (Politika e jashtme) 19 maj. Mund të lexohet tek: <http://www.npr.org/templates/story/story.php?storyId=104302141>

Opp, Karl-Dietter, 2009, Theories of political protests and social movements: A multidisciplinary introduction, critique and synthesis (**Teoritë e protestave politike dhe lëvizjeve sociale. Një hyrje multidisiplinare, kritika dhe sinteza**) Londër dhe New York: Routledge

Petković, B. (ed), 2014. Media Integrity Matters: Reclaiming public service values in Media and journalism. Ljubljana: Peace institute. (**Rëndësia e integritetit në media: Rikthimi i vlerave të shërbimit publik në media dhe gazetari**)

Schlosberg, J. 2013 Power Beyond Scrutiny: Media, Justice and Accountability. (**Pushtet i paprekshëm: media, drejtësia dhe kërkesa e llogarisë**) Londër: Pluto Press

Shah, D., Cho J., Eveland, W. dhe Kwak N. 2005, "Information and Expression in a Digital Age: Modeling Internet Effects on Civic Participation", *Communication Research*, Year 32, no. 5 (October), (**Informacioni dhe shprehja në epokën dixhitale: efektet e internetit mbi pjesëmarrjen qytetare. Kërkime në**

Komunikim, viti 32, nr.5, tetor) Sage Publications.

Silverstone, R. (2002). Complicity and collusion in the mediation of everyday life. (**Bashkëfajësia dhe komploti në mediacionin e jetës së përditshme**) *New Literary History*, 33(4), 761–780.

Tarrow, S.G. 2011. Power in movement: Social movements and contentious politics, Third Edition (**Pushteti në lëvizje: Lëvizjet sociale dhe politika disidente**, edicioni i tretë), Cambridge University Press.

Verloo, Mieke. 2005. Mainstreaming gender equality in Europe. A critical frame analysis. The Greek Review of Social Research (**Barazia gjinore në Evropë si normë shoqërore. Një analizë kritike e kornizës**. Buletini grek i kërkimeve sociale) 117 (B): 11–35.

van Zoonen EA (1992) The women's movement and the media: Constructing a public identity.

European Journal of Communication (**Lëvizjet e grave dhe media: Ndërtimi i një identiteti publik**. Buletini Evropian i Komunikimit) 7(4): 453–476.

Wilhelm, A.G. 2000, Democracy in the Digital Age: Challenges to political life in cyberspace. (**Demokracia në epokën dixhitale: Sfidat e internetit ndaj jetës politike**) Routledge, New York/ Londër.

Treguesi i Qëndueshmërisë së Medias, nga IREX, mund të vizitohet në internet tek <https://www.irex.org/projects/media-sustainability-index-msi>

Midis mediave tradicionale dhe mediave sociale

*Studim mbi praktikat e komunikimit
gjatë protestave në Shqipëri*

Ilda Londo

1. Ambienti mediatik

P eizazhi mediatik shqiptar është i pasur dhe i zhvilluar, krahasuar me numrin e vogël të popullsisë, me rreth tre milionë. Numri i organeve të medias nuk dihet me saktësi, pasi shtypi dhe mediat online nuk e kanë të detyruar të regjistrohen. Për momentin ka 23 gazeta të përditshme dhe një numër të madh publikimesh të tjera me periodicitete të ndryshme, që arrijnë shifrën e rreth 250 organeve të medias së shkruar⁴⁷.

Përsa i përket medias audiovizive në vend, situata është më e qartë, pasi ato kanë nevojë të pajisen me licensë dhe të regjistrohen pranë entit rregullator. Deri më sot, ka dy televizione kombëtare private, 71 stacione televizive lokale, 83 televizione kabllore, dhe dy platforma dixhitale komerciale.⁴⁸ Ka gjithashtu 63 stacione radio lokale, dhe dy stacione kombëtare⁴⁹.

Përsa i përket mediave online, ka shumë të dhëna që mbeten ende të panjohura - numri i tyre, mënyra e funksionimit, financimi, dhe numri i personelit të punësuar në

⁴⁷ Treguesi i Qëndrueshmërisë së Medias, nga IREX, 2015.

⁴⁸ Lista e operatorëve të licensuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive mund të lexohet tek: http://ama.gov.al/index.php?option=com_content&view=category&id=21&Itemid=75&lang=sq, faqja u vizitua në tetor 2015.

⁴⁹ Po aty.

këto media - si rrjedhim i mënyrës së funksionimit të sistemit, që nuk kërkon regjistrim dhe formalizim. Në internet ka një numër të madh portalesh në pronësi dhe administrim të mediave tradicionale, pasi televizionet dhe gazetat kryesore i janë përshtatur kërkesës në rritje për më shumë lajme dhe përmbajtje informative në internet. Zakonisht, faqet e internetit të mediave tradicionale kanë më shumë vizitorë sesa mediat që funksionojnë vetëm në internet⁵⁰; por nga ana tjetër duket se nuk ka ndonjë diferencë shumë të madhe në tërheqjen e publikut midis mediave tradicionale dhe atyre online.

Tabloja e përgjithshme e medias shqiptare paraqet një peizazh të pasur, me shumëllojshmëri burimesh informacioni. Këto burime informacioni janë në dispozicion të publikut dhe kostot konsiderohen përgjithësisht të përballueshme. “Ka një ofertë bujare burimesh informacioni nga të gjitha llojet e medias. Edhe zonat më të largëta dhe më të varfra të Shqipërisë marrin sinjal televiziv, kanë TV kabllor dhe mund të marrin lajme online,” vëren Barometri Ballkanik i Medias.⁵¹

Nuk ka dyshim se ambienti mediatik në Shqipëri është i pasur dhe shumë i gjallë, përsa i përket numrit dhe llojit të organeve mediatike, ku media të reja hapen vazhdimisht. Sidoqoftë, ka shumë pak transparencë në funksionimin e tregut. Ashtu si përmendëm më sipër nuk ka shifra të sakta mbi numrin e lexuesve, tirazhin, dhe shitjet e medias së shkruar. Në të njëjtën kohë, nuk ka as shifra të bëra publike, apo të besueshme, mbi shikueshmërinë, apo audiencën, e radiove dhe televizioneve. Në këto dy vitet e fundit janë ndër marrë disa nisma për të matur këtë audiencë, por të

⁵⁰ Renditja në Alexa.com.

⁵¹ Barometri Ballkanik i Medias: Shqipëria, 2013.

dhënat nuk bëhen publike. Për më tepër, këto sondazhe të kohëve të fundit nuk përfshijnë të gjitha mediat, pasi pronarë dhe drejtues të mediave nuk janë të interesuar t'i dinë këto shifra dhe t'i përdorin për planet e tyre të biznesit.⁵²

Në këtë situatë, përqindja e tregut që zë secila media dhe përmasat totale të tregut janë spekulime. Ashtu si doli nga një studim mbi median: “Ndonëse tregu mediatik ka qenë tashmë i liberalizuar për 23 vjet, ka patur vetëm përparim të kufizuar në drejtim të të dhënave publike, sistematike, dhe të besueshme, mbi tregun mediatik dhe financat e mediave. Ka disa arsye komplekse pse gjendemi në këtë situatë, por ato rrjedhin kryesisht nga dështimi në krijimin e një tregu mediatik funksional, mungesa e interesit të aktorëve mediatikë për të patur një treg transparent në media, si dhe dështimin e shtetit në garantimin dhe zbatimin e rregullave të lojës dhe konkurrencën e ndershme midis mediave. Për pasojë, renditja e organeve mediatike shqiptare mund të jetë vetëm një gjykim i bazuar në perceptime sesa në të dhëna të sakta apo matje audiencash, të cilat edhe kur ekzistojnë nuk bëhen publike.”⁵³

Për më tepër, mungesa e të dhënave mbi pozicionin e një organi mediatik në treg sjell mungesë transparence dhe amulli në lidhje me tregun e reklamave. Disa kompani sondazhi dhe marketingu kryejnë monitorime dhe matje të përafërta mbi tregun, por të dhënat e nxjerra prej tyre nuk bëhen publike; por edhe në rastin më të mirë, ato mbeten hamendësime të përafërta. “Në disa raste, të dhënat që vijnë nga burime të ndryshme janë kontadiktore, dhe kjo

⁵² Intervistë me Thanas Gogën, R&T Advertising, 15 maj 2013, cituar në Peace Institute, “Rëndësia e Integritetit të Medias,” Shqipëri 2014.

⁵³ Peace Institute, “Rëndësia e Integritetit të Medias,” Shqipëri 2014.

e përkeqëson edhe më shumë rrëmujën e përgjithshme.”⁵⁴ Vlerësimet e përafërta të tregut të reklamave për vitin 2013 duket se tregojnë një zvogëlim të fondeve në krahasim me shifrat e para të vitit 2012 - nga 54 milionë euro për vitin 2012, në rreth 37-39 milionë euro në 2013.⁵⁵

Po kështu, të ardhurat nga reklamat për vitin 2014 u llogaritën në rreth 37 milionë euro, në krahasim me 39 milionë euro për vitin 2013, një ulje prej pesë përqind. Të dhënat e përafërta për vitin 2015 treguan një ulje të mëtejshme të këtij fondi me rreth 10 përqind.⁵⁶ Këto të dhëna tregojnë për rënie të vazhdueshme të të ardhurave për median e shkruar dhe radiot, ndërsa televizionet vazhdojnë të jenë media më e preferuar për reklama. Përveç të ardhurave nga reklamat komerciale, mediat mund të përfitojnë edhe nga fondet publike. Ligji nuk parashikon subvencione shtetërore mbi median, por kompanitë mediatike përfitojnë nga fondet publike në formën e reklamave, fushatave të ndërgjegjësimit publik, projekteve kulturore, fonde të shpërndara nga agjencitë e reklamave, etj.⁵⁷ Meqë këto fonde shpërndahen në forma të ndryshme dhe nga institucione të ndryshme, është shumë e vështirë që të përcaktohet shuma totale e shpenzimeve shtetërore për mediat.

Vitet e fundit ka patur një rritje të ndjeshme të përdorimit të internetit, që vlerësohet se mbulon 60.1% të popullsisë. Kjo ka sjellë një lulëzim të mediave online, blogjeve, dhe portaleve online, si dhe të përdorimit të rrjeteve sociale. Në

⁵⁴ Po aty.

⁵⁵ Revista Monitor: <http://www.monitor.al/gara-per-milionat-e-publicitetit-2/>

⁵⁶ Revista Monitor: <http://www.monitor.al/bie-tregu-reklamave-televizionet-dhe-gazetat-ne-krize/>

⁵⁷ Peace Institute, “Krijimi i praktikave klienteliste në media,” 2015.

të njëjtën kohë, shumica e mediave tradicionale kanë hapur faqet e tyre në internet, por përmbajtja e tyre nuk është shumë e ndryshme nga përmbajtja e mediave tradicionale. Nga ana tjetër, disa platforma në internet, kanë mundur të realizojnë dhe të botojnë raportime investigative, që më pas kanë patur jehonë dhe janë përdorur nga mediat tradicionale. Një shembull i tillë është BIRN, një rrjet rajonal ballkanik që specializohet në gazetarinë investigative.

Përdorimi më i gjerë i internetit ka sjellë një rritje të ndjeshme në përdorimin e rrjeteve sociale. Facebook është padyshim rrjeti dominant në këtë drejtim, ku numri i profileve arriti në 1,340,000 në vitin 2015⁵⁸. Një tjetër media sociale e preferuar nga shqiptarët është Twitter, por përdorimi i tij është shumë i kufizuar; përdoruesi me numrin më të madh të ndjekësve – rreth 150,000 – është kryeministri Edi Rama. Kjo shifër është shumë më e ulët në krahasim me faqet më të pëlqyera në Facebook.⁵⁹ Në vend të dytë nga rrjetet sociale renditet YouTube, që është edhe faqja e pestë më e përdorur nga shqiptarët në internet.⁶⁰

⁵⁸ Statistikat mbi Facebook në Shqipëri, 2015.

⁵⁹ Media sociale në Shqipëri, 2015.

⁶⁰ Televizioni është burimi i informacionit më i përdorur nga shqiptarët. Ata shpenzojnë mesatarisht 80.9 orë çdo muaj (2 orë e 40 minuta çdo ditë) duke parë televizor. Burimi i dytë informativ që ndiqet për orë të tëra është përdorimi i internetit nga kompjuterat, mesatarisht 29.8 orë në muaj (një orë në ditë). Burime të tjera shumë të përdorura informacioni janë Facebook (27.6 orë në muaj), interneti në celularë (24.9 orë në muaj), YouTube (13.6 orë në muaj), gazeta në letër (9.4 orë në muaj), WhatsApp (4.9 orë në muaj), gazeta online (4.8 orë në muaj), Instagram (2.9 orë në muaj) dhe interneti në tablet (2 orë në muaj). (OSFA, "Anketimi kombëtar mbi perceptimet dhe pritshmëritë drejt anëtarësimit të mundshëm të Shqipërisë në Bashkimin Evropian," 2014)

Sipas një sondazhi të vitit 2014,⁶¹ shqiptarët vazhdojnë të ndjekin televizionin më shumë se çdo media tjetër, duke kaluar çdo ditë 2 orë dhe 40 minuta para televizorit, ndërsa shpenzojnë mesatarisht një orë në ditë në internet. Në fakt, televizioni është burimi më i besueshëm i infomacionit për shqiptarët, me një shkallë miratimi prej 73 përqind, ndërsa kjo shifër nuk shkon më shumë se 43 përqind për median e shkruar dhe 46 përqind për burimet e informacionit online. Gjithashtu, 84 përqind e shqiptarëve thonë se e përdorin televizorin për të ndjekur lajmet nga politika, ndërsa vetëm 10 përqind e përdorin internetin për të njëjtn arsye. Ata janë skeptikë dhe mosbesues ndaj lajmeve që vijnë nga mediat online dhe mediat sociale: 52 përqind e tyre thonë se nuk i besojnë këtyre mediave; por në të njëjtën kohë 67 përqind thonë se këto platforma ofrojnë mundësi të mira për të shprehur opinione individuale.

⁶¹ OSFA, "Anketimi kombëtar mbi perceptimet dhe pritshmëritë drejt anëtarësimit së mundshëm të Shqipërisë në Bashkimin Evropian," 2014.

2. Protestat qytetare dhe kërkesa e llogarisë ndaj qeverisë

Në Shqipëri besimi ndaj qeverisë dhe institucioneve publike nuk është shumë i lartë. “Çfarë bie menjëherë në sy në nivelin e besimit të shqiptarëve ndaj insitucioneve është ndjenja e fortë e mosbesimit. Ndërsa mosbesimi ndaj institucioneve publike ka qenë një simptomë e zakonshme në shoqëritë në tranzicion post-komunist, mosbesimi institucional është shumë i ngulitur në shoqërinë shqiptare.”⁶² Studime dhe anketime të ndryshme mbi besimin ndaj institucioneve nëpër vite tregojnë se kjo dukuri është konstante. Një studim i vitit 2010 doli në përfundimin se nota e besimit që iu dha institucioneve ishte 43.8 pikë, në një shkallë vlerësimi 0-100; ku 0 do të thotë “Nuk u besoj fare” dhe 100 do të thotë “U besoj shumë”.⁶³ Një tjetër sondazh, në vitin 2012, mbi perceptimin e shqiptarëve raportoi se ata nuk u besojnë institucioneve. Në fakt, shqiptarët kanë më shumë besim tek institucionet e komunitetit ndërkombëtar,⁶⁴ ku

⁶² AIIS, “Albanians and the new European Model,” (*Shqiptarët dhe modeli i ri evropian*) 2015.

⁶³ IDRA, “Corruption in Albania: Perception and Experience: Survey,” (*Korrupsioni në Shqipëri: perceptime dhe eksperiencia: sondazh*) 2010.

⁶⁴ Komuniteti ndërkombëtar përdoret si term për të përshkruar përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare dhe ndër-qeveritare (OKB, BE, OSBE, etj.) si dhe përfaqësuesve të qeverive të huaja (kryesisht të shteteve perëndimore) në vend.

30 përqind e të anketuarve thonë se kanë shumë besim tek ta, dhe 37 përqind përgjigjen se kanë një farë besimi te ndërkombëtarët.”⁶⁵

Besimi i publikut në aftësinë e institucioneve për të përmbushur funksionet e tyre publike ka qenë vazhdimisht shumë i ulët ndër vite. Gjykatat dhe partitë politike gjithmonë renditen si më pak të besuarat, duke identifikuar dy shqetësimet kryesore të shqiptarëve – zbatimin e ligjit dhe pakënaqësitë në lidhje me zhvillimin dhe dinamikat e sistemit politik. Kështu, në një studim mbi treguesin e perceptimit të korrupsionit për periudhën 2005 deri në 2010,⁶⁶ institucionet që morën notën më të ulët ishin partitë politike, parlamenti, gjykatat e shkallëve të ndryshme, dhe qeveria. Në veçanti, një karakteristikë konstante e opinionit publik shqiptar ndër vite ka qenë shkalla e ulët e besimit ndaj partive politike. Një studim i vitit 2012 tregoi se “vetëm një e treta e të anketuarve tha se kishte besim te dy partitë kryesore politike, Partinë Socialiste, dhe Partinë Demokratike, ndërsa rreth 60 përqind e tyre thanë se ndiheshin të zhgënjyer nga klasa politike. Mund të thuhet se ka një farë lodhje ndaj politikës, dhe kjo pasqyrohet me nivelin e ulët të besimit kundrejt partive kryesore.”⁶⁷ Kjo është një ndjesi që ndeshet edhe te brezi i ri, që tregon një mungesë të theksuar interesi ndaj politikës apo e shikon thjesht si një mënyrë për të çarë përpara dhe për të bërë

⁶⁵ AIIS, “Albania in the next ten years: Politics, Economy, Society-Perceptions,” (*Shqipëria në 10 vitet e ardhshme: politika, ekonomia, shoqëria. Perceptime*) 2012.

⁶⁶ IDRA, “Corruption in Albania: Perception and Experience: Survey 2010” (*Korrupsioni në Shqipëri: perceptime dhe eksperiencia: sondazh 2010*).

⁶⁷ Po aty.

karrierë, dhe jo si një mundësi për të ndikuar në ndryshime të rëndësishme për shoqërinë.⁶⁸

Në lidhje me besimin e publikut ndaj institucioneve të ndryshme, një karakteristikë e veçantë është edhe besimi relativ që publiku ka ndaj medias, veçanërisht mbi ndihmesën e saj në luftën kundër korrupsionit. Çdo vit media ka dalë si institucioni më pak i korruptuar në sondazhet e zhvilluara gjatë periudhës 2005-2010.⁶⁹ Gjithashtu, në vitin 2012 media u rendit si institucioni i dytë më i besueshëm nga publiku, pas komunitetit ndërkombëtar, ku 18 përqind e të anketuarve tha se kishin “shumë besim” te media, dhe 45 përqind kishin njëfarë besimi tek ajo.⁷⁰ Të dhënat e nxjerra në vitin 2014 gjithashtu tregojnë se media vazhdon të renditet në vendet e fundit në klasifikimin e mosbesimit, krahasuar me institucionet dhe organizatat e tjera.⁷¹

Një element i rëndësishëm që lidhet me mungesën e besimit ndaj qeverisë dhe institucioneve publike është edhe niveli i perceptuar i korrupsionit, që ka vazhduar përgjatë gjithë periudhës të tranzicionit dhe konsiderohet si një problemet më të mëdha të shoqërisë shqiptare. Shqipëria renditet në vendin 110-tëndërmjet 175 vendeve në Treguesin e perceptimit të korrupsionit të Transparency International

⁶⁸ FES, “Albanian youth 2011: Between present hopes and future insecurities,” (*Rinia shqiptare 2011: Midis shpresës sot dhe pasigurisë për të ardhmen*)

⁶⁹ IDRA, “Corruption in Albania: Perception and Experience,” Surveys 2005- 2010 (*Korrupsioni në Shqipëri: perceptime dhe eksperiencia: sondazhe 2005-2010*).

⁷⁰ AIIS, “Albania in the next ten years: Politics, Economy, Society-Perceptions,” (*Shqipëria në 10 vitet e ardhshme: politika, ekonomia, shoqëria. Perceptime*) 2012.

⁷¹ AIIS, “Albanians and the new European Model,” (*Shqiptarët dhe modeli i ri evropian*) 2015.

për vitin 2014. Po kështu, ka një nivel të lartë pakënaqësie në lidhje me shërbimet e ofruara nga institucionet publike, ku 57 përqind e të intervistuarve thonë se shërbimet publike mezi ofrojnë edhe minimumim e nevojshëm.⁷² Nga ana tjetër, perceptimit të nivelit të lartë të korrupsionit në pushtetin ekzekutiv dhe gjyqësor, i shtohet edhe perceptimi i nivelit të ulët të transparencës të këtyre institucioneve. Në sondazhet e opinionit publik për periudhën 2005-2010, perceptimi i përgjithshëm i transparencës ishte i ulët.⁷³ Raportet mbi zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit në kërkesat për informacion nga media dhe qytetarë të thjeshtë tregojnë se vetëm 60 përqind e këtyre kërkesave plotësohet, dhe ndonjëherë informacioni nuk është ai që kërkohet.⁷⁴

Megjithë pakënaqësinë ndaj punës së qeverisë dhe institucioneve publike ndër vite, protestat qytetare në vend kanë qenë të rralla dhe gati nuk ka asnjë mobilizim të shoqërisë në aktivitete publike. Përveç partive politike, që kanë mekanizmat e tyre për të mobilizuar mbështetjen e simpatizantëve, organizata të tjera kanë patur shumë pak sukses në organizimin e protestave popullore dhe lëvizjeve shoqërore të fuqishme. Po ashtu, nismat qytetare kanë qenë të rralla dhe nuk kanë patur shumë sukses. Arsyet për këtë pasivitet të tejzgjatur janë të shumta dhe komplekse, por pjesërisht kjo mund të shpjegohet me trashëgiminë politike

⁷² AIIS, "Albanians and the new European Model," (*Shqiptarët dhe modeli i ri evropian*) 2015.

⁷³ Perceptimi i përgjithshëm i transparencës mbi gjyqësorin dhe qeverinë ishte nën mesataren e vlerësimeve për nëntë institucionet e marra në konsideratë në sondazhin e vitit 2010. IDRA, "Corruption in Albania: Perception and Experience," (*Korrupsioni në Shqipëri: perceptime dhe eksperiencia: sondazh*) Sondazhe 2005-2010.

⁷⁴ Raportet vjetore të Institutit shqiptar të medias 2015, 2014, 2013, 2012.

dhe kulturore nga sistemi i kaluar. Në Shqipëri, ndryshimi i sistemit nuk u mbështet dhe nuk u frymëzua nga ndonjë shoqëri civile aktive, dhe nuk bëhej fare fjalë për resistencë civile. Pas fillimit të viteve 90, shoqëria civile duhet të mobilizohej dhe të krijohej nga hiçi, duke u përballur me mungesën e traditës së organizimit, pjesëmarrjes dhe aktivizimit qytetar. Shtypja e të gjitha llojeve të rezistencës shoqërore, ndalimi me ligj i organizatave të pavarura që nga viti 1956, dhe krijimi i organizatave kukull për të komunikuar linjën e partisë-shtet, kontribuan në krijimin e një hapësire shoqërore shterpë ku partia dhe shoqëria ishin të padallueshme dhe të pandashme nga njëra-tjetra. Për rrjedhojë, krijimi dhe zhvillimi i shoqërisë civile në Shqipëri nuk kishte atributet normative që fitoi në vendet e tjera post-komuniste, si faktor i rëndësishëm në ndryshimin e sistemit.⁷⁵ Sipas të dhënave zyrtare, në fund të vitit 2014 kishte 2,378 organizata joqeveritare dhe organizata ndërkombëtare në vend. Sidoqoftë, ato nuk shihen si shumë të suksesshme në angazhimin e bazës në lëvizje popullore apo thithjen e mbështetjes së publikut rreth çështjeve dhe aktiviteteve të ndryshme.

Organizatat e shoqërisë civile, dhe efektshmëria e tyre në punë, vuajnë gjithashtu dhe nga mungesa e besimit të publikut shqiptar ndaj tyre, ndërkohë që vetë shoqëria civile duket se është e përçarë politikisht. Organizatat joqeveritare shqiptare shpesh konsiderohen të njëanshme dhe përgjithësisht ndahen në mbështetëse të qeverisë apo

⁷⁵ Bertelsmann Stiftung, "Bertelsmann Transformation Index 2012: Albania Country Report," (*Treguesi Bertelsmann i transformimit 2012: Raporti mbi Shqipërinë*) (Bertelsmann Stiftung: Gütersloh, 2012), faqe 22.

opozitës.⁷⁶ Sipas një burimi tjetër, “organizatat dhe shoqatat civile akoma nuk e kanë shpallur autonominë e tyre politike kundrejt prirjeve në rritje të ndikimit të politikës, ndërsa shumë OJQ shpesh shërbejnë si shërbëtoreshë të politikës dhe jo si organizime publike autonome”.⁷⁷ OJQ-të shqiptare gjithashtu janë thuajse krejtësisht të varura nga financimet e huaja, dhe shpesh vuajnë nga mungesa kronike e fondeve dhe burimeve njerëzore. Që nga viti 2009, shteti ka ofruar financime të OJQ-ve të ndryshme nëpërmjet një agjencie të ngritur posaçërisht për këtë arsye. Kjo agjenci është kritikuar vazhdimisht nga shoqëria civile për shpërndarjen e fondeve për projekte, duke pretenduar se besnikëria ndaj qeverisë është kriteri kryesor për dhënien e fondeve.⁷⁸

Megjithëse organizatat e shoqërisë civile nuk janë shumë të forta dhe kanë mangësi në mobilizimin e mbështetjes nga publiku, ato përsëri organizojnë shpesh protesta dhe aktivitete të fokusuar në fushën e tyre specifike, që zakonisht kanë të bëjnë me çështje sociale. Këto aktivitete kanë të bëjnë më shumë me barazinë gjinore (dhuna në familje, ekuilibri gjinor në politikë dhe fusha të tjera, mundësi të barabarta, etj.), të drejtat e fëmijëve (mbrojtje, shkollim), dhe personat me aftësi të kufizuara. Nga ana tjetër, ka dhe shoqata dhe organizata të tjera si sindikata, shoqata ish-oficerësh, apo të

⁷⁶ Ulrike Stern dhe Sarah Wohlfield, “Albania’s Long Road into the European Union: Internal Political Power Struggle Blocks Central Reforms” (*Rruga e gjatë e Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian: lufta e brendshme politike për pushtet pengon reformat thelbësore*) (Deutsche Gesellschaft für Auswärtige Politik [DGAP]: Berlin, 2012), faqe 11.

⁷⁷ Bertelsmann Stiftung, “Bertelsmann Transformation Index 2012,” (*Treguesi Bertelsmann i transformimit 2012*) faqe 23.

⁷⁸ Stern dhe Wohlfield, “Albania’s Long Road into the European Union,” (*Rruga e gjatë e Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian*) faqe 12.

veteranëve të luftës, që gjithashtu kërkojnë të përmirësojnë situatën e tyre nëpërmjet protestave në rrugë, ndërhyrjeve në parlament për ndryshime legjislacioni, si dhe fushata ndërgjegjësimi.

Me përhapjen e internetit dhe përdorimin më të gjerë të faqeve në Facebook, kanë dalë edhe forma të reja protestash. Për shembull, në vitin 2013, para zgjedhjeve parlamentare, në Facebook nisi një fushatë proteste “jo-votë,” apo e thënë ndryshe: një votë kundër klasës politike. Kjo fushatë i bënte thirrje votuesve të zhgënjyer që të hidhnin në kuti një fletë votimi të mbushur keq dhe të pavlefshme, duke hedhur poshtë të gjithë kandidatët në zgjedhje. Një protestë tjetër e nisur po në Facebook, ishte grumbullimi i një numri protestuesish përpara Bankës së Shqipërisë, që kërkonin arrestimin e guvernatorit, pasi u zbulua se një sasi e madhe lekësh ishte zhdukur nga thesari i shtetit. Ka patur edhe përpjekje të tjera spontane për organizime tubimesh apo protestash nëpërmjet faqeve në Facebook në raste vrasjesh, aksidentesh të rënda, apo çështje me rëndësi kombëtare, por ato zakonisht nuk arrijnë të mobilizojnë një numër të madh njerëzish.

3. Protestat e qytetarëve gjatë periudhës 2013 - 2015

Ky studim paraqet një analizë të praktikave dhe metodave të komunikimit gjatë tre protestave të ndryshme. Kriteri kryesor në përzgjedhjen e rasteve për analizë kishte të bënte me protesta që perceptoheshin se nuk kishin lidhje me kauza të partive politike apo që nuk kishin as mbështetje indirekte të partive politike. Rasti kryesor i analizuar ishte protesta kundër shkatërrimit të armëve kimike, që dukej se nuk mbështetej nga ndonjë grupim politik, dhe e njëjta gjë mund të thuhet edhe për protestën kundër ndërtimit të pallateve pranë liqenit artificial. Edhe kur organizatorët e protestave kanë bindje të qarta politike, ata zakonisht pozicionohen kundër klasës politike aktuale. Për shembull, në rastin e protestave studentore, disa nga protestuesit ishin aktivistë të krahut të majtë, por në deklaratat e tyre publike ata iu kundërvunë shumë hapur partive të majta në qeveri dhe forcave të tjera politike. Nga ky këndvështrim, këto tre protesta janë disa nga rastet e rralla të shprehjes spontane të pakënaqësisë popullore në Shqipëri që nuk organizohen apo mbështeten nga parti politike, apo nga shoqata të mirënjohura të shoqërisë civile.

Kohëzgjatja e protestave ishte një faktor tjetër në përzgjedhjen e këtyre rasteve. Shumë nga protestat e zhvilluara këto vitet e fundit zakonisht shfryheshin pas një dite të vetme. Por të paktën dy nga tre rastet e marra

në konsideratë nuk bëjnë pjesë në këtë kategori. Protesta kundër armëve kimike zgjati dhe u forcua dita-ditës për dy javë rresht, derisa u arrit rezultati i dëshiruar. Protesta e studentëve ishte një shembull i pastër këmbënguljeje, dhe prej saj u krijua një lëvizje e re: studentët kanë protestuar rregullisht përgjatë gjithë vitit 2015, në forma të ndryshme, si protesta në rrugë, pushtim dhe bllokim i ndërtesave të universitetit, ndërhyrje dhe prishje aktivitetesh, etj.

Një tjetër faktor që ndikoi në përzgjedhje ishte edhe numri i protestuesve. Megjithëse nuk pati shifra të sakta mbi pjesëmarrjen në protesta nga burime zyrtare, nga media, apo edhe nga vetë protestuesit, demonstratat kundër armëve kimike jo vetëm që vazhduan gjatë, por ishin edhe tejet masive, me protestues që bllokuan rrugët kryesore të kryeqytetit (nuk ka të dhëna të sakta mbi numrin e tyre, por disa raportime flasin për më shumë se qindra pjesëmarrës), dhe qyteteve të tjera të Shqipërisë. Protestat e studentëve, megjithëse shumë më të vogla në numër, dhe të kufizuara në një kategori të veçantë protestuesish, kanë qenë aktivitete serioze dhe të organizuara rregullisht. Duke patur parasysh se gjatë këtyre 20 viteve të fundit mitingjet e partive politike ishin të vetmet aktivitete që mobilizonin turma njerëzish, ishte me rëndësi që të analizoheshin këto raste të veçanta, kaq të ndryshme nga praktika e zakonshme.

Protestat e studentëve vazhdojnë edhe sot e kësaj dite. Objekti i protestës vazhdon të jetë ligji mbi reformën në arsim dhe çështje të tjera që lidhen me arsimin e lartë. Në disa raste protestuesit janë munduar të përfshijnë edhe ndonjë komponent tjetër social, si për shembull rritjen e çmimit të biletave në transportin publik dhe vendimin për ndërtimin e shesheve të parkimit. Protestat kundër ndërtimit të pallateve u zbehën disi pasi gjykata vendosi të pezullojë ndërtimin e pallateve. Sidoqoftë, çështja vazhdon të jetë në gjykim dhe

nuk dihet akoma se çfarë efekti mund të kenë mbi protestën vendimet e mëvonshme të gjykatës. Nga ana tjetër, protesta që është edhe rasti kryesor në studim përfundoi në nëntor 2013, kur qeveria mori një vendim në përputhje me kërkesat e protestuesve. Më poshtë po paraqesim një përshkrim të secilës protestë të marrë në studim, më kërkesat, dinamikën, dhe zhvillimin e tyre.

Protestat kundër propozimit për shkatërrimin e armëve kimike nga Siria

Në tetor 2013, filluan të qarkullonin disa informacione të pakonfirmuara se Shtetet e Bashkuara të Amerikës kishin propozuar Shqipërinë si vend pritës për shkatërrimin e armëve kimike të hequra nga Siria. Qeveria heshti, dhe as i konfirmoi, as i hodhi poshtë këto raportime. Si rezultat i këtij lajmi alarmues dhe mungesës së plotë të informimit nga burimet zyrtare, filloi të përhapej panik dhe një lëvizje online filloi të përhapej në Facebook, me titullin “Një milionë shqiptarë kundër shkatërrimit të armëve kimike në Shqipëri,” kryesisht me pjesëmarrjen e studentëve dhe aktivistëve. Shumë shpejt grupe protestuesish filuan të mblidheshin përpara ndërtesave qeveritare dhe kryeministrisë. Në fillim, nuk ishin më shumë se 50 vetë, por numri i tyre nisi të rritej ndërsa qeveria vazhdonte të qëndronte në heshtje të plotë. Protestuesit organizoheshin nëpërmjet faqeve në Facebook, në faqen kryesore të protestës, por edhe nga personazhe publike që merrnin pjesë në protestë, si ambientalistë, gazetarë dhe redaktorë, dhe aktivistë të mbrojtjes të drejtave të njeriut. Ndërsa situata tensionohej gjithnjë e më shumë dhe qeveria vazhdonte të qëndronte në heshtje, protestuesit vendosën të qëndronin jashtë në protestë gjatë gjithë natës. Protestat përfunduan më 15 nëntor kur kryeministri deklaroi

në një konferencë shtypi se kishte vendosur të mos pranonte propozimin e Shteteve të Bashkuara. Pas protestave të fillimit të viteve '90, që sollën rënien e regjimit socialist, kjo ishte protesta e parë publike masive që nuk organizohej nga ndonjë forcë politike. Për këtë arsye është e rëndësishme të studiohet ky rast, si përjashtim nga norma, dhe të analizojmë si u realizua komunikimi që bëri të mundur mbajtjen në këmbë të një proteste kaq masive.

Lëvizja studentore “Për universitetin” kundër ndryshimit të ligjit mbi arsimin

Në tetor 2014, studentët e universitetit shtetëror të Tiranës filluan të protestonin kundër një vendimi të qeverisë për të rritur kuotat e pagesës për sistemin master në shkollat e larta publike. Protestat nisën në gjirin e këshillave studentore në fakultete, me demonstrata publike dhe mbledhje firmash për peticione përballë ndërtesave qeveritare; në disa raste pedagogët nuk u lejuan të hynin në ndërtesat e universitetit, si një lloj lëvizje ‘Occupy’ (Pushto). Në javën e parë të nëntorit, protestat u vunë në qendër të vëmendjes së publikut dhe medias, kur kryeministri ndërpreu një mbledhje të qeverisë për të biseduar me protestues që ishin mbledhur përballë ndërtesës ku po zhvillohej takimi. Protestat vazhduan në ndërtesat e universitetit, në rrugë, përballë parlamentit dhe ndërtesave qeveritare. Një tjetër akt proteste u zhvillua më 8 dhjetor 2014, kur disa studentë ‘u futën fshehurazi’ në një aktivitet publik ku merrte pjesë kryeministri, duke hedhur slogane proteste dhe duke mbajtur pankarta kundër rritjes së pagesave, dhe ndryshimit të modelit të financimit në arsimin publik. Organizatorët kryesorë të protestës janë anëtarët e lëvizjes studentore “Për universitetin,” një grupim studentësh nga Universiteti i Tiranës, që kryesisht funksionon nëpërmjet

faqeve në Facebook, por edhe me takime midis studentësh. Ata nisën gjithashtu edhe botimin e gazetës të përmuajshme *Për universitetin* si një forum për shprehjen e opinioneve të pjesëmarrësve të lëvizjes. Ky është rasti i parë i organizimit dhe mbajtjes së protestave nga vetë studentët gjatë këtyre 20 viteve të fundit, dhe për këtë arsye është i rëndësishëm për studimin tonë.

Protestat kundër ndërtimit të pallateve afër parkut dhe liqenit artificial të Tiranës

Rasti i tretë ka të bëjë me një lëvizje proteste kundër ndërtimit të disa pallateve të banimit në zonën më të gjelbër të Tiranës. Parqet dhe hapërsirat e gjelbra në Tiranë janë zhdukur vit pas viti si pasojë e ndërtimeve të vazhdueshme pa kriter. Aktiviteti ndërtues është zhvilluar me intensitet të lartë për më shumë se 20 vjet, duke shkelur dhe manipuluar rregullat e ndërtimit dhe arkitekturës, por ky ishte rast i veçantë pasi kishte të bënte me pasojat e mundshme të dëmtimit të parkut kryesor të Tiranës, sidomos nga planet e zgjerimit të kësaj zone ndërtimi në kurriz të parkut të liqenit. Punimet për ndërtim filluan në shkurt-prill 2015, dhe nxitën pakënaqësi midis një grupi qytetarësh që organizuan disa protesta në zonën e ndërtimit dhe përballë kryeministrit, duke kërkuar që ndërtimi të ndalej. Protestat e tyre u raportuan gjerësisht në media; ata organizohen dhe komunikojnë kryesisht nëpërmjet faqeve dhe postimeve në Facebook dhe me lista e-mail, si dhe duke dhënë intervista për mediat kryesore. Protestat ndalën pasi një gjykatë vendosi që leja e ndërtimit nuk ishte e vlefshme. Sidoqoftë, mbetet për t'u parë si do të vendosin gjykatat në shkallët e tjera dhe çfarë efekti mund të kenë këto vendime mbi protestat.

4. Përzgjedhja e rasteve studimore

Studimi ka për qëllim që të analizojë metodat e komunikimit gjatë protestave qytetare dhe të vlerësojë efektin e këtyre praktikave ndaj përgjegjësisë publike dhe kërkesës së llogarisë. Në këtë këndvështrim, studimi përqendrohet në tre pika kryesore. Pika e parë ka të bëjë me rolin e organeve të medias në komunikimin gjatë protestave; t'i përgjigjemi pyetjes si ka punuar media gjatë zhvillimit të protestave dhe çfarë ndikimi kanë patur në raportim aktorë dhe faktorë të ndryshëm. Pika e dytë merret me metodat e komunikimit të përdorura nga aktivistët dhe qytetarët, duke u përqendruar te mënyra e kontaktit me mediat kryesore, dhe si i kanë përdorur platformat e ndryshme informative për të mobilizuar publikun dhe për t'u organizuar. Pika e tretë ka të bëjë me praktikën dhe metodat e komunikimit nga autoritetet gjatë zhvillimit të protestave, duke studiuar mënyrën si u sollën me median dhe me protestuesit, si dhe metodat dhe mjetet e përdorura prej tyre. Së fundmi, të gjitha këto pyetje na orientojnë drejt një analize të ndikimit që mund të kenë patur protestat dhe komunikimi ndaj përgjegjësisë publike dhe vënies para përgjegjësisë të institucioneve.

Për të studiuar këtë aspekt u përdor metoda cilësore e kërkimit. Studimi u bazua në analizimin e tre rasteve studimore, ku rasti primar u studiuua edhe nëpërmjet analizës së përmbajtjes të raportimit në media dhe me intervista,

ndërsa dy rastet e tjera u studiuan nëpërmjet intervistave me aktorët kryesorë. U zhvilluan intervista me gazetarë, protestues dhe zyrtarë – 20 intervista të thelluara në detaje, gjysmë të strukturuar – që të përftoheshin vëzhgimet e tyre dhe perceptimet ndaj proceseve komunikuese gjatë protestave. Të intervistuarit përfshinë shtatë protestues, shtatë përfaqësues të medias, dhe gjashtë zyrtarë nga policia, ministritë, dhe partitë politike. Sidoqoftë, ndarja nganjëherë ishte e turbullt, pasi disa nga gazetarët kishin marrë pjesë në mënyrë aktive në protesta, veçanërisht në protestën më të madhe kundër shkatërrimit të armëve kimike në Shqipëri. Midis përfaqësuesve të medias kishte gazetarë nga televizioni publik dhe dy stacionet kombëtare komerciale. Gjithashtu u intervistuan autorë blogjesh, dhe redaktorë të mediave online, duke patur parasysh rëndësinë në rritje të mediave të reja si forum i debatit publik dhe dhënies së lajmeve.

Të intervistuarit në listën përfundimtare nuk kërkuan të mbeteshin anonimë. Sidoqoftë, katër persona, të gjithë zyrtarë partiakë dhe përfaqësues të organeve shtetërore, refuzuan të merrnin pjesë në intervista, duke u justifikuar me mungesën e kohës dhe me zhvillimin e një fushate elektorale në vend. Një përfaqësues i policisë tha se nuk ishte personi i duhur për të dhënë informacion për protestat e kaluara, pasi ai nuk ishte në detyrë gjatë zhvillimit të tyre.

Përveç intervistave, rezultatet e studimit bazohen në analizën e përmbajtjes së raportimit në media për rastin e protestës kundër armëve kimike. Identifikimi i shembujve dhe mostrave për të gjithë studimin u bazua në përzgjedhjen e mediave me publik më të gjerë, por në rastin e Shqipërisë kjo është një detyrë pak e vështirë, duke patur parasysh mungesën e të dhënave zyrtare dhe publike në lidhje me audiencën dhe numrin e lexuesve. Si rezultat, në lidhje me stacionet televizive, analiza përfshiu televizionin

publik TVSH dhe dy stacionet e tjera komerciale me licensë kombëtare, pasi mendohet se ato kanë shtrirje më të madhe në popullatë përse i përket zonës së mbulimit me sinjal. Dy stacionet e tjera televizive u zgjodhën në bazë të përceptimit të përgjithshëm të rëndësisë dhe audiencës së tyre si dhe natyrës së përmbajtjes së tyre: VizionPlus TV është një nga televizionet kryesore me karakter të përgjithshëm pas stacioneve komerciale kombëtare, ndërsa Ora News TV është një nga stacionet kryesore të lajmeve 24 orë në vend. Gjithashtu, përzgjedhja mori parasysh edhe pronësinë dhe politikat editoriale të stacioneve televizive. Për shembull, News 24 TV është një nga stacionet kryesore të specializuara me lajme 24 orë, por ky stacion televiziv është pjesë e një grupi mediatik që përfshin edhe portalin e lajmeve në internet Balkanweb, dhe u vlerësua që ishte më mirë të përfshihej në studim portali online, duke qenë se është një nga më të rëndësishmit në vend. Në lidhje me mediat në internet, përzgjedhja u krye në bazë të renditjeve të dhëna nga alexa.com, një faqe interneti që jep të dhëna mbi trafikun në faqet komerciale. Megjithëse ky është një burim informacioni që kritikohet shpesh për mungesë besueshmërie nga përfaqësues të mediave online, nuk ka mënyrë tjetër, për momentin, që të bësh një renditje të mediave online në vend, ngaqë vetë këto media nuk raportojnë në mënyrë të besueshme mbi numrin e vizitorëve.

Gjithsej, 50 kronika lajmesh dhe 30 artikuj online u morën në analizë. Mediat e përzgjedhura janë renditur si më poshtë:

- Radio Televizioni Shqiptar (RTSH)
- Top Channel TV
- TV Klan
- Vizion Plus TV

- Ora News TV
- Balkanweb.com, një nga portalet kryesore të lajmeve në internet
- Albeu.com, portal lajmesh
- Lajmifundit.al, portal lajmesh

Analiza përfshiu përmbajtjen e publikuar gjatë periudhës së protestës, nga 30 tetori deri në 15 nëntor 2013. Duhet nënvizuar fakti se disa nga mediat kryesore nuk raportuan mbi protestën që nga dita e parë, por filluan mbulimin e saj një apo dy ditë më vonë, pas mediave të tjera, gjithashtu edhe ngaqë lajmi fillestar për sjelljen e armëve kimike në vend ishte marrë nga një artikull i botuar në një media të huaj dhe nuk kishte konfirmim zyrtar. Gjithashtu, mbledhja e përmbajtjes mediatike ishte e vështirë, pasi kishin kaluar dy vjet që nga protesta dhe disa kronika lajmesh nuk gjendeshin më. Sidoqoftë, kjo u zgjidh nëpërmjet kontakteve me mediat përkatëse, kryesisht me televizionin publik RTSH, dhe procesi i nxjerrjes dhe analizimit të të dhënave vazhdoi normalisht.

Meqë periudha e raportimit mbulonte një periudhë 15-ditore dhe analiza e përmbajtjes do të përfshinte 10 kronika apo artikuj nga çdo media, përzgjedhja u bë në varësi të momenteve më të rëndësishme, që të përfshinte në analizë momentet e pikut, nisjen e protestave, si dhe ditët ndërmjet kur kishte zhvillime të reja që kishin tërhequr vëmendjen e medias, si kronika apo artikulli i parë nga protesta, reagimet e pakta të zyrtarëve, si dhe aktivitetet e ambientalistëve përpara fillimit të protestave në rrugë. Monitorimi i përmbajtjes përfshiu raportime mbi fillimin e protestave, rritjen e numrit të protestuesve, reagimin e parë të qeverisë, kulmin e protestave në rrugë, dhe vendimin përfundimtar të qeverisë dhe përgjigjen e protestuesve.

5. Rezultatet e kërkimit

5.1 Protestat: kornizimi në media dhe perceptimi

Studimi i perceptimit të protestave nga të intervistuarit nga njëra anë dhe kornizimit (*framing*) në media nga ana tjetër, na lejon të krahasojmë të dhëna dhe informacione dhe të analizojmë rolin e medias në krijimin e perceptimeve të publikut mbi protestat dhe në formimin e opinioneve të atyre që i ndjekin protestat nga afër. Për këtë arsye, ky kapitull merr në analizë perceptimet e përgjithshme të të intervistuarve rreth natyrës dhe rolit të protestave, që ndiqet më pas nga analiza e përmbajtjes për të studiuar kornizimin e protestës në media.

Perceptimet e përgjithshme mbi rolin dhe karakteristikat e protestave

Rezultatet e studimit tregojnë se protestat perceptohen si një instrument me rëndësi jetike për demokracinë dhe mungesa e tyre do ta kthente demokracinë në një mekanizëm të ndryshkur.⁷⁹ Protestat shihen si mënyra më paqësore dhe demokratike për të ushtruar të drejtat individuale dhe për të kërkuar respektin për të drejtat e njeriut. Asnjë

⁷⁹ Intervistë me Erion Kriston, aktivist.

nga të intervistuarit - protestues, gazetarë, apo zyrtarë - nuk i lidhi protestat me dhunën, as në perceptimet e tyre të përgjithshme mbi protestat, dhe as kur bëhet fjalë për këto raste apo protesta të veçanta. Kjo mund të lidhet me faktin se protestat në Shqipëri nuk kanë qenë gati kurrë të dhunshme, përveç disa mitingjeve të partive politike. Për më tepër, disa të intervistuar i konsiderojnë vetë protestat si tregues të shëndetit të demokracisë në një vend: “Protestat janë një instrument ndihmës i pazëvendësueshëm për demokracinë. Pavarësisht sa e zhvilluar dhe e përparur është një demokraci, protestat mbeten një element thelbësor, dhe protesta zhvillohen rregullisht kudo.”⁸⁰ Madje një nga të intervistuarit i shikon protestat si institucion apo pushtet më vete: “Roli i protestave në demokraci është një institucion më vete, fill pas medias dhe gjyqësorit: pushteti i qytetarëve.”⁸¹ Sidoqoftë, ka edhe disa sugjerime se protestat nuk duhen lavdëruar edhe aq shumë, kur marrim në analizë nivelin e demokracisë në shoqëri. “Protestat janë një mënyrë e shprehjes së pakënaqësive që nuk gjejnë dot zgjidhje nga administrata dhe mekanizmi burokratik. Sidoqoftë, ato janë një tregues i qartë i mungesës së demokracisë, pasi në vendet e zhvilluara format ‘radikale’ të veprimtimit politik janë formalizuar dhe janë bërë pjesë e proceseve vendimmarrëse, si për shembull, në rastet e referendumeve.”⁸²

Nga studimi doli se të intervistuarit kishin të njëjtin perceptim edhe për lidhjen midis protestave dhe përgjegjësisë publike: protestat janë një mënyrë e komunikimit të pakënaqësive të zyrtarët shtetërorë të zgjedhur apo të

⁸⁰ Intervistë me Blendi Salaj, gazetar, Club FM Radio dhe protestues.

⁸¹ Intervistë me Sazan Gurin, ambientalist.

⁸² Intervistë me Ervin Gocin, protestues, pedagog i gazetarisë në Universitetin e Tiranës.

emëruar në postet e tyre, për t'i treguar atyre se nuk po përfaqësojnë vullnetin e masës, dëshirat dhe aspiratat e popullit dhe se kjo situatë duhet të ndryshojë. “Protestat janë shumë të rëndësishme në misionin e tyre për të ndryshuar kursin e gabuar që mund të çojë në dhunimin e të drejtave të qytetarëve dhe dështimin e respektimit të vullnetit të tyre,” tha një gazetarët e intervistuar.⁸³ Një përfaqësues i protestuesve bie dakord me këtë këndvështrim: “Protestat janë të nevojshme dhe janë një mënyrë e mirë për të shprehur pakënaqësitë dhe indinjatën e një shoqërie në një kohë kur qeveria e zgjedhur prej tyre është jofunksionale dhe protestat paqësore mbeten e vetmja zgjidhje legjitime.”⁸⁴ Duke përdorur po të njëjtët tregues të përfaqësimit demokratik, një nga protestuesit deklaroi se protestat janë më të rëndësishme edhe se vetë zgjedhjet: “Zgjedhjet mbahen një herë në katër vjet, por protestat janë një mundësi e mirë për angazhim të përhershëm qytetar.”⁸⁵

Përshtypja e përgjithshme mbi zhvillimin e protestave në Shqipëri është e njollosur nga akuzat dhe dyshimet e instrumentalizimit politik që bien rëndon mbi to. Të intervistuarit vënë në dyshim si motivet ashtu edhe efektshmërinë e shumicës së protestave të zhvilluara në vend. Filli i përbashkët që lidhte perceptimet e të gjithë të intervistuarve ishte se politizimi i protestave është fajtori kryesor për për krijimin e përshtypjes se lëvizjet qytetare janë aktivitete të pavlera për shoqërinë, dhe madje ka shkaktuar edhe delegitimimin e tyre. Ky perceptim lidhet ngushtë me faktin se gati të gjitha protestat masive gjatë

⁸³ Intervistë me Klevis Saliaj, ATN TV.

⁸⁴ Intervistë me Rakip Belishakun, student, protestues.

⁸⁵ Intervistë me Arlind Qorrin, pedagog, protestues.

këtyre 25 viteve të fundit kanë nisur direkt nga partitë kryesore politike ose me ndërhyrjen e tyre.⁸⁶ “Protestat në Shqipëri janë shumë të paqarta, me shumë pak diversitet shoqëror, me tepër politikë, me shumë pak të rinj, dhe akoma më pak intelektualë në protesta; dhe mbi të gjitha me shumë pak përfshirje studentësh në to.”⁸⁷ Kjo është një ndjesi të cilës i bëjnë jehonë jo vetëm protestuesit por edhe gazetarët. “Për fat të keq në Shqipëri protestat më të mëdha kanë qenë mitingje politike, që drejtoheshin nga politikanët kryesorë, dhe ka patur shumë pak raste protestash me sfond social që lidheshin drejtpërdrejt me shërbime të ofruara ndaj qytetarëve apo çështje të ngjashme.”⁸⁸ Një gazetar tjetër vuri në dukje disa shembuj nismash, që në dukje, nisën si lëvizje të pavarura qytetare dhe më pas u shndërruan në lëvizje politike apo edhe parti politike.⁸⁹ Të intervistuar të tjerë i shohin protestat të lidhura ngushtë me faktorë politikë dhe të ndërrmara nga aktorë politikë, dhe kjo sjell një velje të popullit nga këto lloj protestash.

Mungesa e përgjegjësisë publike dhe mungesa e rezultateve nga protestat është një faktor tjetër që shkurajon njerëzit nga përfshirja në demonstrata, sipas të intervistuarve. Megjithëse e drejta për të protestuar garantohet dhe respektohet nga autoritetet shtetërore, kërkesat e protestuesve shpesh nuk merren parasysh nga

⁸⁶ Stern dhe Wohlfield: “Në Shqipëri, ende nuk është kristalizuar plotësisht koncepti se vetë qytetarët kanë kontroll mbi ata që qeverisin dhe se mund të vendosin vetë mbi drejtimin që merr qeverisja e vendit. Kjo provohet edhe nga fakti se protestat dhe referendumet ndodhin vetëm rrallë dhe në nivel lokal.”

⁸⁷ Intervistë me Sazan Gurin, ambientalist, protestues.

⁸⁸ Intervistë me Klevis Saliaj, gazetar, ATN TV.

⁸⁹ Intervistë me Gjergj Erebarën, BIRN, gazetar.

këto autoritete, dhe kjo krijon perceptimin se protestat janë akte të kota. “Protesta është forma më demokratike e kërimit të një të drejte, por këto nisma qytetare shumë rrallë kanë qenë të suksesshme.”⁹⁰

Perceptimi i të intervistuarve mbi tre rastet e demonstratave të marra në analizë nuk ndyshonte nga perceptimet e protestave në përgjithësi: ato shihen si mjete demokratike për shprehjen e shqetësimeve të caktuara ndaj qeverisë dhe institucioneve vendimmarrëse. I vetmi ndryshim ka të bëjë me përmasat e protestave dhe për rrjedhojë edhe me fuqinë përfaqësuese të protestuesve. Shumica e të intervistuarve i konsideruan protestat masive kundër shkatërrimit të armëve kimike në Shqipëri si protesta gjithëpërfshirëse, që bashkuan shumë grupime dhe shtresa të ndryshme në një nga protestat më përfaqësuese të popullit shqiptar në tërësi. “Kjo protestë bashkoi njerëz nga fusha dhe shtresa të ndryshme shoqërore, por ata shprehën njëzëri shqetësimet e shumicës së shqiptarëve në atë kohë.”⁹¹

Kornizimi i protestave në media

Për të marrë në shqyrtim kornizimin e protestave dhe kërkesave të tyre në media, u krye një analizë kornizimi diagnozë-prognozë. Raportimi në media (Tabela 1) gjatë protestave në nëntor 2013 u përqendrua kryesisht mbi sjelljen e demonstruesve dhe shpjegimin e kërkesave të protestuesve dhe arsyetimet e tyre rreth këtyre kërkesave.

⁹⁰ Intervistë me Rezar Ballën, kryeredaktor i lajmeve në RTSH

⁹¹ Intervistë me Blendi Salaj, gazetar Club FM, protestues

Subjekti	Numri i rasteve
Kërkesat e protestuesve dhe arsyetimet e tyre	33
Aktivitete proteste	20
Reagimi i institucioneve	27
Gjithsej	80

Tabela 1 – Subjektet kryesore në media rreth protestave

Subjekti i kryesor i 33 raportimeve nga 80 lajmet e monitoruara përqendrohen mbi shprehjen e kërkesave të protestuesve dhe arsyet e tyre për të dalë në demonstrata. Në këtë pikë, raportimi në media u përqendrua mbi deklaratat e protestuesve: në kundërshtimin e tyre ndaj shkatërrimit të armëve kimike në Shqipëri, në lidhje me problemet rreth sigurisë, shëndetit publik, dhe mungesës së kapaciteteve; si dhe vënia në pikëpyetje e transparencës në qeverisje dhe kërkesës së llogarisë ndaj qeverisë mbi vendime të tilla të një rëndësie kaq të veçantë. Aktivitetet e protestës ishin tema kryesore e 20 artikujve dhe kronikave nga 80 lajmet e monitoruara në media: numri i protestuesve dhe zhvillimi i protestës, raportimi mbi përhapjen në qytete të tjera, përfshirja e grupeve të ndryshme, ndërveprimi me policinë, dhe kështu me radhë. Nga ana tjetër, 27 nga 80 artikujt në media u përqendruan mbi sjellejen dhe reagimin e institucioneve shtetërore ndaj protestës, duke përfshirë një shpjegim të shkurtër nga ministri i punëve të jashtme, Ditmir Bushati, takimi i kryetarit të parlamentit, Ilir Meta, me protestuesit, dhe deklarata për shtyp e shpalljes së vendimit përfundimtar nga kryeministri Edi Rama. Në njëfarë mënyre, kjo ndarje e subjekteve u diktua nga dinamika e protestave dhe heshtja gati e plotë nga ana e qeverisë rreth propozimit që i ishte bërë, negociatave me palët e tjera, dhe ndikimet

që mund të kishin këto veprime për vendin. Kështu, mund të themi se mbulimi mediatik ishte një pasqyrim i zhvillimeve të protestave në terren, si dhe roli i personaliteteve dhe institucioneve të veçanta në të gjithë këtë çështje.

Kornizimi i problemeve dhe zgjidhjeve në media

Analiza identifikoi tre kornizime të ndryshme mbi diagnozën (Tabela 2): dy kornizimet dominante ishin rreziku ndaj sigurisë dhe shëndetit publik nga shkatërrimi i armëve kimike në Shqipëri, dhe shqetësimi publik ndaj keqqueverisjes

Diagnoza

Kornizimet kryesore të diagnozës	N	Nënkornizimet e diagnozës	N
Rreziku publik	81	Mungesa e sigurisë në proces	66
		Mungesa e kapaciteteve /eksperiencës	8
		Mungesa e bazës ligjore, mangësi në ligjshmërinë e shkatërrimit të mundshëm të armëve kimike	7
Qeverisje e keqe	66	Mungesë transparence	11
		Mungesë kërkesë llogarie	30
		Dështim në ndjekjen e interesit publik	25
Manipulimi dhe politizimi i protestave	8	Instrumentalizim i mundshëm i protestave nga opozita	5
		Spekulime dhe mangësi informimi nga ana e qytetarëve rreth kësaj çështjeje	3
Gjithsej	155	Gjithsej	155

Tabela 2 – Kornizimet e diagnozës

në këtë rast. Kornizimi i tretë, më pak i rëndësishëm, kishte të bënte me manipulimin dhe politizimin e protestave: protestuesit i shikonin disi me merak përpjekjet e opozitës për t'u bashkuar me protestën, ndërsa kryeministri mendonte se protestat ishin fryrë nga spekulime.

Dy kornizimet dominante gjendeshin thujtë në të gjithë artikujt dhe kronikat e lajmeve që u morën në analizë, zakonisht në të njëjtën kohë, duke treguar edhe dy shqetësimet kryesore të protestuesve, **rrezikun ndaj sigurisë dhe shëndetit publik** (81) nga shkatërrimi i armëve kimike dhe perceptimi i **qeverisjes së keqe** (66). Në tabelën e mësipërme janë renditur edhe nënkornizimet e identifikuara brenda secilës kornizim, si dhe shpeshtësia e tyre në shembujt e marrë për analizë.

Protestuesit: në emër të sigurisë

Kornizimi dominant, rreziku ndaj sigurisë dhe shëndetit nga shkatërrimi i armëve kimike në Shqipëri, mbështetet nga tre nënkornizime, që saktësojnë se problemet që mund të lindin nga shkatërrimi i mundshëm i armëve të tilla në vend janë të natyrës teknike. Argumentet e përdorura më shpesh kanë të bëjnë me terrenin e thyer malor dhe rrugët e vështira në Shqipëri, që e bëjnë shumë problematik transportimin e këtyre armëve. Një argument tjetër lidhet me rrezikun e mundshëm të atyre armëve vdekjeprurëse, duke iu referuar shpesh efekteve dhe viktimave të këtyre armëve në Siri. Një element tjetër që mbështeste këtë kornizim ishte kërcënimi ndaj ambientit, që mund të vinte prej këtij procesi, sidomos në një kohë kur përmendej shpesh se natyra shqiptare dhe turizmi ishin çelësi i zhvillimit ekonomik të vendit. Kështu, përveç trajtimit të çështjes së frikës dhe shqetësimeve se procesi i shkatërrimit të armëve mund të jetë i rrezikshëm,

kishte edhe shqetësime që lidheshin me efektet afatgjata që kjo do të kishte mbi ambientin dhe të ardhmen e vendit.

Ndërsa dështimi në garantimin e një procesi të sigurtë të shkatërrimit të armëve kimike në Shqipëri ishte nënkornizimi kryesor, dy nënkornizime të tjera mbështesnin kornizimin kryesor (rreziku ndaj sigurisë). Disa raportime e vinin theksin mbi mungesën e përvojës dhe të ekspertizës nga shteti shqiptar në procese kaq të ndërlikuara, duke përmendur gjithashtu edhe raste të tjera kur mbetje të rrezikshme toksike nuk ishin trajtuar si duhet. Së fundmi, mungesa e një baze ligjore për të mbështetur një procedurë kaq të ndërlikuar, si dhe disa shenja se kishte shkelje ligji në këtë proces, gjithashtu e mbështetën kornizimin kryesor – natyrën e rrezikshme të të gjithë procesit, me pasoja të rënda për një vend kaq të vogël si Shqipëria. Pas gjithë kësaj, elementi më i theksuar i kornizimit kryesor të diagnozës është rreziku ndaj sigurisë që vjen nga shkatërrimi i armëve kimike në Shqipëri.

Kornizimi i dytë kryesor në analizën e diagnozës kishte të bënte me qeverisjen e dobët, dhe bazohej në perceptimin se qeveria nuk po vepronte në mënyrë të përgjegjshme dhe nuk po tregonte përgjegjësi publike ndaj qytetarëve të saj (shiko kapitullin mbi kërkesën e llogarisë, vijon më poshtë.) Një kornizim i tretë, më pak i rëndësishëm, ishte ai i manipulimit të protestave. Problemi në këtë rast ishte i dyanshëm. Nga njëra anë, raportohej mbi shqetësimin e protestuesve se opozita mund të instrumentalizonte protestën e tyre. Kjo kishte një rëndësi të madhe për protestuesit, ashtu si u tha edhe në media gjatë mbulimit të protestave dhe ngjarjeve të mëvonshme, pasi ata i mëshonin tezës se protesta nuk drejtohej kundër partive politike por kundër rrezikut që sillnin armët kimike. Nga ana tjetër, problemi me demonstratat, sipas kryeministrit, ishte se protestuesit nuk kishin marrë

informacionin e mjaftueshëm dhe protestat ishin ndezur nga spekulime. Ky nënkornizim bazohej kryesisht në retorikë populiste, duke iu referuar parimeve të tilla si: mbrojtja e interesave kombëtare, garantimi i qeverisjes së mirë, dhe nevoja që qytetarët të kenë besim te qeveria e tyre, që nuk mund të dalë kurrë kundër interesave të popullit. Gjithashtu, roli i aleatëve të rëndësishëm, mbi të gjitha SHBA, u përdor si argument për të zbutur protestat, por pa ofruar ndonjë informacion rreth procesit. U tha se SHBA punonin vetëm në të mirë të interesave të Shqipërisë, duke patur parasysh edhe rolin e tyre të rëndësishëm në historinë e Shqipërisë.

Prognoza

Kornizimet kryesore të prognozës	N	Nënkornizimet e prognozës	N
Shëndeti publik dhe siguria	79	Refuzimi nga mungesa e sigurisë	48
		Shkelje ligji	8
		Shqipëria do të kthehet në Siri	16
		Shqipëria do të kthehet në kosh plehrash	4
		Ndikime afatgjata	3
Sjellja e qeverisë	61	Rritje e transparencës dhe përgjegjësisë publike	30
		Përmirësim i besimit të publikut ndaj qeverisë	10
		Respektimi i interesave kombëtare	21
Shmangie e instrumentalizimit të protestave	3	Ndalimi i pjesëmarrjes së politikanëve në protesta	3
Gjithsej	143	Gjithsej	143

Tabela 3 – Kornizimet e prognozës

Prognoza gjithashtu përbëhet nga tre kornizime kryesore, dy prej tyre ishin dominante dhe korrespondonin pak a shumë me kornizimet e diagnozës (Tabela 3, më sipër). Për shembull, nëse siguria shihej si problem, atëherë refuzimi i shkatërrimit të armëve shihej si zgjidhja e problemit.

Kornizimi dominant paraqitej si nevoja për të garantuar sigurinë dhe shëndetin publik. Megjithëse u arrit të identifikoheshin disa nënkornizime në lidhje me këtë subjekt, zgjidhja që i lidhte të gjitha ato së bashku ishte që qeveria të dëgjonte zërin e protestuesve dhe të refuzonte oferten për shkatërrimin e armëve kimike në territorin e Shqipërisë. Kornizimi i dytë dominant lidhej me sjelljen dhe reagimin e qeverisë, që ndahej në nënkornizim të përmirësimit të transparencës dhe kërkesës së llogarisë, përmirësimi i besimit të publikut ndaj qeverisë, dhe respektimi i interesave kombëtare. Edhe në këtë rast, zgjidhja ishte e thjeshtë: qeveria duhet të tregojë transparente dhe t'ia shpjegonte çështjen popullit shqiptar, si dhe ta refuzonte ofertën, meqë dilte kundër interesave kombëtare. Kornizimi i tretë lidhej me nevojën për të shmangur instrumentalizimin e protestave, dhe zgjidhja ndaj këtij problemi paraqitej ndalimi i pjesëmarrjes të politikanëve nga protestat, nga frika e manipulimit.

Prognoza dominohet nga nevoja për të refuzuar ofertën për shkatërrimin e armëve kimike në Shqipëri, duke i dhënë përparësi kryesore sigurisë (79 raste.) Zgjidhja identifikohet më shpesh si refuzimi i marrëveshjes për arsye të rrezikut që mund të sillnin ato (48 raste). Nënkornizimi i dytë i prognozës ishte rreziku se Shqipëria do të kthehej në Siri (16 raste) nëse pranohej oferta. Kjo u përmend nga një vajzë siriane që jetonte në Shqipëri dhe mori pjesë në protesta, dhe ngaqë ajo ishte prezente në raportimin e të gjitha mediave, ishte një nga nënkornizimet kryesore të manifestimeve. Nënkornizimet e

tjera gjithashtu mbështetën të njëjtin argument: katastrofë e mundshme ekologjike dhe pasoja afatgjata të këtij procesi. Kështu, kornizimi ishte një kombinim i argumenteve mbi sigurinë dhe frikën – krahasimi me Sirinë dhe dyshimet rreth të ardhmes së Shqipërisë.

Kornizimi i dytë më i përdorur i prognozës lidhej me sjelljen e qeverisë (61 raste), kryesisht në raport me rritjen e transparencës dhe përmirësimin të nivelit të përgjegjësisë publike të qeverisë dhe kërkesës së llogarisë (lexo më poshtë kapitullin mbi kërkesën e llogarisë). Kornizimi i tretë i identifikuar gjatë analizës (tre raste) ishte nevoja për të siguruar integritetin e protestave, që perceptohej si e rrezikuar nga përpjekjet e opozitës për t’iu bashkuar lëvizjes. Ky kornizim ngrihej mbi vlerësimin e ndarjes së qartë midis protestave dhe klasës politike, ngaqë një nga elementët më të vlefshëm të protestave ishte përfaqësimi i masave, në mënyrë të pavarur nga partitë politike.

Po të krahasojmë kornizimet e diagnozës dhe prognozës, ka një përputhje të qartë midis tyre (tabela 4):

Kornizimet kryesore të diagnozës	N	Kornizimet kryesore të prognozës	N
Rrezik ndaj sigurisë	81	Garantimi i sigurisë dhe shëndetit publik (duke hedhur poshtë marrëveshjen)	79
Qeverisje e keqe	66	Përmirësim i sjelljes së qeverisë (transparencë dhe kërkesë llogarie)	61
Manipulimi dhe politizimi i protestave	8	Shmagje e manipulimit (duke i mbajtur larg politikanët dhe duke shmangur spekulimet)	3
Gjithsej	155		143

Tabela 4 – Përputhja diagnozë - prognozë

Përputhja midis diagnozës dhe prognozës tregon një kornizim të njëtrajtshëm të problemit dhe zgjidhjes së ofruar, ashtu si u identifikua edhe nga analiza e përmbajtjes së medias. Kjo njëtrajtshmëri haset në disa organe të ndryshme mediash dhe nuk vihen re nuanca të caktuara apo veçanti në raportim, që mund të ndikohen nga lidhjet apo aleancat politike të medias apo politikës editoriale. Arsyeja kryesore rreth kësaj dukurie është fakti se kornizimet dominante në media janë dhënë nga gazetarët dhe protestuesit, pasi qeveria nuk paraqiti ndonjë narrativë të kundërt; në çastin kur Shqipëria po përballej me një vendim kaq të rëndësishëm, gati nuk u lëshua fare ndonjë informacion zyrtar në lidhje me gjithë këtë çështje. Gjithashtu, një shpjegim tjetër mund të jetë se protestuesit u shprehën qartë, në disa raste, se ata ishin të interesuar vetëm për rezultatin, apo përfundimin, e kësaj çështjeje, dhe se protestat nuk drejtoheshin kundër punës së qeverisë në përgjithësi. Në të njëjtën kohë, edhe opozita qëndroi në përgjithësi e heshtur deri pak para fundit të protestave. Të gjithë këta faktorë çuan në një situatë ku rreziku për instrumentalizim politik nuk ishte shumë e fortë.

Burimi i informacionit që paraqet problemin	N	Burimi i informacionit që paraqet zgjidhjen	N
Protestuesit (shoqëria civile, njerëz të zakonshëm, gazetarë si protestues)	69	Protestuesit (shoqëria civile, njerëz të zakonshëm, gazetarë si protestues)	64
Politikanë (kryeministri, kryetari i kuvendit, opozita, deputetë)	52	Politikanë (kryeministri, kryetari i kuvendit, opozita, deputetë)	52
Ekspertë	9	Ekspertë	6
Gazetarë	40	Gazetarë	22
Gjithsej	170		144

Tabela 5 – Burimet e informacionit që paraqesin problemet dhe zgjidhjet

Kjo koherencë është edhe më e dukshme po të shohim aktorët që identifikohen si prezantues të problemeve dhe zgjidhjeve. Tabela 5 (këtu më lart) tregon një prirje të qartë: shpeshësia e daljes të një lloji burimi informacioni në identifikimin e një problemi përkon pak a shumë me shpeshësinë e daljes së të njëjtit burim informacioni edhe në paraqitjen e zgjidhjeve. Diferencat e vogla vijnë ngaqë në disa tekste nuk identifikohet zgjidhje. Në përgjithësi, protestuesit përbëjnë grupin më të madh të burimeve të informacionit, ndërsa politikanët renditen në vend të dytë. Sidoqoftë, duke patur parasysh se në grupin e politikanëve përfshihet edhe opozita, apo edhe politikanë që mbajnë një qëndrim neutral ndaj protestave (për shembull, kryetari i Kuvendit), protestuesit janë pa dyshim burimi kryesor i informacionit në media gjatë mbulimit të protestave.

Si rezultat i gjithë kësaj, legjitimiteti i kërkesave të protestuesve dhe lufta e tyre u pranuan gjerësisht nga media dhe publiku, dhe si rezultat vetë protestat nuk paraqiteshin si pjesë e problemit. I vetmi përjashtim është deklarata fillestare e kryeministrit, që përmendi mungesën e informimit nga ana e protestuesve si faktorin kryesor për nxitjen e protestave (tre raste). Sidoqoftë, edhe në këtë rast, ai deklaroi se mungesa e informimit po manipulohet nga rivalët politikë, dhe po mundohej t'i paraqiste protestuesit si të politizuar; pikërisht atë që protestuesit po mundoheshin t'i rezistonin me të gjitha forcat. Në të njëjtën kohë, në pak raste, protestuesit u paraqitën si pjesë e zgjidhjes së problemit (në pesë raste). Kjo erdhi kryesisht nga udhëheqës të shoqërisë civile apo edhe nga protestues të zakonshëm, që thanë se zgjidhja vjen me mobilizimin e një numri më të madh protestuesish, që t'i bënin presion qeverisë të plotësonte kërkesat e tyre për refuzimin e marrëveshjes mbi armët kimike. Duke patur parasysh praninë e madhe të protestuesve si burime

informacioni – ata që identifikojnë si problemin ashtu dhe zgjidhjen gjatë raportimit në media – dhe se dy kornizimet dominante lidhen me kërkesat e protestuesve (mbrojtja e sigurisë dhe shëndetit publik, dhe nevoja për transparencë), mund të thuhet me plot gojën se protestat u legjitimuan plotësisht nga mbulimi në media. Natyrisht, kjo duhet parë edhe në raport me heshtjen e zgjatur të autoriteteve ndaj protestës, mungesës së transparencës dhe informacionit zyrtar.

Krahasimi i raportimeve në media

Protestuesit që u intervistuan në lidhje me mbulimin e protestave, në përgjithësi ishin të mendimit se raportimi shkonte nga ngjyrimet e forta politike, në rastin më të keq, deri te raportimi politikisht korrekt, por sipërfaqësor, i aktiviteteve të protestës.⁹² Këto opinione përkonin edhe me mendimet e gazetarëve dhe zyrtarëve të intervistuar. “Në Shqipëri rrallë gjen raportim të paanshëm të protestave, ngaqë mediat janë shumë të politizuara.”⁹³ Intervistat me gazetarë gjithashtu tregojnë se interesi politik është një faktor që përcakton mbulimin e protestave në media⁹⁴. Në përgjithësi, protestuesit kishin opinione dhe përvoja më të mira me mediat në internet sesa me mediat tradicionale, duke i konsideruar këto të fundit si të lidhura shumë ngushtë dhe vasale ndaj pushtetit politik dhe ekonomik⁹⁵. Sidoqoftë, analiza e kornizimit në përmbajtjen e medias nuk tregoi ndonjë ndryshim shumë të madh midis raportimit në media të ndryshme gjatë protestave të nëntorit 2013 (tabela 6).

⁹² Intervistë me protestues.

⁹³ Intervistë me Arlind Koten, lëvizja Forca Rinia.

⁹⁴ Intervistë me gazetarë.

⁹⁵ Po aty.

Media	Siguria dhe shëndeti publik (n)	Kërkesa e llogarisë	Transparenca	Politizimi i protestave	Qeverisja e mirë	Interesi publik dhe kombëtar	E drejta për të protestuar	Legjitimiteti i procesit
Lajmifundit.al	3	9	2		5	4	2	
Albeu.com	9	1	3	1	3	1	2	
Balkanweb.com	7	3	5		5	3	1	4
TV Klan	9	7	4	1	2	1	3	4
Vizion + TV	7	6	2	1	5	3	1	
Top Channel TV	5	4	2		3	3	2	1
Ora News TV	7	5	3		5	1		
TVSH	7	2	3		4	1	1	3
Gjithsej	54	37	24	3	32	17	12	12

Tabela 6 – Identifikimi i kornizimeve në organet e medias

Parasëgjithash, tekstet e monitoruara në tre mediat online ishin pak a shumë identike, dhe kjo është diçka e zakonshme në portalet shqiptare të lajmeve, ku mund të gesh të njëjtin tekst në disa portale të ndryshme, rivale me njëra-tjetrin. Vetë mediat ngrenë vazhdimisht akuza të ndërsjella rreth kopjimit dhe vjedhjes së materialeve, por kjo është një praktikë që ende vazhdon. Si rezultat, ndryshimi më i madh në mbulimin e protestave në mediat në internet duket se ka të bëjë me referencat mbi përgjegjësinë publike dhe kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë, ku një nga portalet i mëshon më fort kësaj çështjeje se dy të tjerat. Sidoqoftë, kjo diferencë në mbulim ka të ngjarë që të ketë të bëjë më shumë me përzgjedhjen e teksteve për analizë, sesa me dominancën e një kornizimi mbi të tjerët në një media të caktuar. Në fakt,

një mangësi në tekstet e analizuara ishte fakti se në kohën e studimit kishin kaluar dy vjet që nga këto protesta, dhe si rezultat nuk mund të gjendej i gjithë materiali mbi protestat nga mediat online dhe stacionet televizive.

Po kështu, mbulimi i aktiviteteve të protestës nuk paraqiti ndonjë surprizë apo diferenca të thella midis pesë stacioneve televizive që u monitoruan në këtë studim. Ndërkohë që praktikat e punës *copy/paste* janë shumë të përhapura në portalet e lajmeve në internet, njëtrajtshmëria e çështjeve të mbuluara, e burimeve të informacionit, dhe të këndeve të trajtimit të lajmit, ndikojnë gjithashtu edhe te mediat tradicionale, me përjashtim të aktiviteteve me rëndësi të veçantë politike apo ekonomike. Sidoqoftë, e veçanta në këtë rast ishte mungesa e plotë e ndërhyjes dhe reagimit të qeverisë dhe politikanëve, në veçanti gjatë javës së parë të protestës. Në të njëjtën kohë, mungonte edhe zëri i opozitës, mbase nga ndrojtja për të mbajtur anën e protestuesve, dhe nga frika se mos zemëronin një aleat të fuqishëm, si SHBA.⁹⁶ Kështu, në njëfarë mënyre, heshtja e qeverisë dhe e figurave politike, qoftë nga krahu qeverisës ashtu edhe nga opozita, si dhe rritja e vazhdueshme e numrit të manifestuesve, e drejtoi vëmendjen e medias ndaj protestuesve si i vetmi zë në të gjithë këtë çështje.

I vetmi devijim nga kjo prirje ishte mbulimi nga televizioni publik, RTSH, që ishte më i shkurtër dhe më shumë sipërfaqësor se ai i televizioneve private. Për shembull, në kulmin e tyre protestat po zhvilloheshin më pak se 100 metra nga ndërtesa e RTSH, dhe të gjitha stacionet e tjera i transmetonin direkt aktivitetet e protestës, ndërsa

⁹⁶ Udhëheqësit e opozitës u munduan të bashkoheshin me protestat gjatë dy ditëve të fundit, por deri në atë moment opozita kishte ndenjur në heshtje rreth kësaj çështjeje.

RTSH vazhdonte trasmetimin e programit të tij të rregullt, dhe i përmendte protestat shkurtimisht gjatë edicioneve kryesore të lajmeve. Një tjetër pikë ndryshimi kishte të bënte me angazhimin më aktiv për të pasqyruar zërin e protestuesve nga mediat më pranë opozitës në atë kohë. Për shembull, TV Klan, që në atë kohë ishte më pranë partisë opozitare, transmetonte më shumë intervista të personave publikë që protestonin kundër qeverisë dhe bënë presion që të refuzohej marrëveshja e armëve kimike. Sidoqoftë, këto janë vetëm nuanca dhe diferenca të zbehta, pasi në përgjithësi protestat u mbuluan pak a shumë në mënyrë të plotë nga të gjitha stacionet televizive, duke raportuar mbi aktivitetet e protestës, duke intervistuar protestues, duke transmetuar thirrjet dhe deklaratat e tyre publike, përhapjen e protestave, etj.

Gjithashtu, mbulimi në media në këtë rast ishte gati i njëtrajtshëm nga të gjitha organet e medias, pavarësisht nga lidhjet e tyre me qeverinë apo opozitën, apo nga politikat e tyre editoriale. Madje të njëjtat burime dhe ekspertë u cituan në shumicën e kohës nga të gjitha mediat, me të njëjtët grupe njerëzish që qarkulloheshin nga një studio televizive në një tjetër. Po kështu, mediat online nuk paraqitën ndonjë ndryshim nga mediat tradicionale në këtë rast, dhe nuk kishte ndonjë diferencë të dukshme, pasi informacioni që jepej ishte pak a shumë i njëjtë. Paraqitja shabllon e lajmeve dhe aktivitetëve nga një media në tjetrën duket të jetë një nga karakteristikat kryesore të mbulimit nga media në këtë rast, ku shumë media dhe platforma lajmesh mundoheshin të kopjonin apo imitonin njëra-tjetrën.⁹⁷

⁹⁷ IREX, Qëndrueshmëria në media 2015.

5.2 Përgjegjësia publike: kornizimi në media dhe perceptimi

Të dhënat e studimit tregojnë se, në përgjithësi, mediat u munduan të raportonin mbi aktivitetet dhe opinionet e ndryshme gjatë protestave, por dështuan në nisjen e një diskutimi të gjerë publik mbi kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë dhe nuk u thelluan fare në këtë çështje. Në përgjithësi, mbulimi mediatic i protestave e preku disi çështjen e përgjegjësisë publike dhe kërkesës së llogarisë, apo në rastin e protestës kundër armëve kimike, mungesës së transparencës dhe përgjegjësisë publike të qeverisë. (Tabela 7).

Kornizimi kryesor i diagnozës	N	Nënkornizimet e diagnozës	N	Kornizimi kryesor i prognozës	N	Nënkornizimet e prognozës	N
Qeverisja e keqe	66	Mungesa e transparencës	11	Sjellja dhe reagimi i qeverisë	61	Më shumë transparencë e përgjegjësi publike	30
		Mungesa e përgjegjësisë publike	30			Forcimi i besimit ndaj qeverisë	10
		Dështim në mbrojtjen e interesit publik	25			Mbrojtja e interesave kombëtare	21
Shuma e kornizimeve kryesore të diagnozës	155			Shuma e kornizimeve kryesore të prognozës	143		

Tabela 7 – Kornizimet kryesore diagnozë-prognozë në lidhje me përgjegjësinë publike

Analiza diagnozë-prognozë flet për një kornizim koherent të protestave në lidhje me kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë. Tabela 6 tregon se si raportimi mbi protestat përmend edhe problemin e qeverisjes së keqe, në formën e mungesës së transparencës, mungesës së përgjegjësisë publike dhe dhënies llogari, apo dështimin në mbrojtjen e interesit publik. Ndryshimi i sjelljes dhe mënyrës së veprimit nga ana e qeverisë paraqitet si zgjidhja e këtyre problemeve (shiko tabelën për më shumë detaje).

Analiza e përmbajtjes në media tregon se përgjegjësia publike dhe kërkesa e llogarisë del kryesisht nga pasqyrimi i kërkesave të protestuesve apo shoqërisë civile për më shumë transparencë dhe informacion mbi negociatat rreth propozimit për shkatërrimin e armëve kimike në Shqipëri. Pati gjithashtu edhe një numër të madh daljesh të protestuesve në trasmetime televizive direkte, si dhe intervista në studio me përfaqësues të protestës që shprehnin shqetësimet e tyre.⁹⁸

Në pjesën e diagnozës, gjatë analizës së kornizimit, krijuam një listë të problemeve të mundshme të identifikuara në përmbajtjen e medias, si dhe aktorët e përmendur si përgjegjës për shkaktimin e këtyre problemeve, ashtu si tregohet edhe nga tabela më poshtë:

⁹⁸ Për të thënë të vërtetën, rezultati i protestave dhe fati i propozimit ishte objekti kryesor i emisioneve në studio përgjatë gjithë javës para daljes së deklaratës publike të kryeministrit se kishte refuzuar propozimin për shkatërrimin e armëve kimike në Shqipëri. Sidoqoftë, meqë kjo analizë përfshin përmbajtjen mediatike të edicioneve kryesore të lajmeve, nuk mund të thuhet se subjekti i përgjegjësisë në qeverisje u ndoq në mënyrë aktive nga media me nismën e saj, ndonëse protestuesve iu krijuan të gjitha mundësitë për të shprehur shqetësimet e tyre.

Problemi	N	Përgjegjës për problemin	N
Rreziku ndaj sigurisë dhe shëndetit publik	81	Ana teknike e shkatërrimit të armëve	20
		Qeveria, që mori në konsideratë kërkesën nga SHBA	52
		Kërkesa e SHBA ndaj Shqipërisë	14
		Policia, që vinte në pikëpyetje legjitimitetin e protestave	2
		Lajmet në mediat e huaja mbi kërkesën e SHBA ndaj Shqipërisë	2
Mungesa e transparencës dhe kërkesës së përgjegjësisë	66	Qeveria, që nuk mori mendimin e qytetarëve për procesin	2
		Qeveria, për mungesën e transparencës	20
		Sekreti në bisedimet me partnerët	6
		Kryeministri, për vendimin, dhe heshtjen e zgjatur	6
Politizimi i protestave	8	Opozita për instrumentalizim të protestave	6
		Protestuesit, kundër SHBA për kërkesën e bërë	2
		Protestuesit, për mungesë informimi	6

Tabela 8 – Përgjegjësitë në shkaktimin e problemeve

Përcaktimi dhe identiteti i shkaktarit të problemit ndryshonte në varësi të atyre që flisnin në media. Për shembull, opozita u identifikua si shkaktare problemit në gjashtë raste, pasi disa nga anëtarët e saj vendosën të bashkoheshin me protestat gjatë ditëve të fundit të saj. Kjo u pa si problem, si nga qeveria, e cila e konsideroi këtë si një marifet për të përshkallëzuar dhe manipuluar protestat pa patur informacionin e mjaftueshëm për të marrë një

vendim të tillë, ashtu edhe nga protestuesit. Në fakt, kur ish-kryeministri, dhe kryetari i opozitës, u bashkuan me protestën në ditën e fundit, protestuesit i detyruan ata që të largohen nga frika e politizimit të protestave, duke thirrur “Këtu nuk ka politikë!” Ashtu si rikujtoi edhe një nga protestuesit: “Duhet të bëhej e qartë se protesta ngrihej mbi politikën, dhe nuk ishte e lidhur me asnjë nga partitë politike.”⁹⁹

Po kështu, kryeministri dhe zyrtarë të tjerë të qeverisë – në ato pak raste kur folën mbi protestat – i akuzuan qytetarët, protestuesit, dhe ambientalistët, se bazoheshin në spekulime për nxitjen e protestave. Kështu, në gjashtë nga rastet e monitoruara ata u paraqitën si shkaktarët e problemit, ngaqë po nxisnin njerëzit të dilnin në protesta, ndërkohë që nuk kishin informacionet dhe njohuritë e mjaftueshme për të gjykuar mbi shkallën e rrezikshmërisë të shkatërrimit të armëve kimike.

Këto protesta shënuan për herë të parë një shfaqje publike të opozitës dhe kundërshtimit ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës – një risi për Shqipërinë, që është një nga vendet më proamerikane në rajon. Sidoqoftë, meqë propozimi për shkatërrimin e armëve kimike në Shqipëri erdhi prej tyre, SHBA dhe shtete të tjera partnere, u konsideruan si problem nga disa protestues, dhe kjo u pasqyrua edhe në media. Kështu, në 14 nga 138 rastet e identifikimit të shkaktarëve të problemit, kërkesa për shkatërrimin e armëve kimike, dhe për rrjedhojë edhe Shtetet e Bashkuara, u quajtën fajtorë: ata i bënë një kërkesë të padrejtë Shqipërisë, dhe e vunë vendin në një pozitë të vështirë. Për pasojë, për herë të parë pati protesta përballë ambasadës amerikane, e cila gjithashtu krijoi debate më vete, ku ekspertë dhe analistë i përshkruan

⁹⁹ Intervistë me Blendi Salaj, Club FM gazetar, protestues.

veprimet e protestuesve si të pamatura dhe që rrezikonin të acaropin marrëdhëniet me një aleat të rëndësishëm.

Sidoqoftë, tabela 7 tregon qartë se qeveria cilësohej si fajtorë kryesorë nga raportimet në media. Qeveria, sipas analizës së përmbajtjes në media, ishte përgjegjëse për vënien në rrezik të sigurisë dhe shëndetit publik ngaqë e mori në konsideratë këtë kërkesë (52 raste), për mungesë transparence (20 raste), si dhe mungesë të përgjegjësisë publike (dy raste). Në përmbajtjen në media qeveria (d.m.th. Këshilli i Ministrave) dhe kryeministri ndërrojnë vendet herë pas here në rolin e fajtorit dhe përgjegjësit për shkaktimin e problemit. Gjithashtu, kryeministri u identifikua gjashtë herë si personi përgjegjës për vënien në rrezik të sigurisë dhe shëndetit publik, por edhe për mungesë informimi të popullit të tij. Nga ana tjetër, anëtarët e qeverisë, në rastet e rralla kur lëshuan deklaratave publike, e përligjin heshtjen e tyre dhe mungesën e transparencës me konfidencialitetin e negociatave me shtetet partnere (gjashtë raste).

Nuk është ndonjë çudi e madhe që qeveria shihej në të njëjtën kohë si shkaktoresh e problemit, por edhe si institucioni që duhet të dilte me një zgjidhje. Kjo vjen ngaqë pjesa dërrmuese e ankesave dhe pakënaqësive nga protestat adresoheshin drejt qeverisë, por nga ana tjetër, teknikisht, është detyra dhe kompetenca e qeverisë që të marrë një vendim. Një shpjegim tjetër është se pjesa më e madhe e mbulimit në media kishte të bënte me përshkrimin e aktiviteteve të protestës, kërkesave dhe deklaratave të protestuesve, vëmendja dhe pritshmëritë e të cilëve binin krejtësisht mbi qeverinë. Për këtë arsye, qeveria u referua si zgjidhja e problemit të protestave në 86 raste nga 122 zgjidhje të prezantuara gjatë raportimit. Një pjesë e zgjidhjes ishin edhe vetë protestuesit (21 raste), që nganjëherë identifikoheshin si *protestues*, dhe herë të tjera si *popull* apo *qytetarë*. Kjo përmendej

Përgjegjës për zgjidhjen e problemit	Numri i rasteve	Zgjidhja	Numri i rasteve
Qeveria / kryeministri	54	Refuzimi i marrëveshjes	54
Qeveria / kryeministri	15	Përgjegjësi dhe transparencë	2
Qeveria / kryeministri	13	Veprim në të mirë të interesave kombëtare	13
Qeveria / kryeministri	4	Pranimi i marrëveshjes	4
Qeveria / kryeministri	4	Qëndrimi larg politizimit	4
Protestues	21	Rezistim derisa qeveria t'i dëgjojë	21
Publiku, qytetarët, protestues	15	Besim ndaj qeverisë dhe pritje deri në marrje vendimi	15
Gjithsej	126		113

Tabela 9 – Përgjegjësia për zgjidhjen e problemit

zakonisht në raportime ku protestues të thjeshtë apo përfaqësues të protestës bënin thirrje që më shumë qytetarë të bashkoheshin me demonstratat. Sidoqoftë, protestuesit dhe qytetarët përmendeshin si zgjidhje të problemit, në formën e shpërndarjes së protestave të keqinformuara dhe të paarsyeshme, nga deklaratat e zyrtarëve shtetërorë (15 raste). Këto deklarata, sidomos ndërhyrjet publike të kryeministrit, nënkuptonin se protestuesit duhet të kishin besim tek qeveria, pasi ajo vepronte vetëm në të mirë të vendit. Kështu, kryeministri dhe zyrtarë të tjerë të qeverisë deklaruan se e vetmja rrugëdalje ishte që populli t'i besonte

qeverisë, dhe të bënte durim deri sa ajo të ishte në gjendje të informonte vendin, duke lënë të nënkuptohej se për momentin ishin të detyruar nga shtetet e tjera partnere të ruanin sekretin. Ky pretendim, duke i shtuar edhe disa doza zhgënjimi për mungesën e besimit të publikut, u përsërit disa herë nga kryeministri gjatë deklaratës 30-minutëshe që dha më 15 nëntor, nga ku lajmëroi refuzimin e kërkesës për shkatërrimin e armëve kimike në Shqipëri. Në këtë mënyrë u shmang edhe çështja e transparencës dhe dhënies llogari, ndërsa kryeministri e kaloi diskutimin në një nivel emocional: duke sjellë në qendër të vëmendjes besimin që publiku duhet të ketë ndaj qeverisë së vet. Por në fakt, edhe tani, dy vjet më pas, ende nuk ka transparencë dhe informacion mbi atë çka ndodhi, dhe çfarë oferte i ishte bërë qeverisë, dhe kjo hedh hije dyshimi mbi përgjegjësinë publike të qeverisë dhe metodat e saj të komunikimit me qytetarët.

Përgjegjësia publike sipas opinionit të të intervistuarve

Çështja e dhënies llogari ndaj publikut ishte një nga shqetësimet kryesore për të gjithë të intervistuarit, dhe protestat shpesh përlijen me nevojën për përgjegjësi më të madhe në qeverisje. Disa prej tyre thanë se do të kishte më pak protesta, nëse qeveria do të ishte më e hapur ndaj dhënies llogari kundrejt qytetarëve.¹⁰⁰ “Kur mungon kërkesa e llogarisë ndaj shtetit, protestat janë të nevojshme për të detyruar zyrtarët e qeverisë që të tregohen më transparentë në detyrë dhe të zgjidhin kërkesat dhe shqetësimet e qytetarëve.”¹⁰¹ Këtij opinioni i bëhet jehonë edhe nga një tjetër i intervistuar: “Mungesa e përgjegjësisë publike nga

¹⁰⁰ Intervistë me protestues, zyrtarë, dhe gazetarë.

¹⁰¹ Intervistë me Rakip Belishakun, student.

ata që supozohet se duhet të tregojnë përgjegjësi publike çon në protesta: kërkesa e llogarisë dhe protestat janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën.”¹⁰²

Sidoqoftë, shumica e të intervistuarve mendonin se protestat vështirë t'i arrijnë rezultatet e dëshiruara. Ashtu si pritej, ka ndryshim midis opinioneve dhe qëndrimeve të të intervistuarve në varësi të pozicionit dhe rolit të tyre. Zyrtarët partiakë dhe qeveritarë mendonin se ka një lidhje direkte midis kërkesës së llogarisë dhe protestave, por preferojnë që të flasin në parim, dhe nuk i referohen situatës aktuale në vend.¹⁰³ Disa nga protestuesit, kryesisht pjesëtarë të lëvizjes ambientaliste, që kanë një përvojë relativisht të gjatë në këtë fushë, mendonin se përgjegjësia publike është ende e dobët, por situata po përmirësohet. Sidoqoftë, shumë nga të intervistuarit ishin më pak optimistë në këtë drejtim. “Ka një lloj lidhje qesharake midis protestave dhe përgjegjesisë publike. Shpesh zëdhënësit reagojnë ndaj protestave me arrogancë dhe dhunë verbale, duke lëshuar deklarata agresive, pavarësisht nëse kanë të bëjnë me protesta qytetare apo politike.”¹⁰⁴

Të intervistuarit, kryesisht protestuesit, japin shpjegime të ndryshme mbi dështimin e protestave për të vënë zyrtarët para përgjegjesisë apo që ta detyrojnë qeverinë të përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme dhe të pranueshme. Një nga protestuesit, një udhëheqës i lëvizjes studentore kundër reformave në arsim, e lidh mungesën e reagimit nga qeveria me dështimin e protestave për të arritur mobilizim masiv të popullatës apo edhe të atyre grupeve të prekura nga një problem i caktuar. “Në parim, protesta është një nga format kryesore të nxitjes dhe përmirësimit të kërkesës së

¹⁰² Intervistë me Klevis Saliaj, ATN TV.

¹⁰³ Intervistë me zyrtarë partiakë dhe qeveritarë.

¹⁰⁴ Intervistë me Erion Kriston, aktivist.

llogarisë ndaj institucioneve publike. Sidoqoftë, dështimi në organizimin e protestave të pavarura masive në Shqipëri, dhe praktika e injorimit të tyre, e ka dobësuar në parim lidhjen midis protestave dhe përgjegjësisë publike.”¹⁰⁵ Një protestues tjetër e vlerëson këtë dështim në uzurpimin e protestave si institucion nga klasa politike: “Ka një lidhje midis protestave dhe përgjegjësisë publike, por është akoma e brishtë. Institucioni i protestës është disi në krizë pasi protagoniste janë partitë politike që e kanë rrëmbyer këtë instrument qytetar. Për pasojë, do të kalojë një kohë e gjatë përpara se qytetarët të bashkohen rreth një kauze të besueshme, me liderë të besueshëm, si dhe të gjejnë hapësirat e mjaftueshme për të komunikuar.”¹⁰⁶

Komunikimi i zyrtarëve gjatë protestave

Mungesa e kulturës së komunikimit dhe përgjegjësisë publike nga ana e zyrtarëve dhe qytetarëve mbahen si disa nga arsyet kryesore për numrin e vogël të protestave nga qytetarët dhe shoqëria civile, si dhe natyrën e tyre të vakët. “Ka një prirje për t’i injoruar protestuesit. Zyrtarët e dinë se, në fund të fundit, protestat do të zgjasin vetëm gjysmë ore, dhe nuk bëjnë asnjë lëvizje. Vetëm në pak raste, veçanërisht kur përmenden emra dhe bëhen akuza, ata detyrohen të reagojnë, por përsëri vetëm në mënyrë të kufizuar. Prirja kryesore është të mbajnë larg publikun, dhe të kontrollojnë rrjedhën e informacionit. Edhe kodi i etikës¹⁰⁷ i qeverisë është problematik. Ndërkohë që ky

¹⁰⁵ Intervistë me Arlind Qorin, pedagog, protestues.

¹⁰⁶ Intervistë me Ervin Gocin, pedagog, protestues.

¹⁰⁷ Kodi i etikës së qeverisë përcakton, ndër të tjera, se ministrat apo zyrtarë të tjerë duhet të koordinojnë deklaratat e tyre publike me zyrën e kryeministrit, në mënyrë që qëndrimi i qeverisë të jetë i unifikuar, dhe të mos ketë keqkuptime.

kod është i vlefshëm për ministrat, ai gjithashtu orienton të gjithë punonjësit e administratës si të veprojnë, dhe të marrin leje përpara se t'i përgjigjen pyetjeve, dhe kjo përbën një hap të madh prapa.”¹⁰⁸ Prirja e përgjithshme për të shmangur përgjigjen ndaj protestave konfirmohet gjithashtu nga disa të intervistuar, duke përfshirë edhe protestues: “Zyrtarët shtetërorë zakonisht nuk janë shumë aktivë kur vjen fjala te protestat; lëvizin ngadalë, me zor të dëgjojnë, apo thjesht bëjnë sikur duan të të kuptojnë apo të marrin seriozisht, por edhe kjo ndodh vetëm nëse protestuesit janë aq këmbëngulës sa t'i bezdisin. Edhe kur dalin me ndonjë deklaratë publike nuk reflektojnë aq sa duhet, dhe reagojnë dobët ndaj protestave. Deklaratat e tyre janë thjesht retorikë dhe nuk përmendin fare zgjidhjet apo alternativat që ofrohen nga protestuesit.”¹⁰⁹ Në fakt, një nga të intervistuarit vë në pikëpyetje edhe vlefshmërinë e deklaratave publike apo të ashtuquajturave konferenca shtypi: “Nuk mund t'i quash më konferenca shtypi ato sajesa. Është thjesht një zëdhënës apo disa zyrtarë shtetërorë që lexojnë një deklaratë dhe nuk pranojnë fare pyetje apo komente nga salla. Ky nuk mund të quhet komunikim.”¹¹⁰

Metodat e komunikimit të qeverisë dhe zyrtarëve kanë ndryshuar në varësi të situatës, duke kaluar nga heshtja e plotë deri në përfshirje personale nga kryeministri. Sidoqoftë, prirja e përgjithshme ka qenë injorimi i protestuesve apo thjesht mohimi i pretendimeve të tyre si të papërligjura dhe të shkaktuara nga keqinformimi.

Më konkretisht, në rastin e protestave më të mëdha (kundër shkatërrimit të armëve kimike në Shqipëri), kishte

¹⁰⁸ Intervistë me Gjergj Erebarën, BIRN gazetar.

¹⁰⁹ Intervistë me Sazan Gurin, ambientalist.

¹¹⁰ Intervistë me Gjergj Erebarën, BIRN gazetar.

një mungesë të plotë informacioni dhe deklaratash publike nga ana e qeverisë, deri në çastin që protestat u bënë tepër të rëndësishme dhe të pamundura që të injoroheshin - nga numri i pjesëmarësve, përhapja në qytete të tjera, si dhe këmbëngulja e protestuesve për rreth dy javë, që ishte diçka shumë e rrallë deri atëherë. Madje edhe në atë pikë nuk pati komunikim të drejtpërdrejtë nga zyrtarë të shtetit. Për shembull, mediat nuk kishin informacion direkt, por u detyruan të citonin pjesë nga një intervistë në gazetën Le Monde me Ministrin e Punëve të Jashtme ku përmendej mundësia e shkatërrimit të armëve kimike në Shqipëri, si dhe fragmente nga një takim që ai pati me një komision parlamentar lidhur me këtë çështje. Deklarata e parë publike nga ana e tij doli më 5 nëntor, disa ditë pas fillimit të protestave. Si pasojë e presionit të protestave, kryeministri më në fund pranoi më 12 nëntor se Shqipërisë i ishte bërë një ofertë për shkatërrimin e armëve kimike, por ky projekt ishte ende duke u diskutuar; ai gjithashtu theksoi se do të merrej vendimi më i mirë në interes të publikut. Ai përdori faqen e tij në Facebook për publikimin e këtyre deklaratave dhe për të njoftuar se vendimi përfundimtar do të merrej më 15 nëntor, duke shmangur kështu komunikimin direkt me protestuesit dhe mediat.

Një nga kontaktet e pakta direkte midis protestuesve dhe zyrtarëve të shtetit, ishte takimi me kryetarin e parlamentit Ilir Meta, që u orvat të qetësonte ujërat duke u munduar t'i bindte ata se do të merrej një vendim në interes të publikut. Më në fund, vendimi mbi armët kimike u shpall nga kryeministri nëpërmjet një konference shtypi të transmetuar drejtpërdrejtë në televizion, por nuk u lejua asnjë pyetje nga gazetarët. Në përgjithësi, mbizotëroi një heshtje e plotë mbi ofertën e bërë, kushtet e saj, apo mënyrën si u arrit vendimi. Megjithëse në atë kohë u deklarua se marrëveshja

dhe bisedimet po zhvilloheshin në fshehtësi të plotë, që diktohej nga pjesëmarrja në NATO dhe kushtet e vendosura nga shtetet partnere, kjo çështje vazhdon të mbetet mister edhe sot e kësaj dite. “Qeveria gati nuk komunikoi fare gjatë protestave, duke u sjellë si shurdhmemece si kurrë më parë. Edhe ministra, kryebashkiakë, apo gazetarë të afërt me qeverinë nuk kishin asnjë informacion se çfarë po ndodhte. Kjo shurdhëri dhe memecllëk, dhe injorimi i plotë i shqetësimit të publikut për ditë me radhë çoi në protestat masive, dhe shkoi deri në atë pikë sa sistemi i komunikimit të qeverisë doli jashtë kontrollit të saj.”¹¹¹

Rasti i protestave të studentëve paraqiti gati të njëjtat situata dhe praktika komunikimi. Ministri i arsimit, dhe kryeministri bënë shumë pak komente mbi kërkesat e protestuesve, dhe preferonin më shumë të flisnin në përgjithësi rreth reformës në emisione televizive apo intervista. I vetmi përjashtim ishte një episod i veçuar, kur nga këmbëngulja e një grupi studentësh përpara ndërtesës së këshillit të ministrave, kryeministri doli për t’u takuar me ta. Sidoqoftë, edhe në këtë rast, komunikimi direkt u përdor për t’u thënë studentëve se e kishin gabim që dilnin në protesta, pasi nuk ishin të mirinformuar dhe po përhapnin gënjeshtër dhe informata të rreme, ndërkohë që kryeministri kërkoi t’i qetësonte duke i siguruar se çdo gjë do të zgjidhej më së miri. Po kështu, edhe protestat kundër ndërtimit të pallateve pranë liqenit (rasti i tretë në studim) nuk provokoi ndonjë reagim të autoriteteve publike. E njëjta retorikë dhe praktikë komunikimi u përsërit në të tre rastet.

¹¹¹ Intervistë me Blendi Salaj, Club FM gazetar, protestues.

Shumë pak shanse për ndryshim mbi përgjegjësinë publike

Në përgjithësi, të intervistuarit ishin skeptikë rreth ndonjë ndryshimi të mundshëm mbi përgjegjësinë publike, gjatë dhe pas protestave. Protestuesit e lëvizjes studentore janë më të pakënaqurit në lidhje me përgjegjësinë publike dhe sjelljen nga ana e qeverisë, pasi nuk kanë vënë re asnjë ndryshim apo reagim prej tyre. Por sidoqoftë, edhe në rastet e tjera reagimi cilësohet si minimal dhe jo i mjaftueshëm për t'iu përgjigjur kërkesave të protestuesve. Për shembull, një nga ambientalistët që protestonin kundër ndërtimit të pallateve pranë liqenit tha se pati njëfarë reagimi, që erdhi në formën e masave procedurale në mbikëqyrjen e disa institucioneve¹¹², por në këtë rast kërkesat e protestuesve ishin të natyrës sociale, dhe nuk kishin të bënin fare me procedurat, dhe qeveria nuk i plotësoi ato kërkesa.¹¹³

Disa nga të intervistuarit folën rreth protestave të shkatërrimit të armëve kimike si një rast suksesi, pasi vendimi i qeverisë i përmbushi kërkesat e protestës për refuzimin e shkatërrimit të armëve kimike në Shqipëri. Por nga ana tjetër, asnjë nga të intervistuarit nuk ka vënë re ndonjë ndikim afatgjatë apo ndryshime në qëndrimin rreth përgjegjësisë sociale dhe kërkesës së llogarisë. “Në planin afatgjatë protesta nuk dha ndonjë kontribut të madh rreth ndryshimit të konceptit të përgjegjësisë sociale. Mbase pushtetarët sapo e kanë kuptuar se nuk mund ta injorojnë

¹¹² Pati kryesisht ndryshime procedurale rreth rolit të AKPT (Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit) në zbulimin e shkeljeve nga INUK (Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar).

¹¹³ Intervistë me Ervin Gocin, protestues.

përgjithmonë publikun.”¹¹⁴ Të intervistuar të tjerë shprehën të njëjtin opinion, duke ia atribuar suksesin e protestës kundër armëve kimike presionit qytetar, duke vënë re se ky ishte rasti i parë i dorëzimit të qeverisë përballë protestave qytetare në Shqipëri.¹¹⁵

Një pjesë e të intervistuarve shkoi edhe më tej dhe e vuri gishtin mbi lidhjen e ngushtë midis mungesës së përgjegjësisë publike dhe mungesës së reagimit të institucioneve ndaj protestave; ata i shohin vetë protestat si instrument force për të provokuar qeverinë të jetë më vigjilente ndaj nevojave të popullit. “Ideja e turmës së egër po bëhet një nga kërcënimet më të efektshme ndaj qeverisë. Për shembull, kjo doli me sukses në rastin e armëve kimike, doli me sukses në rastin e ish-gubernatorit të Bankës së Shqipërisë, por nuk po ka sukses në rastin e protestës së studentëve. Sidoqoftë, e gjithë kjo tregon se Shqipëria po kthehet në një vend ku institucionet reagojnë vetëm për shkak të forcës të masave popullore dhe protestuesve.”¹¹⁶

Megjithatë, të intervistuarit ishin shumë pesimistë rreth çdo ndryshimi të mundshëm në lidhje me përgjegjësinë publike, si përsa i përket transparencës, metodave të komunikimit, apo edhe sjelljes të faktorëve të tjerë si publiku, media, dhe zyrtarët e shtetit.

¹¹⁴ Intervistë me Blendi Salaj, Club FM gazetar, protestues.

¹¹⁵ Intervistë me Klevis Saliaj, ATN TV.

¹¹⁶ Intervistë me Gjergj Erebarën, BIRN gazetar.

5.6 Roli i medias dhe metodave të komunikimit nga gazetarët

Media luan një rol të rëndësishëm në dhënien e informacionit mbi protestat. Mënyra e mbulimit të protestave ndikohet nga shumë faktorë, që rezultojnë zakonisht në raportim korrekt, të balancuar, por sipërfaqësor. Kapitulli i mëposhtëm merret me karakteristikat kryesore të rolit të medias në raportimin e protestave, në bazë të rezultateve dhe të dhënave të nxjerra nga intervistat dhe analiza e përmbajtjes në media.

Rëndësia e medias për protestat

Rezultatet e konfirmojnë rëndësinë që kanë mediat kryesore në mbarëvajtjen e protestave. Opinioni i përgjithshëm nga të gjitha intervistat është se ka shumë pak gjasa që protestat të kenë ndonjë farë suksesi pa patur mbulimin e medias; kjo u tha nga gazetarë, protestues, dhe zyrtarë shtetërorë. “Roli i medias ka rëndësi jetike, të domosdoshme, dhe të pashmangshme. Protestat zhvillohen që të dëgjohet zëri i masës dhe të fitohet mbështetja e qytetarëve dhe faktorëve politikë. Mbulimi në media është e vetmja mundësi për të përforcuar zërin e protestës. Një protestë që nuk siguron dot mbulim në media është e pavlerë,” tha një nga protestuesit e marrë në intervistë.¹¹⁷ Një protestues tjetër, që punon si gazetar, tha se është gati e pamundur që protestat të kenë sukses nëse nuk komunikojnë dot me mediat, qoftë me mediat kryesore apo edhe ato në internet.¹¹⁸

¹¹⁷ Intervistë me Rakip Belishakun, student.

¹¹⁸ Intervistë me Blendi Salaj, Club FM gazetar, protestues.

Po kështu, të gjithë të intervistuarit nënvizuan rolin thelbësor të mbulimit në media për ndërgjegjësimin e popullatës rreth protestave, si parakusht për suksesin e lëvizjeve sociale. Meqë mediat kryesore, kryesisht televizioni, ende mbeten burimi kryesor i informacionit për publikun e gjerë, dhe ende gëzojnë shtrirjen më të madhe mbi popullatën, fuqia dhe pushteti i tyre vazhdon të jetë i konsiderueshëm. Gjithashtu, protestuesit bien dakord se, teorikisht, mediat ofrojnë një mundësi mjaft të mirë që të shumëfishohet zëri dhe përpjekjet e protestuesve, por në praktikë kjo nuk ndodh shpesh. “Ne të gjithë i njohim problemet që kanë mediat tona, përsa i përket pavarësisë dhe nivelit të profesionalizmit. Sidoqoftë, fakti qëndron se media mbetet i vetmi instrument për të vënë një çështje në qendër të vëmendjes së publikut, dhe për të nxitur aktorët kryesorë të lëvizin, të reagojnë, të bëjnë diçka.”¹¹⁹

Raportimi ndotet nga interesa të ngushtë politike dhe ekonomike

Protestat nuk gëzojnë gjithmonë mbulim në media, dhe kjo tregon se interesi i mediave ndaj protestave nuk udhëhiqet gjithnjë nga interesi publik por nga interesa të tjerë të ngushtë, kryesisht ato të pronarëve të medias. Shumica e mediave në vend zotërohen nga sipërmarrës që kanë kompani të tjera biznesi në fusha të ndryshme, dhe është e vështirë që këto media të mbeten të pavarura dhe të paprekura nga interesat e këtyre bizneseve të tjera.¹²⁰ “Pronarët e medias shpesh ushtrojnë presion që të sigurohen se politika e tyre editoriale

¹¹⁹ Intervistë me Ervin Gocin, protestues.

¹²⁰ Observatori i medias në Evropën juglindore, “Rëndësia e Integritetit të Medias; raporti mbi Shqipërinë.” 2014.

të përkojë me interesat e ngushta politike dhe ekonomike, ndërsa auto-censura midis gazetarëve bëhet më e lehtë edhe nga fakti se shumica e tyre punojnë në kushte informale, pa kontrata pune individuale dhe kolektive.”¹²¹

Edhe vetë gazetarët e pranuan se raportimi mbi protestat nuk ka qenë gjithmonë në nivelin më të lartë të mundshëm. “Media ka rol të dorës së parë në pasqyrimin e asaj që ndodh rrotull nesh, por ka mjaft vend për përmirësim, përse i përket thellësisë së raportimit dhe interpretimeve gjatë mbulimit.”¹²² Nga ana tjetër, shumica e të intervistuarve, duke përfshirë protestuesit dhe gazetarët, bien dakord se megjithëse mbulimi në media mund të jetë sipërfaqësor, prapëseprapë ai ka rëndësi jetike. Ata e shohin rolin e medias kryesisht në informimin e publikut të gjerë mbi kërkesat e protestuesve, shtimin e mundësive që këto kërkesa të përfshihen në axhendën publike, dhe mbase të shërbejnë edhe si instrument për mobilizimin e masave. Sidoqoftë, të gjithë e kishin të qartë se biznesi i medias dhe interesat e ngushta zakonisht thonë fjalën e fundit, përse i përket mënyrës si raportohet mbi protestat. “Roli i medias në mbulimin e protestave mund të shërbejë edhe si kushtrim për mobilizimin e masave. Është në gjendje të bëjë thirrje për mobilizim dhe aksion, kur i shkon për shtat interesit të medias, por ajo mund të tregohet edhe apatike kur protestat bien ndesh me interesat e pronarëve të saj.”¹²³ Nga ana tjetër, përdorimi i mediave sociale, shikohet si një mundësi e mirë për të shmangur njëanshmërinë e përgjithshme të mediave kryesore, pa ndonjë preferencë për ndonjë organ mediatik të caktuar (lexo kapitullin mbi mediat sociale).

¹²¹ Treguesi i Qëndrueshmërisë së Medias, nga IREX, 2015.

¹²² Intervistë me Rezar Ballën, redaksia e lajmeve RTSH.

¹²³ Intervistë me Sazan Gurin, ambientalist.

Roli i medias sipas rezultateve të analizës së përmbajtjes

Rastet e veçanta të marra në analizë përkonin me përshtypjet e përgjithshme të të intervistuarve mbi rolin e mediave gjatë protestave. Shumica e të intervistuarve e pranuan rëndësinë shumë të madhe të mbulimit në media gjatë protestave në të tre rastet, por shprehën edhe pakënaqësi mbi cilësinë dhe thellësinë e raportimit, dhe në disa raste edhe mbi nuancat dhe ngjyrimet e artikujve apo kronikave televizive. Ata fajësojnë për këto mangësi ambientin mediatik në vend, që vazhdon të jetë i ndarë në kampe të ndryshme politike, ku media nuk ka pavarësi, dhe është mbërthyer krejtësisht nga interesa politike dhe ekonomike që kërcënojnë apo sigurojnë mbijetesën e saj:

“Media tradicionale te ne është një institucion mbi të cilin hidhen shumë dyshime mbi mënyrën se si funksionon, rolin e saj, përcaktimin dhe ndjekjen e interesit publik. Sidoqoftë, ajo mbetet mjeti kryesor për të tërhequr vëmendjen ndaj protestave. Po të shohim mediat që raportuan mbi protesta, televizioni kryesor privat, që është më pranë qeverisë, erdhi njëherë për të ndjekur protestat dhe pastaj e humbi interesin mbi to. Por, ka edhe media të tjera, që megjithëse kanë marrëdhënie të afërta me qeverinë, janë treguar shumë aktive në ndjekjen e protestave, duke i mbuluar në mënyrë të plotë. Kjo mund të lidhet edhe me faktin se protesta drejtohej edhe kundër përfshirjes së bashkisë së Tiranës në ndërtimin e pallateve, dhe bashkia atëherë drejtohej nga partia në opozitë.”¹²⁴

¹²⁴ Intervistë me Ervin Gocin, pedagog i gazetarisë, protestues.

Duke u nisur nga analiza e përmbajtjes, media nuk bëri ndonjë përpjekje as për t'i justifikuar dhe as për t'i dënuar protestat, dhe në pjesën më të madhe të kohës u mundua të qëndronte neutrale. Në njëfarë mënyre, mbulimi i protestave mbi armët kimike anoi nga ana e protestuesve, meqë zyrtarët nuk komunikonin fare, përveç disa ndërhyrjeve të shkurtra nga mesi i protestave, për të pranuar se kjo marrëveshje po diskutohej, dhe në fund, kur kryeministri lexoi një deklaratë mbi refuzimin e kërkesës. “Zëri i protestuesve mbizotëroi gjatë gjithë kohës, pasi aktorët e tjerë, veçanërisht zyrtarët, nuk reagueshin fare, megjithëse protestuesit ngulën këmbë që të kishte një reagim nga autoritetet.”¹²⁵ Një protestues tjetër, nga studentët e universitetit, gjithashtu konfirmoi dominimin e studentëve si burim informacioni në media, duke pranuar se “media përforcoi zërin e studentëve.”¹²⁶

Megjithëse zyrtarët nuk ishin të pranishëm në pjesën më të madhe të mbulimit, media u mundua të krijonte përshtypjen e raportimit të paanshëm, duke u munduar të kontaktonte ekspertë sigurie apo burime me njohuri mbi armët kimike. Kjo futi në debat opinione të ndryshme nga ato të protestuesve: disa ngulnin këmbë se Shqipëria duhet ta pranonte ofertën për të përmbushur detyrimet e saj ndërkombëtare, dhe të tjerë thonin se procesi i shkatërrimit nuk është i rrezikshëm, dhe është në të mirë të vendit që të pranohet marrëveshja. Në shumicën e rasteve, stacionet televizive u munduan të ulnin të dy palët përballë njëra-tjetrës; ambientalistët apo protestuesit nga njëri krah, dhe ekspertët që mbështesnin marrëveshjen nga krah tjetër. Ky është një format tipik për mediat shqiptare, ku zakonisht ruhet ekuilibri, por ky format gazetarie ndihmon vetëm në

¹²⁵ Intervistë me Blendi Salaj, Club FM gazetar, protestues.

¹²⁶ Intervistë me Rakip Belishakun, student.

ndezjen e debatit dhe diskutimeve midis palëve të ndryshme, dhe nuk i lë hapësirë raportimit të thelluar, gazetarisë investigative, apo gazetarisë dokumentare. Në fakt, emisione debati mbi tema të ditës, që përqendrohen në diskutime, dhe jo në raportime të thelluara, janë një nga formatet më të përhapura në televizionet shqiptare.

Një pjesë e vogël e të intervistuarve ishin të kënaqur me mbulimin e protestave nga media. Sipas institucionit të Avokatit të popullit që ka ndjekur të gjitha demonstratat, “protestat u raportuan gjerësisht në median e shkruar dhe mediat audiovizive, dhe mbulimi ishte në përgjithësi i ekuilibruar.”¹²⁷ Edhe disa nga protestuesit ndanin të njëjtin opinion. “Mbulimi në media ishte i mirë, i plotë, dhe kërkesat tona iu shpjeguan qartë publikut,”¹²⁸ tha një nga studentët pjesëmarrës në protestë. Sidoqoftë, burimi kryesor i pakënaqësisë të protestuesve ishte mungesa e fazës së dytë: raportimi në vazhdim dhe ndjekja e lajmit hap pas hapi. Për shembull, “raportimi në televizion [i ndërtimit të pallateve pranë liqenit artificial] përbëhej kryesisht nga komentet e protestuesve dhe pamje nga aktivitetet, por nuk kishte raportime më të thelluara, dhe nuk bëhej analizë e dukurisë së përgjithshme, që është kthyer në një epidemi për këtë qytet, por dhe për të gjithë shoqërinë shqiptare.”¹²⁹

Gazetarët duket se janë të përcarë në këtë pikë. Disa prej tyre thanë se media luajti rol vendimtar në dëgjimin e zërit të protestave dhe bëri maksimumin e saj. “Nuk besoj se mund të bënim më tepër në këto raste. Po të mos raportonim në televizion mbi protestat, ato nuk do të ekzistonin fare për

¹²⁷ Intervistë me Elona Demollarin, këshilltare për median, Avokati i popullit.

¹²⁸ Intervistë me Rakip Belishakun, student.

¹²⁹ Intervistë me Ervin Gocin, pedagog i gazetarisë, protestues.

publikun, askush nuk do të merrte vesh gjë, dhe në këtë pikë ne dhamë ndihmesën tonë.”¹³⁰ Nga ana tjetër, disa prej tyre e pranuan se raportimi mund të kishte qenë më i plotë dhe më i thelluar. “Puna jonë zakonisht përfundon kur protestuesit largohen nëpër shtëpitë e tyre, dhe ne rendim për të raportuar mbi diçka tjetër; nga mungesa e kohës, përpjekjeve, dhe nganjëherë nuk kemi as vullnet apo mundësi që të gërmojmë më thellë në raportim.”¹³¹ Një gazetar ishte radikal në kritikën e tij ndaj mbulimit në media. “Media është pjesë e politikave të dezinformimit të institucioneve publike. Ato nuk janë aktive në raportimin e protestave, duket sikur njerëzit e thjeshtë nuk ekzistojnë për median dhe lajmet përqendrohen mbi njerëz të bukur dhe me pushtet, ndërsa të shëmтуarit, pleqtë, njerëzit e dobët duket se nuk ekzistojnë.”¹³²

Në disa raste, të intervistuarit, kryesisht protestuesit, bënë dallimin midis mediave në bazë të gatishmërisë së tyre për të raportuar. Për shembull, studentët dhe ambientalistët protestues kanë deklaruar publikisht (dhe e përsëritën edhe në intervista) se mediat online, që konsiderohen prej tyre të pavaruara dhe profesionale, si Reporter.al, version në shqip i BIRN,¹³³ kanë treguar vëmendje të vazhdueshme ndaj kërkesave të protestuesve dhe kanë mbuluar vazhdimisht aktivitetet e tyre.¹³⁴

¹³⁰ Intervistë me Rezar Ballën, redaksia e lajmeve RTSH.

¹³¹ Intervistë me Klevis Saliaj, ATN TV.

¹³² Intervistë me Gjergj Erebarën, BIRN gazetar.

¹³³ BIRN, Rrjeti ballkanik i raportimit investigativ, është një rrjet redaktorësh dhe trajnuesish që ndihmon gazetarët e rajonit që të shkruajnë shkrime të thelluara, analiza dhe raportime investigative mbi çështje të rëndësishme në politikë, ekonomi dhe në fushën sociale, sipas faqes së tyre në internet: <http://www.balkaninsight.com/en/static-page/about-birn> Faqja shqip në internet e BIRN është: <http://www.reporter.al/>

¹³⁴ Intervista me protestues.

Në bazë të monitorimit të përmbajtjes së medias, duke patur parasysh edhe faktorët që lidhen me problemet dhe zgjidhjet, aktorët mund të ndahen në tre grupe kryesore: protestuesit, politikanët, dhe gazetarët.

Aktorët që identifikojnë diagnozën	N	Nëngrupe	N	Aktorët që identifikojnë prognozën	N	Nëngrupe	N
Protestuesit	69	Njerëz të zakonshëm	22	Protestuesit	64	Njerëz të zakonshëm	24
Politikanët	52	Përfaqësues të shoqërisë civile, ambientalistë	47	Politikanët	53	Përfaqësues të shoqërisë civile, ambientalistë	40
		Kryeministri	32			Kryeministri	33
		Ministri i punëve të jashtme	5			Ministri i punëve të jashtme	5
		Kryetari i parlamentit	5			Kryetari i parlamentit	6
		Opozita	6			Opozita	5
		Deputetë	4			Deputetë	4
Ekspertët	9	Ambientalistë	4	Ekspertët	6	Ambientalistë	1
		Ekspertë sigurie	5			Ekspertë sigurie	5
Gazetarë	40	Gazetarë	40	Gazetarë	22	Gazetarë	22
Gjithsej	170		170	Gjithsej	145		145

Tabela 10 – Aktorët që identifikojnë diagnozat dhe prognozatat

Ashtu si tregon edhe tabela më sipër, shumica e aktorëve, që shërbejnë si burime informacioni dhe identifikojnë problemin në rrënjë të protestës, vijnë nga grupi i protestuesve, dhe kjo ndodh në 69 raste nga 170. Sidoqoftë, duhet patur parasysh se nga brenda këtij grupi shumica e personave të cituar apo atyre që identifikojnë problemin

vijnë, nga e ashtuquajtura, elitë e shoqërisë civile, ndërsa protestuesit që nuk njihen nga media përbëjnë vetëm një pjesë të vogël të tyre: 22 nga 69 raste. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për aktorët që identifikojnë prognozën: protestuesit e formuluan prognozën në 64 nga 145 raste, por 40 nga këta 64 protestues janë përfaqësues të shoqërisë civile. Kjo përkon edhe me dinamikën e protestave, pasi grupi i ambientalistëve ishte i pari që njoftoi kundërshtimin e tyre ndaj projektit për shkatërrimin e armëve kimike në vend, dhe ishin një nga grupet më të zhurmshme, si dhe një organizatorët kryesorë të protestës. Gjithashtu, kjo përkon edhe me prirjen që ka media për të folur me të njëjtat burime informacioni, pasi shumë përfaqësues të grupit që nisi protestën kanë mjaft përvojë në media, si pjesë e shoqërisë civile apo si ekspertë.

Kjo prirje nënvizohet nga disa të intervistuar, sidomos nga protestuesit. “Media ka prirjen që të shmangë protestuesit e thjeshtë, dhe preferon të kontaktojë opinionistë apo ideatorët e protestës, ndërsa protestuesit janë më shumë si ilustrim në pamje filmike, jo zëri kryesor i protestës.”¹³⁵ Një tjetër gazetar dhe protestues gjithashtu tërheq vëmendjen drejt problemeve që sjell për protestuesit dukuria shumë e përhapur i emisioneve talk show mbi çështjet e ditës: “Formatet standard televizive bëheshin nganjëhere pengesë, pasi nga gjashtë personazhe në panel vetëm një ishte protestues, ndërsa pesë të tjerët ishin zakonisht analistë televizioni.”¹³⁶ Disa gazetarë e pranuan se një nga arsytet mund të jetë prirja e medias për t’i rënë gjërave shkurt, kur vjen fjala të përzgjedhja e burimeve të informacionit, por disa të tjerë e shpjeguan këtë me dëshirën e protestuesve që të mos dalin në media (ashtu si është përmendur edhe më lart).

¹³⁵ Intervistë me Ervin Gocin, pedagog i gazetarisë, protestues.

¹³⁶ Intervistë me Blendi Salaj, Club FM gazetar, protestues.

Prirja për t'i trajtuar politikanët si burime thelbësore informacioni, që nuk duhet të mungojnë nga asnjë raportim është një tjetër karakteristikë e mbulimit të medias që përmendet nga të intervistuarit. “Në përgjithësi media rend pas politikanëve dhe i konsideron fjalët e qytetarëve si vulgare, dhe jo aq të rëndësishme sa t'i bëhet jehonë në media.”¹³⁷ Përmbajtja e medias mbi protestën kundër armëve kimike nuk është mbase rasti ideal për ta ilustruar këtë prirje, pasi komunikimi nga politikanët dhe deklaratat e tyre ishin minimale dhe ata mbetën në heshtje gati gjatë gjithë protestës. Në fakt, një nga arsytet e vazhdimit të protestës ishte heshtja kokëfortë e zyrtarëve përgjatë gjithë kësaj shtate. E njëjta prirje, për t'i dhënë më shumë rëndësi citimeve dhe ndërhyrjeve të zyrtarëve në krahasim me protestuesit, vihet re edhe te lëvizja studentore, në ato raste të rralla kur ka patur deklarata nga zyrtarë. Megjithëse studentët kanë protestuar për muaj me radhë, në çastin kur kryeministri doli jashtë për të folur me ta, u raportua nga të gjitha mediat dhe reagimi i tij u bë fokusi i lajmit. Nga ana tjetër, kjo prirje nuk vihet re në rastin e tretë, pasi nuk pati fare reagim nga ana e zyrtarëve në rastin e protestës kundër ndërtimit të pallateve. Nisur nga këto elementë, fakti se analiza dhe intervistat nuk e identifikuan si dominante praninë e politikanëve në lajme, kjo nuk tregon patjetër se kemi një media profesionale, por thjesht se raportimi pasqyron kontekstin dhe dinamikën e protestave, ngaqë zyrtarët qëndruan larg një hapësire që mendohet se zakonisht është e rezervuar për ta. Në njëfarë mënyre, kjo ishte një dinamikë që iu imponua medias nga mënyra se si u zhvilluan protestat dhe pjesëmarrja (apo mungesa) e aktorëve të caktuar, dhe kjo nuk erdhi si pasojë e ndonjë metode pune apo politike editoriale.

¹³⁷ Intervistë me Erion Kriston, aktivist.

Megjithatë, politikanët janë burimet më të cituara në media pas protestuesve, me 52 nga 170 identifikime problemi, por ata janë në krahë dhe pozicione të ndryshme të politikës, duke përfshirë edhe burime që nuk janë zyrtarë direkt përgjegjës për çështjet e dala nga një protestë e caktuar. Nga politikanët, më i cituari është kryeministri Edi Rama; ai ndiqet nga ministri i punëve të jashtme, udhëheqës të opozitës, deputetë të tjerë dhe kryetari i parlamentit, që citohehen pak a shumë në një numër rastesh të përafërt. Kjo prani e ndjeshme e politikanëve në citime dhe në identifikimin e problemeve përkoi me ngjarjet kryesore të protestës dhe me kulmin e saj. Meqë kryeministri dhe disa personalitete të tjera ishin pjesë përbërëse e këtyre momenteve dhe ishin faktorë vendimtarë në rezultatin e protestave, duket e natyrshme që prania e tyre të ndihet edhe gjatë monitorimit të medias.

Media	Protestues	Gazetar	Politikan	Ekspert
Lajmifundit	6	7	10	
Albeu	6	3	5	
Balkanweb	12	4	9	1
TV Klan	22	8	8	1
Vizion plus	7	8	7	3
Top Channel	10	4	7	3
Ora News	11	4	4	1
TVSH	10	1	9	
Gjithsej	84	39	59	9

Tabela 11 – Aktorët që identifikojnë problemin, e ndarë në organe mediash

Ashtu si tregon dhe tabela, aktorët kryesorë që identifikonin problemin në çdo media ishin protestuesit, duke shkuar nga 6 në 22 raste. Përjashtimi i vetëm në këtë rast ishte faqja në internet *lajmifundit.al* ku politikanët identifikonin problemin 10 herë, ndërsa protestuesit ishin cituar vetëm gjashtë herë, dhe vetë gazetarët e identifikonin problemin shtatë herë. Por edhe ky rast duhet analizuar duke patur parasysh disa faktorë. Për shembull, në gati të gjitha organet e medias, edhe kur gazetarët identifikonin problemin ata zakonisht përshkruan zhvillimin e protestës dhe përsërisnin kërkesat e protestuesve apo perifraronin deklaratat e politikanëve. Në këtë rast, problemet e identifikuar nga gazetarët mund të jenë përsëritje të problemeve të identifikuar nga protestues apo politikanë, në varësi të personit që gazetari po citonte apo po i referohej. Në media të tjera, rastet kur protestuesit identifikonin problemin ishin pak a shumë të njëjtë në numër me politikanët, si në rastin e Albeu.com, Vizion +, dhe TVSH. Vihet re gjithashtu se televizionet kanë përdorur më shumë burime informacioni sesa artikujt në mediat online, me përjashtim të Balkanweb. Arsyeja kryesore ka të bëjë me mënyrën e ndryshme të paketimit dhe prezantimit të një lajmi nga mediat në internet. Zakonisht lajmet në mediat online janë shumë të shkurtër, shkojnë nga një deri në dy apo tre paragrafe dhe përqendrohen mbi një deklaratë të caktuar apo një ndodhi të veçantë. Kronikat në emisionet kryesore të lajmeve, nga ana tjetër, shpesh citojnë më shumë se një burim, zakonisht disa protestues, dhe kjo sjell një diferencë të ndjeshme në numrin e burimeve. Sidoqoftë, nuk ka ndryshime cilësore midis burimeve në lloje të ndryshme mediash.

		Lajmifundit	Albeu.com	Balkanweb	TV Klan	Vizion +	Top Channel TV	Ora News	TVSH	Totali
Problemi	Siguria e procesit	4	5	7	9	6	5	8	4	48
Zgjidhja	Qeveria duhet ta refuzojë	5	5	6	9	5	4	5	4	43
Problemi	Përgjegjësi institucionale	3	2	4	7	2	4	3	5	30
Zgjidhja	Qeveria të japë llogari, transparencë	2		3	3		2	3	3	16
Problemi	Veprim në interes të publikut	2	3	5	1	3	2	4	5	25
Zgjidhja	Qeveria të jetë e përgjegjshme	1	3	3		3	2	3	6	21
Problemi	Intensifikim protestash	3	1	7	3	4	3	3	1	25
Zgjidhja	Qeveria duhet ta refuzojë	2	1	6	1	3	3	2	1	19
Problemi	Politizimi dhe manipulimi i protestave	4	1		1	1	1			8
Zgjidhja	Ndalim politikanësh nga protestat		1			1	1			3
Problemi	Mungesë besimi te qeveria	2	1			1	2	2	3	11
Zgjidhja	Qeveria refuzon marrëveshjen	1	1	1			2	2	3	10
Problemi	Detyrime ndërkombëtare				2	3	1	1		7
Zgjidhja	Detyrë morale të respektojë aleancat		2	2	1	1				6
Problemi	Shqipëria nuk sjell problem				1					1
Zgjidhja	Shqipëria mund t'i pranojë armët		1							1

Tabela 12 – Problemet dhe zgjidhjet të ndara në organe mediash

Edhe në këtë rast, identifikimi i problemeve dhe zgjidhjeve në secilin organ mediatik nuk tregon ndonjë ndryshim të madh në mbulim. Ashtu si tregohet edhe në tabelë, problemi që ka mbizotëruar gjatë gjithë raportimit dhe në të gjitha mediat ka qenë siguria e procesit, ndërsa zgjidhja më e përmendur ishte refuzimi i marrëveshjes nga qeveria. Problemi i sigurisë së procesit është identifikuar në çdo media nga katër deri në nëntë herë. Problemi i dytë kryesor ka të bëjë me kërkesën e përgjegjesisë dhe transparencën e institucioneve, dhe kjo është identifikuar në të gjitha mediat nga dy deri në katër herë në çdo organ mediatik. Në këtë rast nuk është identifikuar zgjidhje në dy media, megjithëse është lënë të nënkuptohet se qeveria duhet të përmirësojë transparencën dhe dhënien llogari. Si problem i tretë madhor është identifikuar qeverisja e mirë apo interesi publik, dhe zgjidhja është se qeveria *duhet* të veprojë me përgjegjësi, apo se qeveria *është* duke punuar në mënyrë të përgjegjshme, në varësi të citimit nga burime qeveritare apo nga protestuesit. Edhe kjo shfaqet në të gjitha mediat, dhe në shumicën e rasteve ky problem identifikohet nga qeveria dhe kryeministri, ndërkohë që mundohen të sigurojnë publikun se qeveria po vepron në interes të popullit.

Në tërësi, po të marrim parasysh analizën e kornizimit, dhe përmbajtjes në media në përgjithësi, mund të themi se media riprodhon kornizimet dominante, në vend që t'i dalë kundër apo t'i sfidojë ato. Kjo shpjegohet edhe me mënyrën si funksionon media në Shqipëri: përveç analizave apo editorialeve të veçanta mbi çështje të rëndësishme, edicionet kryesore të lajmeve përqendrohen mbi ngjarjet e ditës, deklaratat individuale, postime në Facebook të deklaratave të politikanëve apo personaliteteve të tjera, dhe në përgjithësi ka një mungesë të analizave të detajuara dhe hyrjes në thellësi

të problemeve.¹³⁸ Edhe në rastin e protestave, media është munduar të përçojë te publiku opinionet e aktorëve kryesorë dhe të paraqesë pikëpamjet e kundërta, por duke bërë këtë thjesht kanë përsëritur deklaratat e palëve në konflikt, duke u kthyer në një papagall. Përrjashtimet e pakta nga ky rregull, gjatë analizës së edicioneve të lajmeve, hasen në përfundim të protestës, ku kemi disa kronika që bëjnë një përmbledhje, apo vështrim retrospektiv, mbi protestën kundër armëve kimike, duke renditur ngjarjet në rend kronologjik dhe duke e quajtur atë si protestën qytetare më spontane dhe më masive të 20 viteve të fundit, falë edhe mobilizimit në mediat sociale. Përveç analizës së përmbajtjes në media, intervistat me protestues gjithashtu konfirmuan se në shumicën e rasteve media ka mangësi analitike, i mungojnë aftësitë e interpretimit apo të analizimit të kontekstit, dhe në përgjithësi nuk është shumë e interesuar, apo nuk ka mundësi të gërmojë për informacione nën shtresën e dukshme.¹³⁹

5.7 Roli i mediave sociale dhe platformave të tjera alternative

Facebook ka qenë forma kryesore e komunikimit midis protestuesve, si dhe mjete kryesor për mobilizimin e protestuesve, në rastet e marra në studim. Si rezultat i popullaritetit të madh në Shqipëri dhe rritjes së përdorimit të internetit, komunikimi nëpërmjet faqeve në Facebook ka qenë një mënyrë e shpejtë dhe efektive për mobilizimin dhe organizimin e protestuesve. Më poshtë po japim një

¹³⁸ ISHM, "Mediat sociale në median tradicionale," 2015.

¹³⁹ Intervistë me protestues dhe gazetarë.

përshkrim të përdorimit të mediave sociale në secilin nga rastet e marra në studim.

- ***Protestat kundër armëve kimike***

Protestat kundër shkatërrimit të armëve kimike ishin mjaft intensive, por u zhvilluan në një afat kohor më të shkurtër se dy protestat e tjera, dhe përfunduan në dy javë. Meqë protesta organizohej nga disa grupe të ndryshme dhe nuk kishte ndonjë udhëheqje të qartë, u krijuan disa faqe të protestës në Facebook, por dy prej tyre janë më kryesoret. E para ishte faqja e Aleancës kundër importit të plehrave (AKIP). Ky grup përbëhej nga disa organizata dhe aktivistë, kryesisht ambientalistë, por edhe aktivistë të të drejtave të njeriut. Ishte krijuar disa vite më parë, si reagim ndaj një propozim legjislacioni për të lejuar importin e plehrave dhe disa substancave për riciklim nga vende të huaja. Ky ishte një nga grupet më aktive në organizimin e protestave dhe pjesëmarrjen në debate në media, gjithashtu edhe falë profilit të lartë të pjesëtarëve të tij si aktivistë të shoqërisë civile. Faqja e AKIP-it në Facebook ka 5,882 miq. Megjithëse faqja ekzistonte edhe përpara protestave dhe vazhdon të jetë aktive për veprimtari ambientaliste, ajo ishte një nga mjetet virtuale kryesore që u përdor gjatë protestave kundër armëve kimike. Faqja ishte një kombinim i postimeve nga organizatorët me informacione mbi zhvillimin e aktiviteteve, fotografi dhe pamje video nga protestat, dhe linke me lajme në media shqiptare dhe të huaja rreth planeve mbi shkatërrimin e armëve kimike. Aty postoheshin edhe shumë fotografi nga protestat e organizuara në qytete të tjera duke paraqitur një tablo më të plotë të ngjarjeve dhe aktiviteteve. Mbulimi në media i protestave paraqitej nëpërmjet kësaj faqje, por përmbajtja në të shkonte përtej mbulimit nga media

tradicionale: aty kishte rifreskim të shpeshtë informacioni direkt nga aktivitetet e protestës nga qytete të ndryshme, si dhe informacion mbi protestën e radhës, çfarë nevojitej nga protesta, informacione si të firmosej një peticion online kundër shkatërrimit të armëve kimike në Shqipëri, e kështu me radhë. Sidoqoftë, cilësia e përmbajtjes dhe materialit në këtë faqe nuk ndryshonte në mënyrë dramatike nga mbulimi në media, pasi përfaqësuesit e AKIP ishin figura publike dhe gëzonin akses në media, kështu që një pjesë e deklaratave online u publikuan edhe në media.

Një faqe tjetër në Facebook u krijua posaçërisht për këtë protestë dhe quhej “1 milion shqiptarë kundër shkatërrimit të armëve kimike në Shqipëri.” Kjo faqe u hap nga tre shokë studentë dhe shumë shpejt u identifikua si faqja kryesore për ndërgjegjësimin e publikut dhe mobilizimin për protesta. Një nga krijuesit e kësaj faqeje kujton: “Kjo faqe u krijua që të shërbente si hapësirë mediatike pa ndonjë linjë editoriale të caktuar, për të mundësuar një mbulim të protestave dhe rrjedhë infomacioni sa më të plotë që të ishte e mundur.”¹⁴⁰ Kjo ishte edhe faqja më e vizituar me rreth 130,000 miq e ndjekës.¹⁴¹ Administratorët e saj e përdornin këtë faqe kryesisht për të dhënë informacione mbi aktivitetet e protestës, dhe veçanërisht për mobilizimin e qytetarëve që të bashkoheshin me protestat; dhe me sa duket patën sukses, pasi këto ishin protestat qytetare më të mëdha që nga fillimi i viteve '90. Krijuesit e faqes mendojnë se ndihmesa e tyre kryesor ishte në organizimin e aktivitetit të parë të protestës, në mobilizimin e vazhdueshëm të protestuesve, dhe inkurajimin e nxënësve dhe studentëve për të lënë shkollat

¹⁴⁰ GazetaTelegraf.

¹⁴¹ Vladimir Karaj, revista Mapo, nëntor 2013.

dhe për t'u bashkuar me protestat; e gjitha kjo falë numrit të madh të ndjekësve.¹⁴² Kjo faqe gjithashtu bashkëpunoi me një grup tjetër që hapi një faqe të veçantë për këtë protestë, *Aleanca kundër importit të lëndëve helmuese* (AKILH). Kjo faqe nisi duke shpërndarë lajme dhe informacione mbi armët kimike, dhe u bënte thirrje njerëzve të merrnin pjesë në protesta.¹⁴³ Kjo faqe është ende aktive dhe ndiqet nga 6,938 miq.

- ***Protestat e studentëve***

Lëvizja e studentëve ka faqen e saj në facebook *Për universitetin*. Faqja ka rreth 12,000 ndjekës dhe cilësohet si faqja zyrtare e lëvizjes me të njëjtin emër. Kjo faqe shërben kryesisht për komunikim të brendshëm për lëvizjen; aty postohen informacione mbi aktivitetet e ardhshme dhe i bëhet jehonë aktiviteteve të mëparshme. Shpesh postohen edhe shënime apo shkrime nga pedagogë që mbështesin lëvizjen, apo shprehen opinionet e organizatorëve të lëvizjes mbi reformën në arsim, dhe mbi diskutimet e negociatat mbi ligjin e arsimit. Faqja gjithashtu përmban fotografi dhe postera që bëjnë thirrje për protesta të reja, si dhe ftesa për të firmosur peticione, duke shërbyer si mjet i rëndësishëm për mobilizimin e studentëve.

- ***Protestat ambientaliste***

Edhe protesta e tretë, kundër ndërtimit të pallateve në parkun e liqenit artificial të Tiranës, ka një faqe në Facebook, *Qytetarët për parkun*. Faqja ka 5,068 ndjekës dhe

¹⁴² GazetaTelegraf.

¹⁴³ Po aty.

përqendrohet mbi çështje ambientaliste në përgjithësi, dhe jo vetëm mbi rastin e veçantë të ndërtimit të pallateve. Kjo faqe ka shërbyer për të shpërndarë informacione mbi protestën, por dhe mbi çështje të tjera të natyrës ambientaliste në të gjithë vendin. Në disa raste ka shkëmbyer informacione mbi protestat e studentëve dhe kjo e ka bërë këtë faqe më fleksibël dhe aktive.

Rrjetet sociale si mjet për organizimin e brendshëm dhe mobilizimin e protestave

Ndonëse të gjithë të intervistuarit e konsiderojnë mbulimin nga mediat tradicionale si një mjet të domosdoshëm për komunikimin e protestave me publikun, edhe rrjetet sociale dhe platformat alternative shihen si mjete shume të rëndësishme për mobilizimin dhe organizimin e protestuesve. Siç u shpreh edhe njëri prej tyre: “rrjetet sociale, veçanërisht Facebook, janë shumë të rëndësishme për komunikim gjatë protestave. Shpesh organizohen aktivitete të veçanta dhe njoftimi bëhet nëpërmjet faqeve në internet, si dhe ka goxha komunikim midis protestuesve.”¹⁴⁴ Kjo u nënvizua edhe nga studentët aktivistë, që thanë se komunikimi nëpërmjet mediave sociale “mbetet për ne forma kryesore e komunikimit, si mbi koordinimin e brendshëm, ashtu edhe për organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit.”¹⁴⁵ Po kështu, disa përfaqësues të tjerë të lëvizjes studentore i konsiderojnë rrjetet sociale si mjeti kryesor i komunikimit dhe organizimit midis protestuesve: “Për ne komunikimi online gjatë gjithë zhvillimit të protestave ka qenë i pazëvendësueshëm, pasi

¹⁴⁴ Intervistë me Erion Kriston, aktivist.

¹⁴⁵ Intervistë me Arlind Qorrin, pedagog, protestues.

njoftimet mbi organizimin e protestave dhe mënyrën e protestimit njoftohen online.”¹⁴⁶

Mobilizimi nëpërmjet faqeve në Facebook ishte veçanërisht i rëndësishëm në protestat kundër shkatërrimit të armëve kimike në Shqipëri, edhe sepse këto protesta arritën shkallën më të lartë të mobilizimit dhe diversitetit, nga pikëpamja profesionale, shoqërore dhe gjeografike. Gjithashtu, protestuesit nuk kishin individë udhëheqës apo ndonjë strukturë udhëheqje të përcaktuar qartë, dhe kjo e bëri të domosdoshme ngritjen e një platforme komunikimi dhe shpërndarjen e informacioneve midis protestuesve. Ashtu si kujton një nga protestuesit: “Nuk kishte ndonjë plan të përcaktuar, as plan veprimesh, e gjitha vinte në mënyrë spontane. Unë njihja vetëm disa nga protestuesit, por jo më shumë se një grup të vogël prej tyre. I gjithë komunikimi u krye nëpërmjet postimeve në Facebook, ku njerëz të ndryshëm sugjeronin orën e takimit, çfarë duhej bërë, si dhe çfarë sloganesh dhe pankartash duheshin përgatitur. Ishte si një mbledhje e madhe në internet.”¹⁴⁷

Dy raste e tjera të protestave janë disa të ndryshme në aspektin e organizimit, pasi ato kishin udhëheqës dhe organizatat e tyre mbështetëse, që shpesh punonin apo studionin së bashku, dhe kjo e bënte organizimin më të lehtë. Por sidoqoftë, dhe në këto raste, faqet në Facebook mbetën burimi kryesor i komunikimit të brendshëm dhe mobilizimit. Një nga protestuesit kundër ndërtimeve pranë liqenit kujton: “Facebook u përdor në mënyrë intensive për organizimin e protestave. Informacioni mbi protestat paraqitej dhe diskutohej në Facebook, dhe po aty postoheshin deklaratat e shtypit, fotografi, dhe materiale të tjera. Ne gjithashtu

¹⁴⁶ Intervistë me Rakip Belishakun, student.

¹⁴⁷ Intervistë me Blendi Salaj, Club FM gazetar, protestues.

u munduam të përdornim Twitter për të rritur numrin e simpatizantëve, por Twitter nuk është edhe aq popullor dhe e lamë fare.”¹⁴⁸ Studentët gjithashtu përdorën faqet në Facebook si platformat kryesore të komunikimit. “Të gjitha informacionet mbi organizimin dhe qëndrimet tona kaluan nëpër Facebook.”¹⁴⁹

Protestuesit e intervistuar nuk kishin ndonjë dyshim mbi rëndësinë dhe mundësitë që të jep Facebook për organizim të brendshëm, por edhe për të komunikuar me publikun. Faqet në Facebook janë përdorur për të komunikuar midis protestuesve, për organizimin e aktiviteteve, për ndërgjegjësimin e publikut ndaj situatës së krijuar dhe kërkesave të tyre, duke postuar fotografi, grafika, slogane propagande, pamje video, thirrje për veprim, etj. Ashtu si kujton edhe një nga protestuesit nga mitingjet kundër armëve kimike: “Komunikimi online kishte rëndësi themelore për protestën dhe Facebook ishte instrumenti kryesor. Rrjetet sociale shërbyen për të shprehur pakënaqësinë e protestuesve dhe për të krijuar një platformë mobilizimi për protestat. I gjithë komunikimi dhe organizimi, megjithëse spontan, u bë nëpërmjet rrjeteve sociale. Informacionet mbi armët kimike u hodhën në faqe dhe më pas u shpërndanë nga qindra njerëz, duke e shumëfishuar efektin dhe ndërgjegjësimin e publikut.”¹⁵⁰

Sidoqoftë, të gjithë të intervistuarit, megjithëse i thurin lëvdata rrjeteve sociale, i kuptojnë problemet dhe mangësitë e këtij lloji komunikimi. Një nga protestuesit e demonstratave antindërtim tha: “Ne patëm një komunikim shumë interaktiv në këtë platformë, por komunikimi ishte i kufizuar midis 40-

¹⁴⁸ Intervistë me Ervin Gocin, pedagog i gazetarisë, protestues.

¹⁴⁹ Intervistë me Rakip Belishakun, student.

¹⁵⁰ Intervistë me Blendi Salaj, Club FM gazetar, protestues.

50 personave që ishin shumë të interesuar mbi këtë çështje. Ne nuk arritëm dot që të krijojmë një bashkëbisedim masiv në internet dhe të mobilizojmë më shumë njerëz.”¹⁵¹ Një protestues tjetër, i angazhuar në çështje ambientaliste dhe shumë aktiv gjatë protestave kundër armëve kimike, tha: “Komunikimi në internet ka qenë shumë i rëndësishëm, por ndikimi i televizionit është më i fuqishëm; aty mund të shjehesh më mirë dhe të dëgjohesh nga një publik më i gjerë.”¹⁵² Po kështu, një gazetar që ndoqi protestat tha: “Komunikimi online gjatë protestave është shumë i rëndësishëm, por prapëseprapë nuk është diçka faktike, nuk është realiteti. Në Shqipëri, mediat tradicionale vazhdojnë të jenë më të fuqishmet; do të thosha se rreth 70 përqind e ndikimit vjen nga televizioni, ndërsa media e shkruar gati nuk ekziston fare [përsa i përket ndikimit në publik]. Mediat sociale mund të jenë mirë për komente apo për të bërë *like*, por nuk bëjnë shumë punë në realitet.”¹⁵³

Roli i rrjeteve sociale si mjete alternative informacioni

Të gjithë protestuesit e intervistuar ranë njëzëri dakord mbi rëndësinë e Facebook, si burimi kryesor i informacionit dhe mobilizimit të protestuesve. Megjithëse nuk bien dakord mbi aftësinë e Facebook për të informuar mediat tradicionale apo masat e gjera, në varësi të popullaritetit të faqeve, protestuesit tregojnë se Facebook i paraqiti ata “më sinqerisht” se mediat tradicionale. “Në rastin e lëvizjes universitare, kishte informacione që nuk publikoheshin, apo që censuroheshin, nga mediat tradicionale, por ato

¹⁵¹ Intervistë me Ervin Gocin, pedagog i gazetarisë, protestues.

¹⁵² Intervistë me Sazan Gurin, ambientalist.

¹⁵³ Intervistë me Gjergj Erebarën, BIRN gazetar.

paraqiteshin për të gjithë në Facebook.”¹⁵⁴ Për shembull, në disa raste kur studentët pushtuan ndërtesat e universitetit për pak orë, kjo nuk u vu re nga mediat kryesore, por videot, fotografitë dhe opinionet e studentëve u postuan në faqen e lëvizjes në Facebook.¹⁵⁵ Po kështu, kur filluan protestat e para universitare, kaloi pak kohë përpara se ato të raportoheshin në media, por informacionet, fotot dhe videot e protestës mund të gjendeshin lehtë në Facebook.¹⁵⁶ Diçka e tillë u përsërit edhe nga protestuesit kundër ndërtimit të pallateve në parkun e liqenit: “Facebook ka luajtur një rol vendimtar për mobilizimin e protestuesve; megjithëse kjo lloj media ka kufizime dhe mangësi në krijimin e një audience masive, ne nuk kishim rrugë dhe mjete të tjera. Nga ana tjetër, kjo ishte mënyra e vetme për të publikuar informacion të pastër dhe të vërtetë, në ndryshim nga stili shabllon i raportimit në mediat tradicionale. Media e pasqyron problemin në linja të përgjithshme, por pa paraqitur më shumë informacione apo detaje rreth shkeljeve të veçanta të rregullave të ndërtimit, mundësinë e shkatërrimit të liqenit, e kështu më radhë. E gjitha kjo gjendej në faqen tonë.”¹⁵⁷ Një tjetër përfaqësues i lëvizjes studentore gjithashtu mendonte se faqja në Facebook ishte e rëndësishme edhe për gazetarët, pasi i ndihmonte ata që të informoheshin në kohë reale,¹⁵⁸ ndërsa një nga organizatorët e lëvizjes tha se media nganjëherë citon faqen në Facebook, duke e përdorur atë si burim informacioni.¹⁵⁹ Në fakt, këto vërejtje përkohë me rezultatet e disa studimeve të kohëve të fundit që tregojnë se media po mbështetet gjithnjë e më shumë në

¹⁵⁴ Po aty.

¹⁵⁵ Po aty.

¹⁵⁶ Intervistë me Rakip Belishakun, student.

¹⁵⁷ Intervistë me Ervin Gocin, protestues.

¹⁵⁸ Intervistë me Rakip Belishakun, student.

¹⁵⁹ Intervistë me Arlind Qorin, pedagog, protestues.

Facebook, madje nganjëherë mjaftohet në raportim vetëm me publikimin e deklaratave që postohen aty.¹⁶⁰

Së fundmi, në disa raste mediat sociale shiheshin si burime alternative informacioni kur mediat kryesore perceptoheshin nga protestuesit si të njëanshme, të paiteruesuara, apo jo profesionale. “Nga përvoja jonë, raportimi i mediave tradicionale nuk i përmbush kriteret profesionale të raportimit të ndershëm të protestave në mënyrë të pavarur nga ndikimi i elitave politike dhe ekonomike. Platformat online mund të përdoren nga protestuesit si komunikime mediatike të pavarura.”¹⁶¹ Të intervistuarit ishin gjithashtu të qartë se kjo mund të sjellë një mbulim të popullsisë shumë më të vogël në krahasim me mediat kryesore. “Mediat tradicionale raportojnë mbi protestat kur përzihen interesa politike, meqë edhe ato vetë janë zgjatim i politikës. Kështu që media duhet parë në një kontekst politik. Me mediat sociale është ndryshe, dhe ato mund të jenë një ndihmë e madhe, por nga ana tjetër nuk ndikojnë aq shumë mbi opinionin publik sa mediat tradicionale,”¹⁶² tha një gazetar që kishte ndjekur protestat. Në tërësi, rrjetet sociale kanë patur dy funksione në raport me protestat: si platformë informimi dhe organizimi të brendshëm, dhe më rrallë, si instrument për mobilizimin e masave. Kjo ndodhi kryesisht në rastin e protestave kundër armëve kimike, ku Facebook u përdor për të dhënë informacion logjistik mbi demonstratat si dhe t’u bënte thirrje njerëzve që të bashkoheshin me protestat. Për më tepër, Facebook është përdorur si mënyrë indirekte komunikimi me mediat, ngaqë shpesh raportimet në media citojnë deklaratat dhe komentet e postuara në Facebook.

¹⁶⁰ ISHM, “Mediat sociale dhe përdorimi i tyre nga mediat në Shqipëri,” 2015.

¹⁶¹ Intervistë me Arlind Qorrin, pedagog, protestues.

¹⁶² Intervistë me Gjergj Erebarën, BIRN gazetar.

5.8 Mundësitë dhe mënyrat e komunikimit të qytetarëve/protestuesve

Të tre rastet e marra në studim paraqesin modele dhe mënyra të ndryshme të organizimit të protestave, në lidhje me ekzistencën e strukturave që merren me organizimin dhe komunikimin, si dhe mbulimin në media që vjen si rezultat. Për të patur një tablo më të qartë të eksperiencave të komunikimit të qytetarëve dhe protestuesve, studimi ka marrë në konsideratë disa aspekte: sa të hapur janë protestuesit ndaj medias, niveli i organizimit të protestave, aksesit në media, komunikimi nëpërmjet rrjeteve sociale, dhe format e ndryshme të shprehjes të përdorura nga protestuesit.

- *Sa të hapur janë protestuesit ndaj medias*

Në përgjithësi, intervistat tregojnë se në të tre rastet protestuesit ishin të hapur për bashkëpunim me median. Asnjë nga të intervistuarit nuk mbante mend ndonjë rast kur protestuesit të refuzonin komunikimin me mediat, në të tre rastet e protestave. Në fakt, shumë protestues thonë se ata kanë një pritshmëri të madhe ndaj medias dhe e shohin atë si e vetmja mënyrë për ta përçarur mesazhin te qeveria, publiku, apo kushdo tjetër qoftë objektivi i tyre. Siç u shpreh edhe një nga protestuesit: “Nuk kam dëgjuar kurrë për ndonjë rast kur protestuesit kanë përzënë mediat, madje ndodh krejt e kundërta. Problemi është se jo të gjithë protestuesit kanë mundësinë të dalin në media, dhe është e natyrshme se jo të gjithëve do t’u dëgjohet zëri.”¹⁶³ Eksperienca e

¹⁶³ Intervistë me Sazan Gurin, ambientalist.

protestave antindërtim në Tiranë tregoi të njëjtën prirje. Një nga përfaqësuesit e protestuesve që u intervistua për këtë studim, megjithëse kritikonte cilësinë e komunikimit, theksoi se protestuesit ishin shumë të hapur për të folur me median në çdo kohë: “Natyrisht që protestuesit kishin dëshirë të komunikonin. Të gjitha komunikimet me gazetarët u kryen nga qytetarë të gatshëm për të thënë fjalën e tyre: me deklaratat shtypi, intervista në sheshin e protestës, kontakte të vazhdueshme me gazetarë, madje në disa raste edhe zbulime dokumentesh për gazetarët.”¹⁶⁴ Megjithatë, disa të intervistuar përmendën se zakonisht protestuesit duan që protesta të dalë në media, por jo të gjithë protestuesit duan që të identifikohen publikisht. “Nganjëherë, në Shqipëri, njerëzit kanë ende frikë. Disa nuk duan të dalin jashtë shtëpisë dhe të bashkohen me protestat, apo t’u përmendet emri, mbiemri, dhe arsyeja pse po protestojnë, dhe veçanërisht nuk duan ta bëjnë këtë në media.”¹⁶⁵

- Mënyrat e komunikimit dhe niveli i organizimit të protestave

Studimi tregon se ka disa pikëpamje në lidhje me efektshmërinë e protestuesve për të përçarur mesazhet e tyre, dhe rreth aftësive të tyre organizative. Disa të intervistuar ishin të kënaqur me komunikimin dhe organizimin e protestave. “Paraqitja e protestuesve në media ishte e koordinuar mirë, e organizuar dhe aspak spontane. Mesazhet ishin formuluar qartë dhe mbulimi në media ishte i mirë.”¹⁶⁶ Nga ana tjetër, gazetarët ishin më kritikë kundrejt

¹⁶⁴ Intervistë me Ervin Gocin, pedagog i gazetarisë, protestues.

¹⁶⁵ Intervistë me Gjergj Erebarën, BIRN gazetar.

¹⁶⁶ Intervistë me Sazan Gurin, ambientalist.

mënyrës së komunikimit të protestuesve dhe aftësive të tyre për të formuluar qartë mesazhet. Shumica e gazetarëve të intervistuar thanë se komunikimi nga ana e protestuesve rrallëherë ishte i mirorganizuar, nuk kishte struktura organizative, komunikimi ishte spontan, dhe nuk kishte ndarje të detyrave.¹⁶⁷

Protesta më e organizuar, përsa i përket komunikimit, duket se ishte lëvizja studentore, edhe për faktin se ajo ishte kishte një strukturë të brendshme organizative; protestat dhe mesazhet përkatëse planifikohehin që më parë, ndërsa protestat e tjera ishin më pak të organizuara, përsa i përket aktiviteteve dhe mesazheve që lëshonin. Një nga udhëheqësit e lëvizjes studentore tha: “Aktivistët e Lëvizjes për universitetin kanë krijuar një njësi të veçantë për marrëdhëniet me median, që merret me vetëraportimin e lëvizjes në internet, duke mbuluar aktivitetet për faqen në Facebook, por edhe për kontaktet me gazetarët.”¹⁶⁸ Një tjetër protestues e konfirmon këtë fakt: “Ndërhyrjet në media ishin të koordinuara mirë dhe kishte një formulim të kujdesshëm të mesazhit të protestës. Sidoqoftë, në disa raste ka patur ndërhyrje sporadike të protestuesve, që në të vërtetë nuk kishin lidhje me protestat, dhe që rrezikonin të sabotonin aktivitetet, por ne jemi munduar të bëjmë filtrime të pjesëmarrësve dhe të shmangim incidentet gjatë protestave në vijim.”¹⁶⁹

Ndërkohë që lëvizja studentore duket se është më e organizuar, protesta kundër armëve kimike ishte një grumbullim më spontan grupesh dhe individësh të fushave të ndryshme, dhe natyrisht që në këtë rast ishte më e vështirë

¹⁶⁷ Intervistë me gazetarë.

¹⁶⁸ Intervistë me Arlind Qorin, pedagog, protestues.

¹⁶⁹ Intervistë me Rakip Belishakun, student.

të realizohet një organizim apo strategji në komunikim. Siç vërejt një nga përfaqësuesit e ambientalistëve: “Komunikimi i protestave me median ishte më së shumti spontan. Organizatat më me përvojë janë në gjendje të komunikojnë në mënyrë më të organizuar.”¹⁷⁰

Nga ana tjetër, shumë të intervistuar thonë se kishte mungesë organizimi midis protestuesve, dhe kjo shkaktoi lëshimin e mesazheve kontradiktore.¹⁷¹ “Komunikimi i protestuesve nuk ishte gjithmonë i koordinuar. Ka shumë spontanitet, përveç atyre rasteve kur protestat kanë një sfond politik. Ndodh rëndom që formulohen dhe lëshohen mesazhe kontradiktore.”¹⁷² Një tjetër gazetar, dhe protestues në të njëjtën kohë, i bëri jehonë të njëjtit opinion: “Në rastin e armëve kimike, kishte grupe protestuesish që përfaqësonin grupime të ndryshme shoqërore, dhe që zgjedhën metoda të ndryshme komunikimi. Disa dolën vullnetarisht si zëdhënës në media, por kishte edhe keqkuptime, dhe nganjëherë paraqiteshin qëndrime të ndryshme mbi të njëjtën çështje.”¹⁷³

- ***Hapësira në media dhe metodat e punës në media***

Si protestuesit, ashtu edhe gazetarët, e pranuan në intervista se mesazhet e protestuesve nganjëherë nuk përçohen në media, dhe kjo mund të vijë nga organizimi i dobët i protestuesve, por edhe nga mungesa e interesit të medias rreth kauzës të protestuesve. “Problemi me protestat është se, edhe sikur të ketë vetëm 10 njerëz që protestojnë, por këta janë personalitete të njohura, median e ke direkt aty.

¹⁷⁰ Intervistë me Lavdosh Ferrunin, ambientalist.

¹⁷¹ Po aty.

¹⁷² Intervistë me Erion Kriston, aktivist.

¹⁷³ Intervistë me Blendi Salaj, gazetar Club FM, protestues.

Në rastin e armëve kimike dhe në rastin e lëvizjes studentore, media u detyrua të raportonte mbi protestat, pasi ato ishin vërtetë protesta. E veçanta e këtyre protestave ishte se ato nuk ishin aktivitete të sajura, thjesht për të tërhequr vëmendjen e medias, por akte të vërteta proteste, dhe media nuk kishte mundësi ta shmangte raportimin mbi to.”¹⁷⁴

Edhe përzgjedhja e personave për të përfaqësuar protestat në media është nganjëherë e dyshimtë, thanë disa të intervistuarve. Disa prej tyre vërejnë se mbulimi në media ka prirjen të përqendrohet mbi personalitetet më publike, që bëjnë lajm, për të përçuar mesazhet e protestës, megjithëse ata mbase nuk janë njerëzit më të përshtatshëm për t’u intervistuar mbi një çështje të caktuar. Një nga protestuesit vërejtë se media shpesh mund të japë idenë e gabuar me mbulimin e saj, pasi nuk zgjedhin personin e duhur për të përçuar mesazhin e protestave.¹⁷⁵ Po kështu, një protestues tjetër u ankua mbi prirjen e medias për të intervistuar personalitete të njohura dhe opinionistë që marrin pjesë në demonstrata, dhe jo persona më pak të njohur por shumë të angazhuar në protesta.¹⁷⁶

Kjo prirje për të rendur pas njerëzve të famshëm në protesta vihet re qartë në analizën e përmbajtjes në media: nga 63 raste kur protestuesit identifikojnë problemin, drejtuesit e lëvizjes citohen 38 herë, dhe në 15 raste të tjerë citohet organizata ku ata bëjnë pjesë. Njerëzit e thjeshtë në protesta e identifikojnë problemin vetën 10 herë në 63 raste. Këto të dhëna mund të jenë të vlefshme për të ndihmuar protestuesit që të gjejnë hapësira në media në të ardhmen. Një prej tyre përmend një nga mënyrat për ta

¹⁷⁴ Intervistë me Gjergj Erebarën, BIRN gazetar.

¹⁷⁵ Intervistë me Erion Kriston, aktivist.

¹⁷⁶ Intervistë me Ervin Gocin, pedagog i gazetarisë, protestues.

bërë një protestë të suksesshme: “Është e rëndësishme të krijosh lidhje me persona në pozita kyç në media që mund të angazhohen në mbulimin e protestave.”¹⁷⁷ Nga ana tjetër, një taktikë e tillë, ndonëse e suksesshme, mund të kufizojë apo të shtrembërojë pasqyrimin e aktiviteteve dhe përfaqësimin e protestuesve.

Masiviteti i protestave është gjithashtu një faktor kyç në tërheqjen e vëmendjes së medias ndaj protestave. I tillë ishte rasti i protestave kundër armëve kimike, ku një numër i madh njerëzish ishin vazhdimisht në rrugë duke protestuar, dhe kjo e bëri të pamundur injorimin nga ana e medias. Kjo është një ‘domosdoshmëri,’ sipas shumicës së të intervistuarve: “Kur protestat bëhen masive, atëherë media vjen vetë dhe nuk ka më nevojë për njoftime apo komunikime dhe ftesa të mëparshme.”¹⁷⁸

Nga ana tjetër, protestuesit e kanë shumë të qartë rëndësinë e vëmendjes së medias, nëse duan që protesta të ketë sukses. Megjithëse ata e konsiderojnë mbulimin në media si sipërfaqësor, dhe ankohen se mungon raportimi investigativ dhe hyrja në thellësi të problemit, ata e konsiderojnë mbulimin nga media si instrument thelbësor për ndërgjegjësimin e masave. “Qytetarët (në protesta) e shohin median si varkë shpëtimi; duan të komunikojnë me gazetarët me çdo kusht. Sidoqoftë, gazetarët nuk janë gjithmonë të pranishëm në protesta dhe nuk janë në gjendje ta transmetojnë mirë mesazhin.”¹⁷⁹ Përjashtim, ndërmjet tre protestave, bën rasti i lëvizjes studentore, që fillimisht nuk kishte besim te media. Sidoqoftë edhe studentët ndryshuan taktikë. Sipas një gazetari që i ka ndjekur nga afër këto

¹⁷⁷ Intervistë me Lavdosh Ferrunin, ambientalist, protestues.

¹⁷⁸ Po aty.

¹⁷⁹ Intervistë me Erion Kriston, aktivist.

protesta, studentët kanë filluar të kuptojnë fuqinë e saj dhe janë përpjekur të mbajnë një qëndrim ndryshe ndaj medias, duke u munduar të tërheqin vëmendjen e saj.¹⁸⁰

- *Komunikimi i protestuesve nëpërmjet rrjeteve sociale*

Në të tre rastet, protestat kanë komunikuar me publikun nëpërmjet raportimit në media dhe rrjeteve sociale, kryesisht me anë të faqeve në Facebook. Kjo media sociale i jep mundësi protestuesve ta krijojnë vetë përmbajtjen e faqes dhe t'ia transmetojnë publikut, duke postuar fotografi, postera, slogane, video, forume diskutimi, shënime, artikuj, etj. Sipas protestuesve, aftësia për të kontrolluar përmbajtjen e faqes është një nga avantazhet e kësaj platforme, në krahasim me format e tjera të komunikimit në media (është përmendur më lart në rolin e rrjeteve sociale). Për shembull, siç kujton një nga protestuesit kundër armëve kimike: “Ne postuam fotografi të personave që merrnin pjesë në protesta për t'i dhënë lëvizjes një pamje më njerëzore: prindër me fëmijë, të rinj të kapur për dore në protesta, për të paraqitur sa më shumë të ishte e mundur fytyrën njerëzore të protestuesve, për të treguar se nuk kishte asgjë që nuk shkonte me protestat.”¹⁸¹

Një efekt anësor i këtij mbulimi të protestave në Facebook, ishte efekti shumëfishues dhe jehonë kur postimet nga protestues shfaqeshin në media. Sipas protestuese dhe gazetarëve, përmbajtja në Facebook ka ndihmuar edhe median gjatë raportimit të protestave¹⁸², dhe në fakt, ka shumë gazetarë që ndjekin faqet e protestave në Facebook.

¹⁸⁰ Intervistë me Gjergj Erebarën, BIRN gazetar.

¹⁸¹ Intervistë me Blendi Salaj, Club FM gazetar, protestues.

¹⁸² Intervistë me gazetarë dhe protestues.

- *Format e ndryshme të shprehjes gjatë protestave*

Forma kryesore e shprehjes gjatë protestave ishte marshimi në rrugët kryesore dhe përballë ndërtesave qeveritare, ngulja me çadra përballë ndërtesës së universitetit, fjalimet, thirrja e sloganeve, e kështu me radhë. Nga ana tjetër, në disa raste protestuesit u munduan të ishin më krijues në shprehjen e kërkesave të tyre. Kjo ndodhi në rastin e protestave të studentëve, dhe deri në njëfarë pike me protestën kundër armëve kimike. Për shembull, protestuesit dhe gazetarët kujtojnë se gjatë protestës së armëve kimike, organizatorët i kërkuan të gjithë protestuesve të tregoheshin krijues dhe të krijonin posterat e tyre për t'i marrë me vete në protestë, dhe kjo solli një diversitet sloganesh.¹⁸³ Gjithashtu, disa nga protestuesit u munduan të përdornin përjasje të reja dhe simbolike. Për shembull, përveç mënyrës klasike të komunikimit nëpërmjet deklaratave dhe njoftimeve për shtyp, studentët u munduan të tërhiqnin më shumë vëmendje duke e gjuajtur ndërtesën e kryeministrit me topa letre higjienike; duke tërhequr zvarrë një kuti të madhe që personifikonte kredinë e studentit; shkrimin e sloganeve me bojë të kuqe në rrugë, etj¹⁸⁴.

¹⁸³ Intervistë me Gjergj Erebarën, BIRN gazetar, dhe Sazan Gurin, ambientalist.

¹⁸⁴ Intervistë me Arlind Qorrin, pedagog, protestues.

6. Shënime të fundit

Protestat në Shqipëri gjenden në një krizë institucionale, për disa arsye. Së pari, protestat e kanë humbur besimin e masave, pasi janë kthyer në instrumente që përdoren gjerësisht nga klasa politike, dhe kjo ka sjellë edhe zhgënjimin e popullatës kundrejt tyre. Së dyti, protestat zakonisht përballen me mungesë rezultati dhe dështojnë në kërkesën e llogarisë ndaj zyrtarëve dhe institucioneve qeveritare, dhe kjo nuk lë vend për shpresë në përdorimin e protestave për të arritur objektiva të caktuara. Këto faktorë, së bashku me dobësinë e përgjithshme dhe apatinë e shoqërisë civile, ka sjellë në një situatë të tillë të turbullt dhe konfuzë, aq sa të intervistuarit mendojnë se lëvizjet sociale janë të nevojshme, por në të njëjtën kohë ka shumë pak besim ndaj protestave.

Mbulimi në media gjatë protestave, në përgjithësi, konsiderohet si neutral, por sipërfaqësor. Ka shumë pak raportime të thelluara në media, dhe i mëshohet më fort ruajtjes së ekuilibrit dhe korrektësisë politike. Nuk ka raportime që mund të japin një tablo të plotë të dinamikës dhe arsyeve të protestave, dhe të merren seriozisht me problemet bazë që ngrihen nga protestuesit. Megjithatë interesat e ngushta të medias zakonisht ndikojnë apo orientojnë mbulimin në media, analiza e përmbajtjes së lajmeve tregoi për një mbulim shabllon të protestave,

me shumë pak diferenca në raportim midis organeve të ndryshme mediatike.

Media i bën rregullisht jehonë shqetësimeve të protestuesve mbi qeverisjen e përgjegjshme, kërkesën e llogarisë, dhe mungesën e transparencës, por vetë ajo ngurrton të nisë debatin mbi përgjegjësinë publike dhe shumë rrallë e ndjek këtë çështje. Në të njëjtën kohë, nocioni i dhënies llogari kundrejt protestuesve dhe qytetarëve është shumë i dobët te zyrtarët e shtetit. Praktikant e komunikimit në këtë aspekt tregojnë se zyrtarët zakonisht i injorojnë kërkesat për përgjegjësi publike, apo i shmangen dialogut të drejtpërdrejtë me përfaqësuesit e protestës. Edhe në ato raste të rralla kur ata bënë përpjekje të hapin linja komunikimi, diskutimi mori tone populiste, duke shmangur përgjigjet mbi çështjet kryesore të protestës. Në tërësi, perspektivat për përmirësimin e marrëdhënieve zyrtarë-qytetarë në kërkesën e llogarisë duken shumë të zymta, dhe protestat duket se nuk e kanë ndryshuar për mirë situatën e përgjegjësisë publike.

Ky studim konfirmoi rolin themelor të medias në informimin e publikut rreth protestave dhe në vënien e kërkesave të protestuesve në qendër të vëmendjes të debatit publik. Megjithëse raportimi në media mund të jetë ndonjëherë i njëanshëm dhe shpesh sipërfaqësor, ndikimi i saj në ndërgjegjësimin e publikut është i pazëvendësueshëm. Edhe pse rrjetet sociale përdoren gjerësisht dhe parapëlqehen për organizimin e protestave dhe mobilizimin e protestuesve; kur vjen puna te komunikimi me publikun, mediat kryesore konsiderohen si forma më efektive e informimit.

Megjithatë, protestuesit nuk e gëzojnë gjithmonë vëmendjen e dëshiruar nga media, si pasojë e përplasjes së interesave të vetë medias me ato të protestuesve, apo mbase thjesht sepse përmasat e protestave nuk mjaftojnë për të ndezur interesin e medias. Prirja për t'i krijuar

hapësira, të ashtuquajturve, personalitete protestash, dhe jo protestuesve të thjeshtë, nuk siguron mbulimin më të mirë për aktivitetet e protestës, kërkesat dhe dinamikën e tyre. Po kështu, uzurpimi i mbulimit në media nga politikanët është një prirje e dukshme edhe në raportimin e protestave, ku fokusi kalon mbi protestuesit vetëm atëherë kur mungojnë zyrtarët.

Komunikimi midis protestuesve bëhet kryesisht në faqet në Facebook, për organizimin e brendshëm të protestuesve, si dhe për të shtuar numrin e mbështetësve dhe simpatizantëve midis publikut të gjerë. Mediat sociale janë kthyer edhe në një mënyrë komunikimi të informacionit drejt medias tradicionale, duke shtuar kështu ndikimin e protestës nëpërmjet mbulimit në media. Megjithatë, komunikimi i protestuesve me median, dhe për pasojë edhe me publikun, nuk ka qenë gjithnjë i organizuar mirë, i qartë, apo unanim. Cilësia e komunikimit varet shumë nga struktura e brendshme organizative e protestuesve, si dhe zotësia e tyre për të krijuar raporte dhe kontakte me median.

7. Rekomandime

Për zyrtarët shtetërorë

- Komunikoni direkt me protestuesit, si në rrugë, ashtu edhe në media.
- Të rritet transparenca nëpërmjet komunikimit të vazhdueshëm në takime të hapura dhe diskutime me median, me grupet e interesit, dhe me protestuesit.
- Të shtohen përpjekjet për zbatimin më efektiv të ligjit të ri mbi të drejtën e informimit, si një mënyrë për të përmirësuar transparencën dhe përgjegjësinë publike, duke qenë më të hapur kundrejt qytetarëve, përfshi edhe protestuesit.

Për median

- Raportimet mbi protestat duhet të jenë më serioze, duke i hyrë në thellësi problemeve, dhe duke shkuar përtej ekuilibrit dhe korrektësisë politike.
- Ndiqni më tej çështjet e përgjegjësisë publike edhe pasi të kenë përfunduar aktivitetet e protestave apo edhe vetë protestat, duke monitoruar qeverinë, zyrtarët, institucionet.

- Mundohuni të zgjeroni rrethin e personave që intervistoni dhe që flasin në emër të protestave.
- Nxisni debatin dhe bashkëbisedimin midis zyrtarëve dhe protestuesve.

Për protestuesit

- Ndërtoni një strategji komunikimi që të përfshijë disa subjekte apo faktorë, si median, zyrtarët, shoqërinë civile, dhe qytetarët, duke formuluar qartë mesazhin, kërkesat, dhe mënyrën e komunikimit.
- Gjeni mënyra origjinale dhe të efektshme për të shprehur kërkesat e protestës (për shembull: ndërhyni dhe protestoni në aktivitete të elitave, forma shprehje alternative, simbole të forta vizive, etj.).
- Kërkoni që media të mbahet në komunikim dhe kontakt të vazhdueshëm në mënyrë që të ndjekë dhe të raportojë më mirë mbi protestat.
- Përdorni të gjitha mundësitë që ju jepen nga mediat alternative dhe rrjetet sociale për të dhënë informacion dhe për të organizuar aksionin e protestës.

Bibliografi

Autoriteti i Mediave Audiovizive. Lista e operatorëve të liçensuar: http://ama.gov.al/index.php?option=com_content&view=category&id=21&Itemid=75&lang=sq, faqja u vizitua në tetor 2015.

Bertelsmann Stiftung, “Bertelsmann Transformation Index 2012: Albania Country Report,” (**Treguesi Bertelsmann i transformimit 2012: Raporti mbi Shqipërinë**) Bertelsmann Stiftung: Gütersloh, 2012.

Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, “National survey on perceptions & expectations towards a potential EU membership of Albania,” (**Studim kombëtar mbi perceptimet dhe pritshmëritë ndaj anëtarësimit të mundshëm të Shqipërisë në BE**) 2014.

Friedrich Ebert Stiftung Shqipëri, “Albanian youth 2011: Between present hopes and future insecurities,” (**Rinia shqiptare 2011: Midis shpresës sot dhe pasigurisë për të ardhmen**) FES: Tiranë, 2011.

I. Londo në Peace Institute, “Nurturing Client Based Media Practices,”2015.(**Krijimi i praktikave klienteliste në media**)

IDRA, "Corruption in Albania: Perception and Experience: Survey 2010." (**Korrupsioni në Shqipëri: perceptime dhe eksperiencia: sondazh 2010**)

IDRA, "Corruption in Albania: Perception and Experience: Surveys 2005- 2010." (**Korrupsioni në Shqipëri: perceptime dhe eksperiencia: sondazhe 2005-2010**)

Instituti Shqiptar i Medias, "Përdorimi i mediave sociale në median tradicionale," ISHM: Tiranë, 2015.

Instituti Shqiptar i Medias, "Treguesi i hapjes të institucioneve publike," ISHM: Tiranë, 2012-2015.

Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare, "Shqipëria në dhjetë vitet e ardhshme: Politika, Ekonomia, Shoqëria - Perceptime," ISHSN: Tiranë, 2012.

Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare, "Shqiptarët dhe modeli i ri evropian," ISHSN: Tiranë, 2015.

IREX, Treguesi i Qëndueshmërisë së Medias 2015: Shqipëria.

Lani, ed., "Balkan Media Barometer: Albania, 2013," (**Barometri Ballkanik i Medias**) Instituti Shqiptar i Medias.

I. Londo në Peace Institute, "Media Integrity Matters," (**Rëndësia e Integritetit të Medias**) Shqipëria, 2014.

O. Liperi, "Gara për milionat e publicitetit," Revista Monitor: <http://www.monitor.al/gara-per-milionat-e-publicitetit-2/>

O. Liperi, "Bie tregu i reklamave: televizionet dhe gazetat në krizë," Revista Monitor: <http://www.monitor.al/bie-tregu-reklamave-televizionet-dhe-gazetat-ne-krize/>

Rr. Zguri, "Media Sociale në Shqipëri, 2015," Instituti Shqiptar i Medias, 2015.

Ulrike Stern and Sarah Wohlfield, "Albania's Long Road into the European Union: Internal Political Power Struggle Blocks Central Reforms," (**Rruga e gjatë e Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian: lufta e brendshme politike për pushtet pengon reformat thelbësore**) Deutsche Gesellschaft für Auswärtige Politik –DGAP:Berli, 2012.

Intervista

Intervistë me Arlind Kote, lëvizja Forca Rinia, 5 maj 2015.

Intervistë me Arlind Qorrin, pedagog, protestues, 11 maj 2015.

Intervistë me Blendi Salaj, gazetar, Club FM Radio dhe protestues, 6 qershor 2015.

Intervistë me Elona Demollari, këshilltare për median Avokati i popullit, 28 maj 2015.

Intervistë me Erion Kriston, aktivist, 21 maj 2015.

Intervistë me Ervin Gocin, pedagog, protestues, 3 qershor 2015.

Intervistë me Gjergj Erebarën, BIRN gazetar, 30 korrik 2015.

Intervistë me Klevis Saliaj, ATN TV, 16 maj, 2015.

Intervistë me Lavdosh Ferrunin, ambientalist, 20 maj 2015.

Intervistë me Rakip Belishaku, student, protestues, 27 maj 2015.

Intervistë me Rezar Ballën, kryeredaktor i redaksisë së lajmeve RTSH, 10 qershor 2015.

Intervistë me Sazan Gurin, ambientalist, 17 maj, 2015.

Analiza e përmbajtjes në media

A. N., Shoqeria civile proteston kunder asgjesimit te armeve kimike te Sirise ne Shqiperi, Balkanweb, 7 nëntor, 2013, <http://www.balkanweb.com/site/arkiva-2000-2014/>

AKIP në protestë: “Jo” armëve kimike siriane në Shqipëri!, Ora News Lajme, Ora News TV, 12 nëntor, 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=WuP6oMGU9jI>

AKIP: Jo armeve kimike ne Shqiperi, Albeu.com, 9 nëntor, 2013, <http://www.albeu.com/shqiperi/akip-jo-armeve-kimike-ne-shqiperi/131196/>

AKIP: Kunder asgjesimit te armeve siriane ne Shqiperi, TVSH Lajme, TVSH, 3 nëntor, 2013.

Alma Demiraj, Proteste kunder armeve kimike, Edicioni Informativ, Top Channel TV, 9 nëntor, 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=mT1iw8IUj5k>

Ambientalistet dhe biznesi: Rama te refuzoje armet kimike, s’ka negociata, Lajmifundit.al, 15 nëntor, 2013, <http://lajmifundit.al/2013/11/ambientalistet-dhe-biznesi-rama-te-refuzoje-armet-kimike-ska-negociata/>

Ambientalistet protestojne kunder armeve kimike, TVSH Lajme, TVSH, 9 nëntor, 2013.

Ambientalistet: Qeveria e ka mbyllur marreveshjen me SHBA, TV Klan, Edicioni Kryesor i Lajmeve, TV Klan, 9 nëntor, 2013, https://www.youtube.com/watch?v=fh0_TJHQ12U

Armët e Sirisë në Shqipëri? Guri: Përgatitjet kanë nisur prej kohësh, Ora News Lajme, Ora News TV, 9 nëntor, 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=Upo9Wqwu06U>

Armet kimike nga Siria, ambientaliste e qytetare ne proteste, Lajmifundit.al, 7 nëntor, 2013, <http://lajmifundit.al/2013/11/armet-kimike-nga-siria-ambientaliste-e-qytetare-ne-proteste/>

Armët kimike nga Siria, bashkia Elbasan kundër: Barrë e rëndë për qytetin, Ora News Lajme, Ora News TV, 7 nëntor, 2013, https://www.youtube.com/watch?v=T_5uO42ckVg

Armet kimike te Sirise, Rama: Nuk ka asnje vendim, qytetaret do informohen per gjithcka, Lajmifundit.al, 12 nëntor, 2013, <http://lajmifundit.al/2013/11/mbyllet-takimi-per-integrimin-fyle-rama-dalin-para-medias/>

Armet kimike, debat ne kuvend, Edicioni Informativ, Top Channel TV, 14 nëntor, 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=PSx1c5uuLx0>

Armet kimike, Rama: Nese vendosim, cmontimi s' do te jete i rrezikshem, Albeu.com, 12 nëntor, 2013, <http://www.albeu.com/shqiperi/armet-kimike-rama-nese-vendosim-cmontimi-sdo-jete-i-rrezikshem/131479/>

Armet kimike, Rama: Nuk i pranojme, TVSH Lajme, TVSH, 15 nëntor, 2013.

Armët kimike, Rama: S`kemi marrë ende një vendim, Ora News Lajme, Ora News TV, 12 nëntor, 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=AOvRIsfgjFA>

Armet kimike, Rama: S`ka vend per alarm, Albeu.com, 13 nëntor, 2013, <http://www.albeu.com/kryetitull/armet-kimike-rama-ska-vend-per-alarm/131667/>

Armet kimike, vazhdon protesta para kryeministrise ne Tirane, Lajmifundit.al, 14 nëntor, 2013, <http://lajmifundit.al/2013/11/armet-kimike-vazhdon-protesta-para->

kryeministrise-ne-tirane/

Basha: Rama e ka marre vendimin, PD kerkon referendum per armet kimike, Lajmifundit.al, 14 nëntor, 2013, <http://lajmifundit.al/2013/11/basha-rama-e-ka-marre-vendimin-pd-kerkon-referendum-per-armet-kimike/>

Blerina Moka, Kunder armeve kimike te Sirise, Edicioni Informativ, Top Channel TV, 11 nëntor, 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=xZAwjGShR-U>

D. B., Armet kimike, proteste para Ambasades SHBA ne Tirane, tubime edhe ne Prishtine, Balkanweb, 12 nëntor, 2013, <http://www.balkanweb.com/site/arkiva-2000-2014/>

D.B., AKIP informon qytetaret: Ja perse nuk duhen armet kimike ne Shqiperi, Balkanweb, 9 nëntor, 2013, <http://www.balkanweb.com/site/arkiva-2000-2014/>

D.B., AKIP: Asgjesim i armeve siriane ne Shqiperi? Qeveria shqiptare te reagoje, Balkanweb, 3 nëntor, 2013, <http://www.balkanweb.com/site/arkiva-2000-2014/>

Dhjete arsye pse Shqiperia duhet t'i refuzoje armet kimike, Albeu.com, 9 nëntor, 2013, <http://www.albeu.com/shqiperi/dhjete-arsye-pse-shqiperia-duhet-ti-refuzoje-armet-kimike/131171/>

Ende asnje vendim per armet kimike, TVSH Lajme, TVSH, 12 nëntor, 2013.

Er. Nu, Armet kimike ne Shqiperi? Bushati: Jemi kontaktuar nga SHBA, s'kemi marre vendim, Balkanweb, 5 nëntor, 2013, <http://www.balkanweb.com/site/arkiva-2000-2014/>

Er. Nu., AKIP petition qeverise per te refuzuar armet kimike, Balkanweb, 15 nëntor, 2013, <http://www.balkanweb.com/site/arkiva-2000-2014/>

Er. Nu., Armet kimike, Meta: Pergjegjesi, aq sa na mbajne supet. Basha: Te ngrihemi kunder heshtjes se qeverise, Balkanweb, 10 nëntor, 2013, <http://www.balkanweb.com/site/arkiva-2000-2014/>

Er. Nu., Armet kimike, Rama-qytetareve: Nuk i pranojme. I pamundur asgjesimi ne Shqiperi, Balkanweb, 15 nëntor, 2013, <http://www.balkanweb.com/site/arkiva-2000-2014/>

Er. Nu., Forumi civil, rezolute kunder armeve kimike: “Jo” garanton te ardhmen e qytetareve, Balkanweb, 15 nëntor, 2013, <http://www.balkanweb.com/site/arkiva-2000-2014/>

Erida Gjermani, Protesta para ambasadës SHBA, Lajme, Vizion Plus TV, 12 nëntor, 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=d00j5kqsDq0>

Fillojne protestat kunder armeve kimike te Sirise, TVSH Lajme, TVSH, 7 nëntor, 2013.

Fitoi rinia, Shqiperia i thote JO armeve kimike, Albeu.com, 15 nëntor, 2013, <http://www.albeu.com/shqiperi/jo-faleminderit/131857/>

Fitojne protestuesit, TVSH Lajme, TVSH, 15 nëntor, 2013.

Ish agjenti i CIA: Armet cojini ne Shqiperi, TV Klan, Edicioni Kryesor i Lajmeve, TV Klan, 11 nëntor, 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=1xEGpyd7Xz0>

Jolldiz Mitro, Si shkuam nga “po” te “jo”, TV Klan, Edicioni Kryesor i Lajmeve, TV Klan, 15 nëntor, 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=A6MWSLX6uSI>

Kerry i ka telefonuar Rames per armet, TVSH Lajme, TVSH, 7 nëntor, 2013.

Kerry i telefonon Ramës për armët, Bushati zbulon bisedën për lëndët kimike, Ora News Lajme, Ora News TV, 8 nëntor,

2013, <https://www.youtube.com/watch?v=ixdNwVMZxLk>

Klodiana Kapo, Protese kunder armeve kimike, Edicioni Informativ, Top Channel TV, 12 nëntor, 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=dK9GvMwUOoY>

Kryeqyteti ne protesta, Lajme, Vizion Plus TV, 14 nëntor, 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=6Oqzz4DnNYg>

Mbetjet kimike te 2007, Lajme, Vizion Plus TV, 9 nëntor, 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=KqXvavVVFRw>

Meta takon protestuesit: vendimi per armet kimike ne interes te qytetareve, Lajmifundit.al, 14 nëntor, 2013, <http://lajmifundit.al/2013/11/meta-takon-protestuesit-vendimi-per-armet-kimike-ne-interes-te-qytetareve/>

Meta: vendimi ne interes te qytetareve, TVSH Lajme, TVSH, 14 nëntor, 2013.

Ne pritje te vendimit per armet kimike, TV Klan, Edicioni Kryesor i Lajmeve, TV Klan, 14 nëntor, 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=RsNzHKu9bvQ>

Ola Xama, Protesta maratone kunder armeve kimike, Lajme, Vizion Plus TV, 9 nëntor, 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=KqXvavVVFRw>

Ornela Joti, Kryeqyteti ne protesta, Lajme, Vizion Plus TV, 14 nëntor, 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=6Oqzz4DnNYg>

Pro & kunder armeve kimike, Lajme, Vizion Plus TV, 9 nëntor, 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=KqXvavVVFRw>

Protese kunder armeve kimike, TVSH Lajme, TVSH, 12 nëntor, 2013.

Protesta kunder armeve kimike, Edicioni Informativ, Top

Channel TV, 13 nëntor, 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=z4T4NcS3RvY>

Protesta kunder asgjesimit te armeve te Sirise, Albeu.com, 7 nëntor, 2013, <http://www.albeu.com/shqiperi/protesta-kunder-asgjesimit-te-armeve-te-sirise/131033/>

Protesta ne te gjithë vendin, TVSH Lajme, TVSH, 13 nëntor, 2013.

Protesta ne Tirane dhe ne rrethe, qytetaret zbresin ne shesh kunder armeve kimike, Lajmifundit.al, 14 nëntor, 2013, <http://lajmifundit.al/2013/11/protesta-ne-tirane-dhe-ne-rrethe-qytetaret-zbresin-ne-shesh-kunder-armeve-kimike/>

Protesta ne Tirane, Elbasan, dhe Fier, TV Klan, Edicioni Kryesor i Lajmeve, TV Klan, 11 nëntor, 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=1xEGpyd7Xz0>

Proteste kunder armeve kimike te Sirise, TV Klan, Edicioni Kryesor i Lajmeve, TV Klan, 7 nëntor, 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=H2Em7XcbJw4>

Protestë kundër shkatërrimit të armëve siriane në Shqipëri, Ora News Lajme, Ora News TV, 7 nëntor, 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=Od5T9slPtUg>

Protestuesit perzene Berishen dhe Bashen nga protesta, Albeu.com, 14 nëntor, 2013, <http://www.albeu.com/shqiperi/protestuesit-perzene-berishen-dhe-bashen-nga-protesta-foto-lajm/131743/>

Protestuesit: Revolte popullore nese nuk refuzohen armet kimike, Lajmifundit.al, 15 nëntor, 2013, <http://lajmifundit.al/2013/11/protestuesit-revolte-popullore-nese-nuk-refuzohen-armet-kimike/>

Qytetaret pushtojne sheshin, Edicioni Informativ, Top

Channel TV, 14 nëntor, 2013, https://www.youtube.com/watch?v=h1x_dSdua1k

Rama flet per here te pare per armet kimike, TV Klan, Edicioni Kryesor i Lajmeve, TV Klan, 12 nëntor, 2013, https://www.youtube.com/watch?v=OT6n_EIByA

Rama jo SHBA-së për armët kimike. Sulmon krerët e PD: Helmuhan protestën, Ora News Lajme, Ora News TV, 15 nëntor, 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=OAtoMgxrMY4>

Rama: Armet kimike? Kur te na kerkohet vendim do e ndajme me publikun e Kuvendin, Balkanweb, 12 nëntor, 2013, <http://www.balkanweb.com/site/arkiva-2000-2014/>

Rama: Perkrahe SHBA per carmatimin e regjimit sirian, TV Klan, Edicioni Kryesor i Lajmeve, TV Klan, 11 nëntor, 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=1xEGpyd7Xz0>

Rama: S'ka pasur vendim per armet kimike, Shqiperia jo pjese e operacionit, Lajmifundit.al, 15 nëntor, 2013, <http://lajmifundit.al/2013/11/rama-ska-pasur-vendim-per-armet-kimike-vetem-negociata-ne-parim/>

Refuzohen armet kimike, Lajme, Vizion Plus TV, 10 nëntor, 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=n14lBqzhBQA>

Refuzohen armet kimike, Lajme, Vizion Plus TV, 15 nëntor, 2013, https://www.youtube.com/watch?v=3ijsNx7NL_Y

Rovena Mocka, Armet kimike, Kerry i Telefonon Rames, Edicioni Informativ, Top Channel TV, 8 nëntor, 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=rWVYbsSHt1Y>

Rovena Mocka, Shkaterrimi i armeve kimike, Edicioni Informativ, Top Channel TV, 1 nëntor, 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=Wq64jTUYXck>

Sadiela Olloni, Festojne protestuesit, Lajme, Vizion

Plus TV, 15 nëntor, 2013, https://www.youtube.com/watch?v=3ijsNx7NL_Y

Sadiela Olloni, Rama per armet e Sirise, Lajme, Vizion Plus TV, 12 nëntor, 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=d00j5kqsDq0>

Shkatërrimi i armëve kimike të Sirisë, përfitimet dhe disavantazhet për Shqipërinë, Ora News Lajme, Ora News TV, 1 nëntor, 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=tfpyq2Ro93w>

Shkatërrimi i armeve kimike, Bushati konfirmon kerkesen e SHBA, Albeu.com, 5 nëntor, 2013, <http://www.albeu.com/shqiperi/shkaterrimi-i-armeve-kimike-bushati-konfirmon-kerkesen-e-shba/130836/>

Shkatërrimi i lëndëve kimike, Rama: E kemi të pamundur, Edicioni Informativ, Top Channel TV, 15 nëntor, 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=QkWYslRacFg>

Shoqeria civile proteston para ambasadës SHBA, TV Klan, Edicioni Kryesor i Lajmeve, TV Klan, 12 nëntor, 2013, https://www.youtube.com/watch?v=OT6n_ElByA

Shqiperia ne kembe, TV Klan, Edicioni Kryesor i Lajmeve, TV Klan, 13 nëntor, 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=rPzrvzaFBA8>

Shqiperia zgjohet ne proteste, Rama: Sot mbaj qendrim per armet kimike, Lajmifundit.al, 15 nëntor, 2013, <http://lajmifundit.al/2013/11/shqiperia-zgjohet-ne-proteste-rama-sot-mbaj-qendrim-per-armet-kimike/>

Stop armëve kimike në vend, Shqipëria në protesta, Ora News Lajme, Ora News TV, 14 nëntor, 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=NqgpdzGz8pc>

Studentet ne Korçe kunder armeve kimike, Ora News Lajme, Ora News TV, 13 nëntor, 2013, https://www.youtube.com/watch?v=F7G_5ZzC0IQ

Vajza siriane ne proteste kunder armeve kimike, Albeu.com, 14 nëntor, 2013, <http://www.albeu.com/shqiperi/vajza-siriane-ne-proteste-kunder-armeve-kimike/131702/>

Vazhdon protesta para Kryeministrise, Albeu.com, 15 nëntor, 2013, <http://www.albeu.com/kryetitull/proteste-para-parlamentit-kunder-shkaterrimit-te-armeve-kimike-ne-shqi/131682/>

Zerat pro armeve kimike, Edicioni Informativ, Top Channel TV, 9 nëntor, 2013, <https://www.youtube.com/watch?v=v9pLd-LwmB4>

